44	Ndërtim i parqeve dhe këndeve të lojërave për Fëmijë	DUKM		70		10	30	30
45	Ndërtimi i rrjetit të energjise elektrike në Bjeshket e Junikut	DSHPMI		1,500		500	500	500
46	Hapja, Gjurmimi dhe Vënia në funksion e vendbanimit të periudhës së bronzit për vizitorët "Gropa e Amonit"	DAKRS		50		20	15	15
47	Restaurimi dhe vënia në funksion e monumenteve të vjetra si: Kullat, Mullinjtë dhe Valavicat	DAKRS		300		100	100	100
48	Ndërtimi i tregut të gjelbër	DZHE		80		80		
49	Ndërtimi i zonës për kamping – Moronice	DZHE		50			25	25
50	Ndërtimi i pishinave verore	DZHE		200			100	100
51	Kompleksi rekreativ në Livadhin e Madh	DZHE		50			250	250
52	Ndërtimi i objektit për Trashëgimi kulturore/muzeu i qytetit	DAKRS		600		200	200	200

53	Inkubator biznesi	DZHE	250	150	100	
54	Hapja dhe sinjalizimi i shtigjeve të reja për ecje çarku Moronicë-Zharre	DZHE	30	20	10	
55	Rekonstruimi i rrugës "Junik - Rastovic"	DUKM	2,200	1000		
56	Asfaltimi, kanalizimi dhe ujësjellësi në fshatin Gjocaj, Jasiq	DUKM	200	50	100	50
57	Ndërtimi i objektit të Gjykatës komunale	DAP	600		300	300
58	Ndërtimi i objektit të stacionit të Policisë	DSHPMI	400	200	200	
59	Ndërtimi i linjës Via-Ferrata në Lokacionin "Shkëmbi i Jedovës"	DZHE	80		30	50
60	Ndërtimi i fushës sportive në SHFMU "Edmond Hoxha"	DAKRS	130		100	30
61	Hartimi i planeve të hollësishme të komunës	DUKM	100	50	25	25
62	Ndërtimi i ujëmbledhësve në Komunën e Junikut	DUKM	2,500	1,000	1,000	500
63	Ndërtimi i rrjetit elektrik eficient smart lokal	DSHPMI	30		20	10
64	Hapja dhe trasimi i rrugëve malore	DZHE	20		10	10
65	Ndërtimi i palestrës sportive në Junik	DAKRS	700		350	350
66	Pyllëzimi i hapësirave të zhveshura	DZHE	120	40	40	40
67	Ruajtja, Sanimi dhe Rregullimi i burimeve të ujit të pijes në Ekofshatrat-Bjeshkë	DZHE	30	30		
68	Ndërtimi dhe rregullimi i hapësirave rekreative dhe sportive përgjatë lumit Erenik	DSHPMI	200	30	70	100
69	Themelimi i zonës ekonomike për investitorë të huaj	DZHE	300	150	150	
70	Ndërtim i trotuarit në rrugën Gaxherr- Bajraktar - Pepsh	DUKM	100	50	50	
71	Ndërtimi i palestrës sportive në Gjimnazin "Kuvendi i Junikut"	DAKRS	350	200	100	50
72	Infrastruktura rrugore për persona me mobilitet të zvogëluar	DSHPMI	5		5	
73	Ndërtimi i kompleksit të dëshmorëve	DUKM	100	50	50	
74	Ndërtimi i pendës së ujitjes në Qafë të Jasiqit- Tofaj- Pepsh	DZHE	50	50		
75	Ndërtimi i sistemit të ujitjes në lagjen Bramatok	DZHE	200	50	50	100
76	Zgjerimi i rrugës "Qendër-Shkollë Fillore- Pepsh- Teqja Halvetije Xhaferije"	DUKM	400	200	200	
77	Ndërtimi i pallatit të kulturës	DAKRS	1,500		1,500	
78	Ndërtimi, asfaltimi dhe ndriqimi i rrugës së Turbisë	DUKM	200	100	100	
79	Rregullimi i shëtitorës përgjatë lumit Trava	DUKM	200		100	100
80	Ndërtimi i rrethojave dhe rregullimi i varrezave	DSHPMI	100		50	50
81	Gjelbërimi i hyrjeve të qytetit të Junikut me drunje dekorativ	DSHPMI	15	5	5	5
82	Rregullimi i hapësirave tek parku Moronica	DUKM	55	55		
83	Shndërrimi i hapësirave përgjatë lumit Erenik në zona rekreative	DSHPMI	25	10	15	
84	Vendosja e kabinave pritëse në stacione nëpër lagje	DSHPMI	10	5	5	
85	Blerja e Automjetit për nevoja të Komunës	DAP	30			30
86	Hapja dhe sinjalizimi i shtigjeve në parkun Moronica	DZHE	30	10	20	
87	Ndërtimi i Depos së Komunës	DAP	5	5		
88	Rekonstruimi dhe Renovimi i objektit të komunës	DAP	50	50		
89	Ndërtimi i shtegut në brendi të Kanionit të Junikut me material metalik dhe druri	DZHE	15	10	5	

90	Ndërtimi i pikave vrojtuese panoramike në Bjeshkët e Junikut	DZHE	25	10	10	5
91	Hapja dhe Rregullimi i shtegut për lëshim me Bicikleta "Livadhi i Bahqit-Livadhi i Verrave"	DZHE	10		10	
92	Ndërtimi i shtegut për biçiklista	DSHPMI	10	10		
93	Rregullimi i kanaleve të ujitjes në lagjen Malok i poshtëm	DZHE	20		10	10
94	Instalimi i pompave termike në objektin e Komunës së Junikut	DSHPMI	50	25	25	
95	Instalimi i pompave në objektet e Institucioneve tjera Publike në Komunën e Junikut	DSHPMI	200	50	50	100
96	Ndërtimi i Digës lokacioni Gropa e Erenikut	DZHE	3,500	1,000	1,000	1.500
97	Ndërtimi i Qendrës së skijimit	DZHE	240	140	100	
98	Ndërtimi i pikave grumbulluese të produkteve bujqësore	DZHE	30	15	15	
99	Ndërtimi i Bujtinave Turistike	DZHE	150	50	50	50
100	Hartimi i planeve rregulluese Urbane për Gryken e Erenikut me lokalitetet: Gradinë, Jedovë, Liqejt e Gjeravicës dhe Rrasa e Zogut	DUKM	100	50	50	
101	Parku i Paqes në kufirin Shqipëri-Kosovë-Mali i Zi (ndërtimi i kampingut)	DUKM	150	100	50	
102	Ndërtim i impianteve të ujërave të zeza dhe trajtimi i tyre.	DUKM	1.200	500	500	200
103	Ndërtimi i rrugës Gropa e Erenikut Bogiqe (Kufiri Kosovë-Shqipëri-Mali i Zi)	DUKM	800	200	300	300
104	Studimi i Fizibilitetit për shtrirjen e nxemjës qendrore në Qytetin e Junikut.	DUKM	300	150	150	
105	Hapja e Rrugëve fushore Qafa e Jasiqit-Fierza	DSHPMI	30	15	15	
106	Ndërtimi i fushës së Futbollit	DAKRS	300		150	150
107	Ndërtimi i shtigjeve për këmbësor në rrugët e Junikut.	DSHPMI	50	50		
108	Rregullimi i kanaleve të ujërave të zeza në lagjen Pepsh	DSHPMI	30	15	15	
109	Vazhdimi i kanaleve të ujitjes në lagjen Miroc.	DZHE	50	25	25	
110	Ndërtimi i tretoarëve segmenti Qendër-Kallavaj	DSHPMI	100	50	50	
111	Rekonstruimi i kanalit kullues të Valavica	DUKM	20	10	10	
112	Funksionalizimi i impianteve të ujërave të zeza lokacioni Berishë dhe Gaxherr.	DSHPMI	100	30	30	40
113	Zhvillimi i Infrastrukturës së Integruar në fshatrat Gjocaj dhe Jasiq	DSHPMI	50	10	20	20
114	Ndërtimi i trotuareve në rrugët kryesore	DSHPMI	30	10	10	10
115	Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në Kallavaj	DUKM	60	30	30	
116	Rregullimi i oborrit të zjarrfikësve	DSHPMI	20	10	10	
117	Ndërtimi i parqeve dhe këndit të lojërave për fëmijë	DUKM	50	10	20	20
118	Ndërtimi i parkingut nëntokësor	DUKM	350	200	100	50
119	Funksionalizimi i pendës së Bramatoqeve lokacioni nën Jaruha	DUKM	50	50		
120	Ndërtimi i murit mbrojtës tek fusha e hapur e sportit në moronicë	DSHPMI	10	5	5	
121	Rekonstruimi i urave në disa rrugë të Bjeshkëve (Plaça e Junikut, Bjeshka e Tropojës)	DSHPMI	15		15	
122	Ndërtimi i sistemit të ujitjes në lokacionin Goqaj dhe troje. (Sistem i mbyllur)	DZHE	1.800	500	500	800
123	Rikonstruimi e Rrugës " Shkelzen Gacaferi"	DUKM	200	100	50	50
124	Rekonstruimi i fushës së sportit në lagjen Miroc.	DSHPMI	20	20		
125	Ndërtimi i kanaleve të ujitjes lokacioni Kanali i luqëve deri në Shafrane	DZHE	60		30	30
126	Rregullimi i Rrugës tek Bunari i Fushës	DZHE	50	30	20	
127	Vazhdimi i kanaleve të ujitjes në Setkovce	DZHE	40	20	20	
128	Ndërtimi i fushës së hapur sportive në Lagjen Pepsh	DAKRS	20	20		
129	Asfaltimi i Rrugëve në Lagjen Pepsh	DUKM	40	20	20	

130	Ndërtimi i Kanalit të ujitjes në lagjen Bajraktar (100m)	DZHE	8	8		
131	Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në Lagjen Krasniq	DZHE	20	10	10	
132	Ndërtimi i këndit për fëmijë në lagjen Gaxherr i epërm.	DSHPM	15	10	5	
133	Ndërtimi i baseneve rekreative lokacioni Jasiq dhe Moronicë	DZHE	250		150	100
134	Rregullimi i vend ndaljes për autobusin e transportit të nxënësve	DAKRS	15	15		
135	Rregullimi i fushës së sportit në Gjmnazin "Kuvendi i Junikut"	DAKRS	56			56
136	Rregullimi i infrastrukturës në lokalitetin Kështjella e Junikut-Gradina.	DAKRS	50		50	
137	Ndërtimi i pendës në lumin Trava	DUKM	100		50	50
138	Kanalizimi i ujërave të zeza në lagjen Pepsh Rruga e gështenjave me gjatësi 200 m	DUKM	20			
139	Ndërtimi i qendrës Rinore	DAKRS	500		200	300
140	Ndërtimi i kanalit të ujitjes segmenti Goqaj- Arashaj-Janik me gjatësi 2km	DZHE	70		70	
141	Rregullimi i hapësirave publike në lagjet Miroc dhe Malok – Kënd i lodrave	DSHPM	50			50
142	Kanalizimi i ujërave të zeza në lagjen Krasniq rruga Shafrane	DUKM	50		50	
143	Ndërtimi i kanalit të ujitjes- rruga Janik- fushat Goraqe 1.5km	DZHE	70		70	
144	Ndërtimi i pendës akumuluese lokacioni Ereniku i vogël	DUKM	400		200	200
145	Ndërtimi i pendës akumuluese lokacioni Gropa e Erenikut	DUKM	500		300	200
146	Ndërtimi i pendës akumuluese lokacioni Qafa e Jasiqit	DUKM	500		300	200
147	Rekonstruimi i shkalleve emergjente ne objektet publike të Komunës së Junikut.	DAP	500	100	200	200
148	Asfaltimi i rrugës Bekim Berisha 1,200m gjatësi	DSHPMI	90		90	
149	Ndriçimi Publik përgjatë rrugës "Brahim Sadiku"	DSHPMI	14		14	
150	Ndërtimi i trotuarit përgjatë rrugës "Brahim Sadiku"	DSHPMI	20		20	
151	Ndërtimi i murit mbrojtës tek rruga Qaush Ibishi	DSHPMI	30		30	
152	Kanalizimi i ujrave të zeza në lagjen Gaxherr rruga Arif Gjoci	DSHPMI	20	20		
153	Ndërtimi i kanalit të ujitjes në lagjen 7 shtatori	DSHPMI	20		20	
154	Rregullim i rrugës fushore Janik 500m	DZHE	12	12		
155	Asfaltimi i rrugës tek Qallakët	DSHPMI	25	25		

P. S. Vlerat e prezantuar në tabelë janë të shprehura në mijë (000) euro.

Kryetari i Komunës
Ruzhdi Shehu

Drejtoresha për Buxhet dhe Financa
Ardita Hoxha



REPUBLIKA E KOSOVES -- REPUBLIKA KOSOVA -- REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK -- OPŠTINA JUNIK -- MUNICIPALITY JUNIK



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA	REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK	MUNICIPALITY OF JUNIK
Drejtori	2-155/2914
Nr. i Fax	08/09/2025
Dato	

Data:	08.09.2025
Për/Za/To:	z. Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal
Përmes/Preko/Through:	z. Ruzhdi Shehu - Kryetar i Komunës
Nga/Od/From:	Znj. Ardita Hoxha - Drejtoresh për Buxhet dhe Financa
Tema/Subjekat/Subject:	Kërkese për të shtuar në rend dite në KPF dhe Kuvend shqyrtimin dhe miratimin e Normave Tatimore për vitin 2026.

I nderuar,

Duke u Bazuar në Ligjin Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 9 Ligjin Nr.08/L-224 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme si dhe U.A Nr.08/2019 për Metodologjinë e Vlersimit të Pronës së Paluajtshme, Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L040, Drejtoria për Buxhet dhe Financa kërkon nga KPF dhe Kuvendi Komunal që të bëjë miratimin e Normave për vitin 2026.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK



DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Duke u bazuar në Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.06/L-005, për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, Ligji Nr.08/L-224 neni 9, pika 4, Kuvendi i Komunës cakton shkallën e aplikueshme tatimore për çdo kufi tatimor sipas paragrafit 3 të këtij neni, deri me 30 nëntor të vitit para vitit të vendosjes së tatimit. Shkallët tatimore të përcaktuara nga komuna duhet të kenë trend progresiv dhe e cila dallon nga vitet e mëhershme kur kemi pas shkallë tatimore në bazë të kategorive të pronave, nësi ZTP ju propozojmë që shkalla tatimore për vitin 2026 shkalla bazike:

PROPOZON

CAKTIMIN E NORMAVE TATIMORE PËR TATIMIN NË PRONËN E PALUAJTSHME PËR VITIN 2026

Neni 1

Shkalla tatimore progresive

1. Caktohen normat tatimore për vitin 2026 për të gjitha vlerat e pronave në territorin e Komunës së Junikut, sipas vlerës së kombinuar të gjitha pronave të paluajtshme të tatimpaguesit, si vijon:

- 1.1. Për vlerën e pronave deri në njëqindmijë (100,000.00) euro **caktohet** shkalla tatimore në lartësinë prej **0.10 %**;
- 1.2. Për vlerën e pronave mbi njëqind mijë (100,000.00) euro **caktohet** shkalla tatimore në lartësinë prej **0.20 %**, plus tatimi nga nën-paragrafi 1.1 të këtij neni;
- 1.3. Për vlerën e pronave mbi pesë qind mijë (500,000.00) euro **caktohet** shkalla tatimore në lartësinë prej **0.30 %**, plus tatimi nga nën-paragrafët 1.1 dhe 1.2 të këtij neni;
- 1.4. Për vlerën e pronave mbi një milion (1,000,000.00) euro **caktohet** shkalla tatimore në lartësinë prej **0.40 %**, plus tatimi nga nën paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3 të këtij neni; dhe
- 1.5. Për vlerën e pronave mbi pesë milionë (5,000,000.00) euro **caktohet** shkalla tatimore në lartësinë prej **0.50 %**, plus tatimi nga nën-paragrafët 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të këtij neni.

II. Normat tatimore sipas këtij neni caktohen konform nenit 9 të plotësuar dhe ndryshuar me nenin 2 të Ligjit Nr.08/L-224 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.

Drejtoreshë për Buxhet edhe Financa:

Datë: 09.09.2025

Znj. Ardita Hoxha





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02-180/09/25
Datë: 19.09.2025

Në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 30 paragrafi 6 të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26 i datës 29.09.2010) dhe nenit 8 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Junikut iu bënë këtë:

FTESË

Për: Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Nga: **Shpejtim Gacaferi** – kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut;
Lënda: Mbledhja e nëntë (09) - e rregullt 2025 të Legjislacionit V të Kuvendit të Komunës së Junikut;
Vendi: Salla e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Data: 26.09.2025, ora 10⁰⁰.

Rendi i ditës:

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e kaluara;
3. Shqyrtimim dhe miratimi i Draft Buxhetit për vitin 2025-2028;
4. Formimi i Grupit të punës për hartimin e projekt Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2026;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2026;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit për Trashegimi Kulturore 2025-2030 për Komunen e Junikut;
7. Rishqyrtimi i Vendimit Nr. 02-180/7547 për miratimin e Planit ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturunave në komunën e Junikut, miratuar nga Kuvendi Komunal i Junikut, datë 29.08.2025;
8. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit;
9. Të ndryshme.



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – RÉPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

Plani për Trashëgiminë Kulturore 2025-2030

Shtator, 2025

Përmbajtja

KAPITULLI 1	3
HYRJE.....	3
QËLLIMI I PLANIT:.....	4
RËNDËSIA E TRASHËGIMISË KULTURORE PËR JUNIKUN	4
METODOLOGJIA E PËRDORUR	4
Grupi Punuese Për Hartimin E Planit Për Trashigimi Kulturore 2025-2030.....	4
Plani u mbështet nga Drejtorit, shkollat , bizneset dhe OJQ.....	4
PERIUDHA E MBULUAR:	5
KAPITULLI 2.....	5
KOMUNA JUNIK – KONTEKSTI	5
GJEOGRAFIA:.....	5
HISTORIA:.....	5
2.3. KONTEKSTI SOCIAL	7
KAPITULLI 3	8
FORMAT E TRASHËGIMISË KULTURORE NË JUNIKUN	8
TRASHËGIMIA ARKITEKTONIKE:	8
TRASHËGIMIA ARKEOLOGJIKE:	9
TRASHËGIMIA E LUAJTSHME:	9
TRASHËGIMIA SHPIRTËRORE	10
Ushqimet Tradicionale.....	11
KAPITULLI 4	12
ANALIZA SWOT PËR TRASHËGIMINË KULTURORE TË JUNIKUT.....	12
4.1. MBROJTJA DHE MENAXHIMI I TRASHËGIMISË KULTURORE:.....	13
4.2. EDUKIMI:.....	13
4.3. ZHVILLIMI EKONOMIK:.....	14
4.4. PROMOVIMI:.....	15
KAPITULLI 5	15
VIZIONI, OBJEKTIVAT DHE REZULTATET E PRITURA	15
VIZIONI:.....	15
OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME:	15
OBJEKTIVAT SPECIFIKE DHE REZULTATET E PRITURA:	16
1. OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM: EDUKIMI DHE VETËDIJËSIMI.....	16

2. OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM: MBROJTJA DHE MENAXHIMI	16
3 Objektivi i Përgjithshëm: Zhvillimi Ekonomik.....	17
4. OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM: PROMOVIMI	17
OBJEKTIVI SPECIFIK 4.1:.....	17
OBJEKTIVI SPECIFIK 4.2:.....	17
OBJEKTIVI SPECIFIK 4.3:.....	17

KAPITULLI 617

PLANI I VEPRIMIT	17
OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM 1: EDUKIMI DHE VETËDIJËSIMI	18
OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM 2: MBROJTJA DHE MENAXHIMI	19
OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM 3: ZHVILLIMI EKONOMIK.....	20
OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM 4: PROMOVIMI	21

KAPITULLI 723

MONITORIMI DHE VLERËSIMI:	23
7.1. KORNIZA E MONITORIMIT:	23
7.2. PROCESI I VLERËSIMIT:	23
7.3. PËRSHTATJA DHE PËRMIRËSIMI:	24

KAPITULLI 824

TAB.1. MONUMENTET ARKITEKTONIKE ME MBROJTJE TË PËRKOSHME.....	24
TAB.2. MONUMENTET ARKITEKTONIKE ME MBROJTJE TË PËRKOSHME.....	25
Shkurtesat.....	25

Ky dokument është i hartuar nga Komuna Junik, bartës i të cilit është Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, në bashkëpunim me Organizaten jo qeveritare CHwB (Trashigimia kulturore pa kufi) në Kosovë.

Kapitulli 1

Hyrje

Ky kapitull shërben si një prezantim i Planit për Trashigiminë Kulturore të Komunës së Junikut 2025-2030. Ai përcakton qëllimin e saj kryesor, thekson rëndësinë e trashëgimisë kulturore për identitetin, zhvillimin dhe mirëqenien e Junikut, përshkruan metodologjinë e përdorur në hartimin e saj dhe përcakton periudhën kohore që mbulon ky Plan.

Qëllimi i Planit:

Qëllimi kryesor i Planit është të krijojë një kornizë të qartë dhe gjithëpërfshirëse për mbrojtjen, promovimin dhe zhvillimin e trashëgimisë kulturore të Junikut. Gjithashtu ky Plan synon të shfrytëzojë potencialin e trashëgimisë kulturore si një aset i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik, social dhe turistik të Junikut, duke ruajtur dhe transmetuar vlerat e saj për gjeneratat e ardhshme. Nëpërmjet këtij Plani, synohet të përmirësohet menaxhimi i trashëgimisë kulturore, të rritet vetëdijesimi i publikut për vlerat e saj, të nxitet pjesëmarrja e komunitetit në ruajtjen e saj, dhe të promovohet Juniku si një destinacion unik turistik kulturor.

Rëndësia e Trashëgimisë Kulturore për Junikun

Trashëgimia kulturore e Junikut përbën një pjesë thelbësore të identitetit të tij dhe një pasuri të çmuar për zhvillimin e tij të ardhshëm. Duke përfshirë monumente historike, tradita të gjalla, artefakte unike, dhe peizazhe tërheqëse natyrore, trashëgimia kulturore e Junikut ofron një pasqyrë të historisë, vlerave dhe mënyrës së jetesës së komunitetit. Ajo jo vetëm që na lidh me të kaluarën, por edhe na ndihmon të kuptojmë të tashmen dhe të planifikojmë të ardhmen tonë. Përveç vlerës së saj kulturore dhe historike, trashëgimia kulturore ka një potencial të madh për zhvillimin ekonomik të komunës së Junikut. Ajo mund të tërheqë turistë, të krijojë vende pune, të mbështesë bizneset lokale, dhe të gjenerojë të ardhura për komunitetin. Duke investuar në mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, ne po investojmë në një të ardhme më të mirë për komunën e Junikut.

Metodologjia e Përdorur

Ky Plan është hartuar nëpërmjet një procesi gjithëpërfshirës, duke përfshirë konsultime të gjera me të gjithë aktorët e interesit në komunën e Junikut, si përfaqësues të komunës, pronarë të monumenteve kulturore, operatorë turistikë, organizata joqeveritare, mësues, studentë, dhe anëtarë të komunitetit. Ky proces konsultativ ka siguruar që Plani të pasqyrojë nevojat dhe aspiratat e komunitetit, dhe të jetë e bazuar në të kuptuarit e thellë të trashëgimisë kulturore të komunës së Junikut. Për të analizuar gjendjen aktuale të trashëgimisë kulturore dhe për të identifikuar sfidat dhe mundësitë, janë përdorur Analizat SËOT- për fusha të ndryshme, si mbrojtja dhe menaxhimi i trashëgimisë kulturore, edukimi, zhvillimi ekonomik, dhe promovimi. Rezultatet e këtyre analizave kanë shërbyer si bazë për formulimin e objektivave strategjike dhe planit të veprimit.

Grupi punues për hartimin e Planit për Trashigimi Kulturore 2025-2030

1. Xhavit Velijaj-Kryesues- Drejtor i drejtoris për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport;
2. Sali Shoshi – Anëtar-Drejtor i CHwB në Kosovë;
3. Ferdone Tofaj- Anëtar-Shefe e Sektorit për Planifikim;
4. Arten Hamza – Anëtar - Zyrtar kryesor financiar;
5. Fatmir Isufaj –Anëtar- Shef i Sektroit për Kulturë, Rini dhe Sport.

Plani për Trashigimi Kulturore 2025-2030, u mbështet nga perfaqsesit e drejtorive, Shkolla, biznesi dhe OJQ

Zenun Shala-Drejtor I Drejtoris per Urbanizëm, Gjeodezi dhe Mjedis, komuna Junikut;
Demokrat Ganijaj- drejtor i Drejtorisë per Shërbime Publike, Inspektoriat, Mbrojtje dhe Mjedis, komuna Junikut;
Jetmit Jasiqi-Drejtor i Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, komuna Junikut;

Vjollca Qestaj- Drejtoreshë e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, komuna Junikut;
Leonora Shehu- Drejtoresh për Administratë, komuna Junikut;
Bekim Gaxherri –Drejtor i SHFMU “Edmond Hoxha” në Junik - Kryetar i shoqatës “Rrasa e Zogut”, komuna Junikut;
Haki Jasiqi – Fusha e biznesit;
Mësimdhënësit nga SHFMU „Edmond Hoxha“.

Periudha e mbuluar:

Ky Plan kulturor mbulon periudhën nga 2025 deri në 2030. Ajo do të rishikohet dhe përditësohet periodikisht për të siguruar që të mbetet e rëndësishme dhe e efektshme në përmbushjen e qëllimeve të saj, duke u përshtatur me ndryshimet në kontekstin lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.

Kapitulli 2

Komuna Junik – Konteksti

Ky kapitull synon të ofrojë një kuadër të përgjithshëm për Komunën e Junikut, duke analizuar aspektet gjeografike, historike dhe sociale që ndikojnë në trashëgiminë kulturore të saj.

Gjeografia:

Komuna Junik, ndodhet në pjesën jug-perëndimore të Kosovës, në rajonin e Dukagjinit dhe bën pjesë në regjionin e Pejës. Pozita gjeografike e Junikut, gjendet në mesë të fushave pjellore dhe male të larta, kjo ka ndikuar në mënyrën e jetesës, traditat, dhe zhvillimin e komunitetit.

Komuna Junik, karakterizohet nga një relief kryesisht malor, pasi shtrihet në zemër të „Bjeshkëve të Nemuna“ (Alpet Shqiptare), një rajon i njohur për relievin e tij të thyer, majat e larta, luginat e thella, lumej dhe liqejtë dhe bukuritë natyrore. Komuna shquhet me Malin e „Gjeravicës“, maja më e lartë në Kosovë, si dhe me Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", një zonë e mbrojtur me biodiversitet të lartë dhe peizazhe tërheqëse.

Lumenjt „Erenik“ dhe „Lumi i çetë“, kalojnë nëpër teritorin e komunës, duke siguruar ujë të bollshëm për bujqësi dhe duke krijuar peizazhe tërheqëse. Lumenjtë burimorë dhe përrënjtë e shumtë ushqejnë tokat pjellore dhe krijojnë kushte të favorshme për zhvillimin e florës dhe faunës.

Pyjet e dendura me pisha, ah, gështënja dhe bredhi mbulojnë pjesën më të madhe të territorit të Junikut, duke ofruar resurse të rëndësishme për ekonomi, mbrojtje nga erozioni, dhe habitat për kafshë të egra. Bjeshkët e Nemuna ofrojnë gjithashtu mundësi për zhvillimin e turizmit malor, hikingut, alpinizmit, dhe sporteve dimërore. Pozita gjeografike e Junikut ka bërë që ai të jetë një qendër e rëndësishme për blegtori dhe bujqësi, si dhe një destinacion i njohur për turizmin malor. Burimet natyrore si uji, pyjet, dhe mineralet kanë ndikuar në zhvillimin ekonomik të zonës dhe kanë formësuar mënyrën e jetesës së banorëve.

Historia:

Juniku si lokalitet në periudhën antike dhe mesjetare, ka një histori të pasur dhe të lashtë, e cila ka lënë gjurmë të pashlyeshme në identitetin e tij kulturor. Gjurmët e para të banimit njerëzor në zonën e Junikut datojnë që nga periudha e Neolitit, siç dëshmojnë zbulimet arkeologjike në vendbanimin e

Kronit të Madh dhe lokalitete të tjera përreth. Këto zbulime tregojnë për një kulturë të zhvilluar bujqësore dhe blegtorale, si dhe për një organizim shoqëror të hershëm. Gjatë periudhës romake, rajoni i Junikut u bë pjesë e provincës së Ilirikut, duke lënë gjurmë të kulturës dhe arkitekturës romake, siç janë rrugët, fortifikimet, dhe vendbanimet e asaj kohe. Në mesjetë, Juniku u bë pjesë e Principatës së Kastriotëve, një nga principatat më të rëndësishme shqiptare. Gjatë kësaj periudhe, Juniku u zhvillua si një qendër e rëndësishme ekonomike dhe kulturore, duke pasur lidhje të ngushta tregtare me qytetet e tjera të rajonit. Gjatë periudhës osmane, e cila zgjati për më shumë se katër shekuj, ndërtimi i xhamive, teqeve, haneve dhe objekteve të tjera të kultit islam dëshmon për ndikimin e kulturës osmane në Junik. Njëkohësisht, u ruajtën dhe u zhvilluan traditat dhe zakonet lokale, duke krijuar një sintezë unike kulturore.

Kuvendi i Junikut, i mbajtur në Maj të viti 1912, ishte një ngjarje e rëndësishme në historinë e kombit shqiptar. Në këtë kuvend, përfaqësues nga të gjitha trevat shqiptare u mbledhën për të diskutuar dhe vendosur për strategjinë e përbashkët për të arritur pavarësinë nga Perandoria Osmane. Kuvendi i Junikut konsiderohet si një nga momentet më kulmore të Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe si një nga gurët themeltarë të shtetit të pavarur shqiptar.

Luftat Ballkanike 1912-1913, Juniku pas ramjes së perandoris Osmane dhe luftës për mbrojtjen e Junikut dhe trojeve shqiptare, Juniku ra nën sundimin Serb, ku si pasojë ishte vrasja e shumë atdhetarëve dhe largimi i popullatës në drejtime të ndryshme dhe shkatërrimi i shtëpive dhe u dogjen dhe u plaqkiten, gjithashtu filloi arrja e kolonizatorëve malazez dhe serb në tokat e Junikut me rrethin.

Lufta e parë Botërore 1914-1918. Gjatë kësaj lufte Juniku u administrua nga aleatët Austro-Hungarez. Në 1915-1918, ishte hapur shkolla e parë shqipe në Junik. Ndërsa pas përfundimit të luftës së parë botërore aleatët humbën luftën, Juniku, ra nën sundimin e Mbretërisë Jugosllave (Serbo-Kroate-Slllovene), ku kërret e Junikut u vranë dhe u përndjekën, u shkatërruan shumë shtëpi, u mbyll shkolla shqipe, dhe një pjesë e popullsisë u detyrua të largohej nga vendlindja e tyre. Megjithatë, banorët arritën të rindërtojnë dhe të ruajë identitetin e tij kulturor.

Neutraliteti i Junikut – Zona neutrale (autonome) e Junikut u krijua në nëntor 1921 nga autoriteti i Lidhjes së Kombeve pas mosmarrëveshjeve kufitare midis dy vendeve, Shqipëri dhe Mbretërisë së Bashkuar Jugosllave, dhe ndërhyrjeve të shpeshta ushtarake nga pala jugosllave, që nga viti 1918 në palën shqiptare, si dhe përleshjeve të vazhdueshme midis lëvizjes kombëtare shqiptare dhe ushtrisë jugosllave. “Zona Neutrale e Junikut” ishte praktikisht autonome, e sunduar nga vendas dhe me norma kanunore. Juniku, për shkak të rrethanave historike, humbi neutralitetin në janar të vitit 1923 dhe ra nën sundimin e mbretërisë Jugosllave. Edhe gjatë kësaj kohe banorët e Junikut u persekutuan duke vrarë kërret e asaj kohe dhe duke i përndjekur banorët e Junikut. Sipas të dhënave shumica e banorëve ishin strehuar në zonat malore për të mbrojtur nga rpushtimi i zonës nga forcat Jugosllave. Pas rpushtimit të Junikut me rrethin, Mbretëria Jugosllave rifilloi kolonizimin me serbo malazez deri në vitin 1939.

Juniku gjatë Luftës së Dytë Botërore – Lufta e dytë botërore ndaloi kolonizimin e Junikut me rrethin sipas planit të Qubrilloviçit, hyri nën administrimin e shtetit të Shqipërisë gjatë pushtimit Italian dhe gjerman, ku u hapën shkolla në gjuhën shqipe, të cilat deri në atë kohë ishin të ndaluara. Në vitin 1944-1945 pas largimit të forcave Gjermane, Juniku prapë ju nënshtrua një lufte për mbrojtjen e Junikut prej forcave partizane. Në fillim të vitit 1945, Juniku me rrethinë ra në duart e partizanëve Jugosllav,

shumë prej banorëve u larguan dhe u vranë dhe u perndjekën, ku si pasoj u vra dhe u zhduken paria (udhëheqja) e Junikut prej 12 anëtarëve. Shumë shtëpi u djegen dhe u shkatërruan duke përfshirë ekonominë familjare.

Pas përfundimit të luftës, Juniku u bë pjesë e Jugosllavisë komuniste. Pas kësaj lufte prap banorët filluan rimëkëmjen, duke vazhduar shkollimin në gjuhën shqipe dhe u ndërtuan shkollat dhe shtëpitë dhe u ndërmorën reforma shoqërore dhe ekonomike, duke përfshirë kolektivizimin e bujqësisë dhe industrializimin deri në vitin 1990.

Juniku gjatë viteve 1989 deri në vitin 1999, Pasi u suprimua autonomia e Kosovës në vitin 1989 nga rregjimi Serb, Parlamenti ë Kosovës në vitin 1990 shpalli kosovën Republikë, ndërsa në vitin 1991 shpalli kosoven shtet te pavarunnga Federata Jugosllave, pastaj filloi perndjekja e delegatve te kuvendi dhe kambinetit qeveritar. Qeveria e kosovës dhe parlamenti vepruan ne ekzil, ndësa vetëm presidenti i Republikës së Kosovës veproi mbrenda Kosovës, duke i organizuar institucionet paralele, ndaj regjimit serb. Në këtë organizim përfshihej organizimi politik, ushtarak, arsimi, shëndetësia, etj.

Lufta e fundit në Kosovë (1998-1999), shkaktoi dëme dhe vuajtje të mëdha në Junik. Ushtria dhe forcat paramilitare serbe kryen krime të shumta kundër popullsisë civile, duke përfshirë vrasje, tortura dhe dëbime. Në mars të vitit 1998, popullata e Junikut me rrethinë, u vetorganizua në vetmbrojtje me institucionet paralele te Republikës së Kosovë dhe UÇK-në, kundër forcave policore, ushtarake dhe paramilitare serbe. Gjatë kohës së luftimeve në mbrojtje të Junikut, ranë shumë dëshmorë, martirë dhe kishte shumë të plagosur si nga ushtaret te UÇK-së dhe popullata civile. Pas intervenimit NATO-s në mars të viti 1999 me forca ajrore, dhe luftës së UÇK, ka mesi i Qershorit 1999, forcat serbe detyrohen të tërhiqen nga Juniku dhe Kosova, gjatë tërheqjes së forcave serbe mbi 90% të shtëpive të Junikut me rrethinë u plaqkitën, u vu zjarri dhe u shkatërruan bashk me ekonominë familjare.

Periudha e pas Luftës 1999

Pas luftës dhe largimit të forcave policore dhe ushtarake të regjimit serb, vendi u vendos nën administrimin ndërkombëtar (civil – UNMIK dhe ushtarak – KFOR), në vitin 2002 u mbajtën zgjedhjet lokale dhe parlamentare ku u formuan institucionet e Kosoves në mbikëqyrjen e UNMIK-ut. Vendi u rindërtua me ndihmën e donatorëve ndërkombëtarë, dhe nga vetë banorët e Junikut. Juniku deri ne vitin 2005 ishte pjesë e komunës së Deçanit, në vitin 2005, Juniku fiton statusin e Pilot njesisë komunale, ndërsa në vitin 2008, Juniku fiton statusin e Komunës.

2.3. Konteksti Social

Juniku karakterizohet me banorë të lidhur ngushtë, me tradita të forta dhe një identitet kulturor të dallueshëm. Sipas të dhënave të fundit të vitit 2024 nga Enti Statistikor i Kosovës, Juniku ka një popullsi prej 3,963 banorë të përhershëm. Shpërndarja e popullsisë sipas moshës tregon një numër të konsiderueshëm të të rinjve, duke theksuar rëndësinë e investimit në edukimin dhe zhvillimin e tyre.

Banorët e komunës së Junikut janë të njohur për traditat të vjetra, siç janë mikpritja, besa, nderi dhe respekti shoqëror. Këto vlera reflektohen në marrëdhëniet e ngushta familjare dhe në gatishmërinë për të ndihmuar dhe mbështetur njëri-tjetrin. Festat tradicionale si Dita e Verës, Bajrami dhe festa e Shën Gjergjit festohen me ceremoni dhe aktivitete të shumta, duke përfshirë valle tradicionale, këngë epike të interpretuara me çifteli dhe lahutë, gatime karakteristike si flija, maza e zier, etj.

Artizanati lokal ka pasur një rëndësi të veçantë në komunën e Junikut. Punimet e leshit, si qilimat, sexhadet dhe veshjet tradicionale, si zhgunët dhe tirqit, janë dëshmi e aftësive të artizanëve vendas. Gdhendja e drurit, punimi i veglave bujqësore dhe prodhimi i instrumenteve muzikore, si çiftelia dhe fyelli, janë gjithashtu pjesë e trashëgimisë artizanale të Junikut.

Marrëdhëniet sociale dhe familjare janë thelbësore për ruajtjen dhe transmetimin e trashëgimisë kulturore. Familjet kanë lidhje të ngushta, dhe brezat e vjetër luajnë një rol të rëndësishëm në përcjelljen e traditave dhe vlerave kulturore te brezat e rinj. Këndimi i këngëve kreshnike dhe praktikat e artizanatit lokal janë ende të gjalla dhe vlerësohen nga banorët. Odat e Junikut, si një institucion i lashtë i vendimmarrjes dhe zgjidhjes së konflikteve, ishte një element i rëndësishëm i jetës shoqërore.

Shkolla fillore e mesme e ulët "Edmond Hoxha", shkolla e mesme – gjimnazi "Kuvendi i Junikut", biblioteka komunale "Dinë Mehmeti", si dhe xhamia e vjetër dhe teqja, janë institucione të rëndësishme që kontribuojnë në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore. Shkollat luajnë një rol kyç në edukimin e gjeneratës së re për vlerat e trashëgimisë, ndërsa biblioteka ofron burime të rëndësishme informacioni dhe materiale për studiuesit dhe entuziastët. Me funksionalizimin e Qendres Kulturore krijohen shërben si një hapësirë për organizimin e ngjarjeve kulturore, ekspozitave dhe aktiviteteve të tjera që promovojnë trashëgiminë e Junikut.

Kapitulli 3

Format e Trashëgimisë Kulturore në Junik

Ky kapitull paraqet format e ndryshme të trashëgimisë kulturore në Junik.

Trashëgimia Arkitektonike: Ndërtesat dhe strukturat që reflektojnë historinë kulturën e Junikut: dhe

- **Kulla** (Shtëpi tradicionale, simbol i forcës dhe mikpritjes).
- **Mulli** (Vend ku përpunohej kallamoqi dhe gruri për të prodhuar miell).
- **Vajevica:** Sistem tradicional për përpunimin e leshit.
- **Mure rrethuese:** Mbrojtje nga sulmet e jashtme.
- **Posllome:** Vendet ku janë ruajtur gjësendet dhe ushqimet për kafshë.
- **Hambare:** Magazina për ruajtjen e drithërave.
- **Ndërtesa kulturi (Xhami, Teqe, Tyrbe):** Vende për adhurim fetar.
- **Shkolla e vjetër:** Vend ku mësoheshin brezat e rinj.
- **Kosh drithi:** Ruajtës i drithërave.
- **Bunari:** Burim i ujit.
- **Kanale të ujitjes (të Gurit):** Ujë për bujqësi.
- **Stane:** Vendqëndrime verore në bjeshkë, kryesisht për blegtorë.
- **Hidrocentrali (Tofaj):** Burim i energjisë elektrike.
- **Gardhi:** (I punuar me thupra druri të thurura me shtylla druri, i cili ka shërbyer si rrethoj oborri apo livadhi)
- **Urat:** (Kalime për blegtorët mbi lumenj dhe përrenj të punuar prej druri).

Trashëgimia Arkeologjike: Mbetjet nga e kaluara e lashtë:

- **Kroni i Madh:** Vendbanim i hershëm.
- **Kështjella e Junikut (Gradina):** Fortesë e lashtë.

Trashëgimia e Luajtshme: Objektet e përdorura në jetën e përditshme dhe në punë:

- **Vek:** (Mjet për përpunimin e veshjeve dhe shtrojave tradicionale);
- **Furkë:** (Mjet dore për dredhjen e penjit nga leshi);
- **Makinë për tjerre:** (Mjet me të cilin, nga leshi përpunohen penjet);
- **Shtizë:** (Vegël dore për grumbullimin e penjeve nga leshi);
- **Qeberr, tinarë:** (Ruajtja e djathit);
- **Vedra:** (Vegël nga druri për bartjen e qumështit (tambëlit));
- **Drapër:** (Vegël për korrjen e kallamoqit dhe grurit);
- **Lagraqa:** (Vegël për ndërrimin e saqit nga vatra e zjarrit);
- **Kaca:** (Mjet ku ruhen perimet e konservuara (turshitë));
- **Kenata:** (Përshkrim i shkurtër specifik);
- **Buria:** (Mjet nga druri për bartjen e ujit nga burimi);
- **Bucaku:** (Mjet për bartjen e ujit);
- **Kerr i kalit:** (Karrocë e cila ka rrota me spica druri apo me rrota gome);
- **Kerri me kija:** (Kallëcë me rrota me spica druri, e cila tërhiqet nga lopët apo nga kau);
- **Gërshanë:** (Vegël që përdoret për prerje të ndryshme);
- **Vegsh:** (Enë prej llaqi (argjile) e pjekur në temperaturë, e cila shërben për zierje);
- **Zhguni:** (Material i punuar nga leshi që përdoret për veshje apo mbulim);
- **Postaja:** (Lëkurë e deleve e përpunuar për shtroja apo mbulim);
- **Plis:** (Kapelë prej leshi deleje, që ka ngjyrë të bardhë dhe formë gjysmë rrethore);
- **Qifteli:** (Vegël muzikore me dy tela);
- **Lahutë:** (Vegël muzikore me një tel);
- **Kaval:** (Vegël muzikore nga druri apo bronxi me frymë, me gjatësi rreth 60 cm);
- **Fyelli:** (Vegël muzikore nga druri, me frymë, me gjatësi 30 cm);
- **Mullar i sanës:** (Grumbullimi i sanës (bar i thatë) rreth një trungu gështenje të tharë me degë të prera rreth trungut, rreth 25 cm; trungu me gjatësi rreth 8 m);
- **Gërshërët e sanës:** (Vegël për prerjen e sanës në mullar);
- **Arka e pajës (kutia):** (Kuti ku vendoset pajë (qeji) e nuses);
- **Veshja e katunit (komplet):** (Veshje tradicionale për gra: Këmishë, marham, lidhca, shalli, jeleku, çorapët dhe pështjellakët);
- **Tirqit:** (Veshje tradicionale për burra, e punuar prej leshi të deleve);
- **Sinija (sofra):** (Dërrasë druri e rrumbullakët, e këmbëzuar, me lartësi rreth 30 cm; shërben si tavolinë për ushqyerje);
- **Shkomi:** (Ulësë nga druri me tri këmbë, e punuar prej druri pishe, me degë të prera nga trungu 30 cm që shërbejnë si këmbë);
- **Atllagia (t'holluese):** (Shërben për përgatitjen e petëve për pite, ka formë shkopi me gjatësi rreth 1 m);
- **Maxhe:** (Kuti ku ruhet mielli dhe gatuhet bukët);
- **Fener:** (Mjet prej metali dhe xhami, me gazë dhe fitil, që përdoret për ndriçim të jashtëm);
- **Lloma:** (Mjet prej qelqi, me gazë dhe fitil, që përdoret për ndriçim të brendshëm);
- **Pisha:** (Material që ka shërbyer për ndezje dhe ndriçim);
- **Tfurki (druri):** (Vegël nga druri për përdorimin e barit, sanës);

- **Grabuja (druri):** (Vegël për pastrimin apo mbledhjen e barit me tërheqje);
- **Zgjedha e kijeve:** (Pjesa ku vendosen kafshët për tërheqjen e qerres);
- **Parmenda:** (Mjet nga druri me të cilin është lëvruar toka);
- **Vllaqa:** (Mjet i thurur nga thupra druri shkoze për rrafshimin e sipërfaqes pas lavrimit të tokës);
- **Qerepi:** (Vegël e rrumbullakët nga thëngjilli i pjekur, në të cilën është vendosur buka për pjekje);
- **Fund buke:** (Përgatitja e bukës para vendosjes në qerep);
- **Qilim:** (Shtrojë në dyshe);
- **Sexhade:** (Mbulojë);
- **Dekica:** (Mbulojë);
- **Goblen:** (Pikturë nga materiali i tekstilit);
- **Jetek:** (Mbulesë shtrati prej materiali tekstili);
- **Mlojsa (djepit):** (Mbulesë djepi);
- **Strajca:** (Thes prej leshi);
- **Plunga:** (Pëlhurë prej leshi që është përdorur për bartjen e fëmijëve, ushqimeve dhe gjësendeve në pjesën e pasme të shpinës);
- **Sita:** (Vegël për sitje);
- **Shosha:** (Vegël për sitje të të korrave);
- **Katullaqi:** (Për vendosjen e tepsive);
- **Kosa:** (Vegël dore për kositje, ka bisht druri dhe teh metali);
- **Krraba e sanës:** (Për nxjerrjen e sanës nga mullari i sanës);
- **Kull e qekiq:** (Vegla për cokatjen e kosës (mprehjen));
- **Qekiqi:** (Vegël metali me bisht druri, që shërben për shtypje apo goditje);
- **Krrabza (çorape):** (Vegël për përpunimin e çorapeve);
- **Krrabza (tentene):** (Vegël për përpunimin e mbulesave);
- **Therrica:** (Vegël dore për përpunimin e mbulesave etj.);
- **Saqi:** (Vegël metali për pjekje që ngrohet në prush dhe vendoset mbi bukë në qerep (mbulesë));
- **Tangari:** (Vegël për vendosjen e prushit, që shërben për ngrohje të dhomës);
- **Saxhaku:** (Vegël për vendosjen e qerepit në vatër);
- **Djepi:** (Mjet nga druri për vendosjen e fëmijës në gjumë duke e lëkundur).

Trashëgimia Shpirtërore: Traditat dhe praktikat e transmetuara brez pas brezi:

- **Kuvendi i Junikut:** (Ngjarje historike për pavarësi nga Perandoria Osmane);
- **Neutraliteti i Junikut:** (Zonë me autonomi dhe garanci ndërkombëtare);
- **Ora letrare:** (Aktivitet kulturor);
- **Dita e verës:** (Aktivitet tradicional për pritjen e pranverës);
- **Festat e Bajramit:** (Festa fetare);
- **Mbledhja e burrave:** (Ngjarje ku mblidhen burrat dhe merren vendime);
- **Nata e konagjeqit:** (Përgatitja e vajzave për ditën e martesës);
- **Dita e konagjeqit:** (Dita e martesës së vajzave);
- **Nata e dasmës:** (Përgatitja për ditën e dasmës);
- **Krushqit:** (Dasmorë që marrin nusen dhe e sjellin te shtëpia e dhëndrit);
- **Dita e dasmës:** (Dita kur mblidhen familjarët dhe farefisi për të festuar martesën e djalit);
- **Përcjellja e nuses:** (Ditën e konagjeqit, me ardhjen e krushqve, nusja përcillet deri te kerri i nuses);

- **Marrja e nuses:** (Nusja pasi hyn në kerrin e nuses, krushqit vazhdojnë rrugën deri te shtëpia e dhëndrit);
- **Nusja nëpër shtëpi:** (Nusja në shtëpinë e burrit);
- **Hapja e qeizit:** (Në ditën e dasmës, pasi merret nusja, shpalosen gjësendet e saj të punuara gjatë fejesës dhe ekspozohen);
- **Darkat e lamës:** (Darkë e organizuar me përfundimin e të korrave në fund të vjeshtës);
- **Djergat:** (Darka e organizuar për nder të djergjes nga bjeshka në fund të sezonit);
- **Qethja e dhenve:** (Në bjeshkë, në mënyrë të organizuar bëhet qethja e deleve);
- **Vjelja e gështenjës:** (Në vjeshtë bëhet mbledhja e gështenjës për nevojat familjare dhe për shitje);
- **Mbledhja e boronicës:** (Në bjeshkë mbledhet boronica për nevojat familjare dhe për shitje);
- **Shëngjergji:** (Festë tradicionale që organizohet në muajin maj);
- **29 Maji (fillimi frontal i luftës):** (Datë e shënuar për nder të ditës kur banorët e Junikut u organizuan në vetëmbrojtje nga forcat serbe);
- **Kositja – cokatja:** (Bari i rritur prehet me kosë);
- **Me nu sonën në mullar:** (Bari i prerë dhe i terur grumbullohet në mullar për ruajtje për sezonin e dimrit);
- **E pamja:** (Për ditët mortore organizohet e pamja. Mblidhen burra nëpër oda për disa ditë për të shprehur ngushëllime të afërmeve të të ndjerit);
- **Përhajre:** (Organizim për nder të një ngjarjeje të gëzueshme);
- **Përrallat:** (Krijimtari gojore popullore me përmbajtje fantastike dhe personazhe të trilluar);
- **Ninullat:** (Këngë për vendosjen e fëmijëve në gjumë);
- **Qilimet (të shtatat):** (Drekë e organizuar për nder të të vdekurit);
- **Lojra tradicionale:** (Lojra që zhvillojnë shkathtësinë fizike dhe mendore);
- **Loja me instrumente:** (Me instrumente të ndryshme krijohen tinguj muzikorë);
- **Punimi i instrumenteve muzikore:** (Zanatë që merret me punimin e instrumenteve muzikore);
- **Loja tradicionale:** [Kontrollo nëse është ndryshe nga "Lojra tradicionale"];
- **Kut e klic, kapuqa, cic mic, guralec, gugjaz, vizak, llastik, me krropnajë, shofa qok, ngile, nermje dy zjemav, Pam-pam, gropaz – me guracek, shtaga sorrash, Giqi-Giqi:** (Lojra të organizuara në oda dhe ambiente të jashtme, të luajtura nga të rinjtë);
- **Nisja e dasmës:** (Ngjarja fillon me pritjen dhe grumbullimin e dasmorëve në oda dhe shtëpi);
- **Mbulimi i stanit me qetina:** (Degë halore);
- **Djedia e dulliave:** (Paralajmëron ardhjen e pranverës në Ditën e Verës);
- **Zhdjergat:** (Darkë me bylmetin e sjellur nga bjeshka);
- **Dreka e postermës:** (Organizohet një herë në vit pas therjes së kafshës);
- **Darka e postermës:** (Me therjen e gjedhës organizohet darkë);
- **Ngjitja në bjeshkë:** (Fillimisht me kafshë, pastaj me familje);
- **Mbledhja e fasules:** (Me dorë në vjeshtë për nevoja familjare dhe shitje);
- **Korrja e arës:** (Me drapër dhe bartje me qerre në pozllome);
- **Kërimi i kallamoqit:** (Qërimi i kallamoqit dhe ruajtja e tallës për kafshë);
- **Mbledhja e sanës (terja):** (Pas kositjes bari thahet dhe ruhet në lamë);
- **Vendosja në sanë:** (Sana e tharë paloset në mullar);
- **Lidhja e dujve të tallës me thupra:** (Pas korrjes, lidhja bëhet për bartje);
- **Lnurja e leshit:** (Pastrimi fillestar në vajejica);
- **Shkelja e zhgunave:** (Faza e dytë e pastrimit dhe lidhjes së fijeve);
- **Punimi i pëlhurës – në vek:** (Fijet ndërldihen dhe rrihen në vek);
- **Shalla e marhamë:** (Pjesë e veshjes së katundit);
- **Qorapet – thurja:** (Thurje me dorë me krrabez);

- **Jeleku – thurja:** (I punuar me dorë);
- **Kamzat – qepja:** (Pjesë e veshjes së katundit);
- **Meselet – tregimi:** (Anekdota);
- **Rrotullat – tregimi:** (Anekdotë e ndërlidhur me një ngjarje);
- **Punimi i djepit:** (Mjet për vendosjen në gjumë të fëmijës);
- **Qërorja e kallamojt:** (Qërimi në vjeshtë pas korjes).

Ushqimet tradicionale

- **Përpunimi i mazës:** (Me grumbullimin e mazës bëhet tundja dhe merret tlyeni);
- **Pitja:** (Ushqim i gatuar në tepsi me petë të pjekura me mazë);
- **Flija:** (Brumë gruri i shtresuar dhe i pjekur me saç);
- **Tespište – e kallamojt:** (Brumë i kallamojt i përzier me mazë dhe pjekur, pastaj ulet me sherbet);
- **Laknor i kallamojt:** (Brumë i kallamojt i përgatitur me mazë dhe i pjekur);
- **Perpeq (me qull):** (Përgatitur me djathë dhe brumë të kallamojt dhe grurit, i pjekur në furrë ose qerep);
- **Zanja e djathit:** (Tomli ngrohet në 40°C, shtohet fara e djathit, pasi të trashet masa kullohet dhe shtypet);
- **Zanja e kumshtit:** (Nga zierja e hirres);
- **Hirra:** (Nxirret nga kullimi i djathit);
- **Kosi:** (Përgatitet duke zier tomlin, ftohet në temp rreth 50°C, duke shtuar farën e kosit).
- **Gjiza:** (Produkt i qumështit);
- **Trofta e Erenikut (e egër):** (Peshk me karakteristika të veçanta që përdoret si ushqim);
- **Lakna me lugë:** (Lloj lakre që përgatitet me tomel dhe mazë duke u zier);
- **Mish me lakna:** (Ushqim i dimrit me mish të postermës dhe lakra);
- **Resenik:** (Pite me lakra);
- **Bukë misri me lëng:** (Buka e kallamojt piqet dhe servohet me lëng djathi);
- **Sharuk:** (Bukë e kallamojt e përzier me djathë dhe shtypur në formë topti);
- **Përshesh me tamël:** (Buka e misrit zihet në tomel);
- **Përshesh me tlana:** (Buka e kallamojt përzihet me mbetjet e tepsisë pas ndarjes së mazës);
- **Përshesh me kos:** (Buka e kallamojt përzihet me kos);
- **Mazë e zier:** (Mazë e zier me miell të kallamojt);
- **Tlyeni (përgatitja):** (Ndarja e yndyrës nga maza);
- **Llomi:** (Mbetja nga ndarja e yndyrës nga maza);
- **Tundja e mazës:** (Përzihet derisa ndahet yndyra nga mbetja);
- **Kosi i kulluar:** (Nga ky produkt nxirret hirra duke u larguar masa e lëngshme).

Kapitulli 4

Analiza “SWOT” për Trashëgiminë Kulturore të Junikut

Ky kapitull paraqet rezultatet e analizave “SWOT” (Perparësitë, Dobësitë, Mundësitë dhe Kërcënimet) për trashëgiminë kulturore të Junikut, duke u fokusuar në katër fusha kryesore: Mbrojtjen dhe Menaxhimin, Edukimin, Zhvillimin Ekonomik dhe Promovimin. Analizat SWOT ofrojnë një kuadër të rëndësishëm për të kuptuar gjendjen aktuale të trashëgimisë kulturore dhe për të identifikuar strategjitë më efektive për zhvillimin e saj të qëndrueshëm.

4.1. Mbrojtja dhe Menaxhimi i Trashëgimisë Kulturore:

Përparësitë:

- Prezenca fizike e monumenteve.
- Fonde për infrastrukturë.
- Qasje e lehtë nëpër lokalitete.
- Pozicioni gjeografik.

Dobësitë:

- Kullat e mbyllura për publikun.
- Kullat e menaxhuara sipas preferencave politike partiake.
- Ndërtime të larta afër kullave.
- Mospërputhje e ndërtimeve të reja me arkitekturën tradicionale.
- Mospërfillje e marrëveshjeve rajonale për menaxhimin e kullave.
- Mungesë koordinimi në investimet nga organizatat ndërkombëtare.
- Mospërcaktim i kompetencave për mbrojtje dhe menaxhim në nivel lokal dhe qendror.
- Mungesë e mirëmbajtjes së monumenteve.
- Mungesë e iniciativave për shfrytëzimin e monumenteve.

Mundësitë:

- Krijimi i një komisioni për monitorimin e gjendjes.
- Mbështetje për pronarët e kullave.
- Hapja e kullave për publikun me mbështetje nga komunat.
- Evidentimi i të gjitha monumenteve.
- Klasifikimi i monumenteve sipas qëllimeve të shfrytëzimit.
- Hartimi i udhëzuesit për harmonizimin e ndërtimeve të reja me arkitekturën ekzistuese.

Kërcënimet:

- Ndërtimet e reja afër kullave.
- Humbja e aseteve të trashëgimisë.
- Ndërtimet pa leje.
- Rrëzimi i objekteve të trashëgimisë.

4.2. Edukimi:

○ Përparësitë:

- Infrastruktura shkollore.
- Kualifikimi i mësimeve.
- Qasje të drejtpërdrejtë në objektet e trashëgimisë kulturore.
- Organizimi i darkës së lames.
- Organizimi i ditëve të Gjeravicës.
- Organizimi i festive brenda dhe jashtë shkollës, ku nxënësit vallezojnë valle tradicionale.
- Lojërat tradicionale.

- Bukuritë natyrore.
- **Dobësitë:**
 - Mungesa e fondeve.
 - Mbështetja e pamjaftueshme institucionale.
 - Mungesa e informimit.
 - Mungesa e transparencës.
 - Mungesa e trajnimeve.
 - Mungesa e vullnetit për punë.
 - Ndikimet politike.
 - Qasja e kufizuara në ndërtesat e trashëgimisë kulturore.
- **Mundësitë:**
 - Lëndët zgjedhore: kampingu, figurat historike, vizita kullave, mulliri.
 - Edukata fizike: Ecje drejt malit.
 - Art figurative: Ekspozita e veshjeve, kullave etj.
 - Histori: Përgatitja e ciceronëve të rinj, “Kuvendi i Junikut”.
 - Gjuhë shqipe: Shkrimi letrar, këngët kreshnike.
- **Kërcënimet:**
 - Degradimi fizik dhe mungesa e mirëmbajtjes.
 - Ndërtimet e pakontrolluara.
 - Zhdukja e zakoneve.
 - Emigracioni.
 - Rreziqet nga zjarri.

4.3. Zhvillimi Ekonomik:

- **Peparësitë:**
 - Interesi në rritje për turizmin kulturor dhe natyror në Junik.
 - Prania e bizneseve lokale të gatshme për të investuar në turizëm.
 - Resurset natyrore tërheqëse të Bjeshkëve të Nemuna me theks të veçantë maja e Gjeravicës.
- **Dobësitë:**
 - Mungesa e kapaciteteve të bizneseve lokale për të ofruar shërbime turistike cilësore.
 - Infrastruktura e pamjaftueshme turistike (akomodimi, transporti, informacioni).
 - Mungesa e koordinimit midis bizneseve dhe institucioneve lokale.
- **Mundësitë:**
 - Zhvillimi i produkteve dhe shërbimeve turistike të bazuara në trashëgiminë kulturore dhe natyrore.
 - Ofrimi i trajnimeve dhe mbështetjes financiare për bizneset lokale.
 - Krijimi i partneriteteve me agjencitë turistike dhe operatorët e turizmit.
- **Kërcënimet:**
 - Konkurrenca nga destinacione të tjera turistike.
 - Mungesa e investimeve në infrastrukturën turistike.
 - Ndikimi negativ i turizmit të pakontrolluar në mjedis dhe kulturë.

4.4. Promovimi:

- **Perparësitë:**
 - Potenciali unik i trashëgimisë kulturore dhe natyrore të Junikut.
 - Traditat e forta kulturore dhe mikpritja.
 - Numri i vizitorëve në rritje (hiking, ski, etj.).
 - Angazhimi i komunitetit në promovimin e kulturës lokale.
- **Dobësitë:**
 - Mungesa e marketingut dhe promovimit të koordinuar.
 - Infrastruktura e pamjaftueshme turistike (informacion, akomodim, transport).
 - Mungesa e produkteve turistike të zhvilluara dhe të diversifikuara.
 - Mungesa e kapaciteteve dhe trajnimeve për turizmin kulturor.
- **Mundësitë:**
 - Zhvillimi i partneriteteve me agjenci turistike, media dhe influencues.
 - Përdorimi i platformave dixhitale dhe rrjeteve sociale për promovim.
 - Organizimi i festivaleve dhe ngjarjeve kulturore për të tërhequr vizitorë.
 - Krijimi i një marke unike për Junik si destinacion turistik kulturor.
- **Kërcënimet:**
 - Konkurrenca nga destinacione të tjera turistike.
 - Mungesa e investimeve në promovim dhe marketing.
 - Efektet negative të turizmit të pakontrolluar (ndikimi në mjedis dhe kulturë).
 - Mungesa e vëmendjes nga qeveria qendrore për promovimin e Junikut.

Kapitulli 5

Vizioni, Objektivat dhe Rezultatet e Pritura

Ky kapitull përcakton vizionin afatgjatë për trashëgiminë kulturore të Junikut, si dhe objektivat e përgjithshme dhe specifike që do të udhëheqin zbatimin e kësaj strategjie. Gjithashtu, përcaktohen rezultatet e pritura që do të shërbejnë si indikatorë për të matur suksesin e strategjisë.

Vizioni:

"Juniku, një qendër e gjallë e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, ku traditat e lashta bashkëjetojnë me zhvillimin e qëndrueshëm, duke ofruar një përvojë unike për vizitorët dhe duke siguruar një të ardhme të begatë për komunitetin."

Objektivat e Përgjithshme:

Kjo strategji synon të arrijë katër objektiva të përgjithshme, të cilat janë në përputhje me nevojat dhe mundësitë e identifikuara në analizat „SWOT“:

1. **Edukimi dhe Vetëdijësimi:** Të rritet edukimi dhe vetëdijësimi i komunitetit, veçanërisht i gjeneratës së re, për vlerat e trashëgimisë kulturore dhe rëndësinë e ruajtjes së saj.

2. **Mbrojtja dhe Menaxhimi:** Të përmirësohet mbrojtja dhe menaxhimi i trashëgimisë kulturore, duke siguruar ruajtjen e monumenteve, objekteve dhe praktikave tradicionale.
3. **Zhvillimi Ekonomik:** Të shfrytëzohet potenciali i trashëgimisë kulturore për të nxitur zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm, duke mbështetur turizmin kulturor, artizanatin lokal dhe sipërmarrjen.
4. **Promovimi:** Të promovohet Juniku si një destinacion unik turistik kulturor, duke tërhequr vizitorë vendas dhe të huaj dhe duke rritur njohjen e tij në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Objektivat Specifike dhe Rezultatet e Pritura:

Për të arritur objektivat e përgjithshme, janë përcaktuar një sërë objektivash specifike, së bashku me rezultatet e pritura që do të shërbejnë si indikatorë për të matur progresin.

1. Objektivi i Përgjithshëm: Edukimi dhe Vetëdijësimi

Objektivi Specifik 1.1: Integrimi i përmbajtjes së trashëgimisë kulturore në kurrikulat shkollore.

Rezultati i Pritur: Rritja e numrit të orëve mësimore kushtuar trashëgimisë kulturore me [100] për qind.

Objektivi Specifik 1.2: Organizimi i aktiviteteve edukative dhe vetëdijësuese për publikun e gjerë.

Rezultati i Pritur: Organizimi i të paktën pesë aktiviteteve edukative në vit, duke përfshirë leksione, seminare, vizita në monumente, dhe ekspozita.

Objektivi Specifik 1.3: Krijimi i materialeve promovuese dhe informative për trashëgiminë kulturore.

Rezultati i Pritur: Publikimi i dy broshurave, fletushkave, dhe materialeve të tjera promovuese në vit, si dhe krijimi i një faqeje interneti të dedikuar për trashëgiminë kulturore të Junikut.

2. Objektivi i Përgjithshëm: Mbrojtja dhe Menaxhimi

Objektivi specifik 2.1: Hartimi i një plani të detajuar për mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e monumenteve kulturore.

Rezultati i Pritur: Hartimi i planit deri në TM1 2027 dhe fillimi i zbatimit të tij deri në 2030.

Objektivi Specifik 2.2: Hartimi i një plani të detajuar për mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e monumenteve kulturore.

Rezultati i Pritur: Hartimi i planit deri në TM1 2027 dhe fillimi i zbatimit të tij deri në 2030.

Objektivi Specifik 2.3: Sigurimi i fondeve të nevojshme për restaurimin dhe konservimin e monumenteve.

Rezultati i Pritur: Alokimi i 20,000.00 euro fonde në vit për restaurimin dhe konservimin e monumenteve.

Objektivi Specifik 2.3: Përmirësimi i infrastrukturës rreth monumenteve kulturore.

Rezultati i Pritur: Asfaltimi i rrugëve, ndriçimi, dhe vendosja e sinjalistikës, zonimi, digjitalizimi turistik i rreth 15 monumenteve.

Objektivi Specifik 2.4: Hartimi i projektit për muzeun dhe implementimi i tij për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë së luajtshme.

Rezultati i Pritur: Alokimi i 50,000.00 euro fonde për projektim dhe ndertim (adaptim) të objektit deri në vitin 2027.

3. Objektivi i Përgjithshëm: Zhvillimi Ekonomik

Objektivi Specifik 3.1: Mbështetja e bizneseve lokale që ofrojnë produkte dhe shërbime të lidhura me trashëgiminë kulturore.

Rezultati i Pritur: Ofrimi i granteve dhe trajnimeve për tetë biznese në vit.

Objektivi Specifik 3.2: Zhvillimi i produkteve turistike të reja të bazuara në trashëgiminë kulturore.

Rezultati i Pritur: Krijimi i tetë pakove turistike të reja që përfshijnë vizita në monumente kulturore, shfaqje të traditave, dhe degustime të produkteve lokale.

Objektivi Specifik 3.3: Nxitja e artizanatit lokal dhe prodhimit të suvenireve me motive tradicionale.

Rezultati i Pritur: Organizimi i kurseve të trajnimit për artizanët dhe krijimi i një dyqani për shitjen e produkteve artizanale.

4. Objektivi i Përgjithshëm: Promovimi

Objektivi Specifik 4.1: Zhvillimi i një strategjie të marketingut për promovimin e Junikut si destinacion turistik kulturor.

Rezultati i Pritur: Hartimi i strategjisë deri në TM3, 2026 dhe fillimi i zbatimit të saj deri në 2030.

Objektivi Specifik 4.2: Përdorimi i rrjeteve sociale dhe platformave dixhitale për promovimin e trashëgimisë kulturore.

Rezultati i Pritur: Rritja e numrit të ndjekësve në rrjetet sociale me [100] për qind dhe rritja e vizitave në faqen e internetit me [100] për qind.

Objektivi Specifik 4.3: Organizimi i festivaleve dhe ngjarjeve kulturore për të tërhequr vizitorë.

Rezultati i Pritur: Organizimi i tri festivaleve dhe ngjarjeve kulturore në vit, me një pjesëmarrje të përgjithshme prej 2000 vizitorësh.

Kapitulli 6

Plani i Veprimit

Ky kapitull paraqet planin e veprimit të detajuar për zbatimin e Strategjisë Kulturore të Junikut. Plani i veprimit përcakton aktivitetet konkrete që do të ndërmerren për të arritur objektivat specifike të përcaktuara në Kapitullin 5, si dhe afatet kohore, përgjegjësitë, burimet e nevojshme dhe indikatorët e suksesit për secilin aktivitet.

Plani i veprimit është i organizuar sipas objektivave të përgjithshme të strategjisë dhe ofron një kuadër të qartë për të udhëhequr punën e të gjithë aktorëve të përfshirë në zbatimin e strategjisë.

Objektivi i Përgjithshëm 1: Edukimi dhe Vetëdijësimi

Objektivi Specifik	Aktiviteti Kryesor	Afati Kohor	Buxheti komunal	Buxheti nga donatorët	Përgjegjësi Kryesore	Burimet e Nevojshme	Indikatorët e Suksesit
1.1. Integrimi i përmbajtjes së trashëgimisë kulturore në kurrikulat shkollore.	1.1.1. Zhvillimi i moduleve mësimore për trashëgiminë kulturore.	TM3 2026	500.00	10,000.00	Ministria e Arsimit, Komuna e Junikut, Mësuesit.	Ekspertë të trashëgimisë kulturore, fonde për materiale mësimore.	Numri i shkollave që përdorin modulet e reja, vlerësimi i njohurive të nxënësve.
	1.1.2. Trajnimi i mësuesve për përdorimin e moduleve të reja.	TM1 2027	300.00	10,000.00	Qendra e Trajnimit të Mësuesve, Komuna e Junikut.	Trajnerë të specializuar, fonde për trajnim.	Numri i mësuesve të trajnuar, vlerësimi i aftësive të mësuesve për të mësuar për trashëgiminë.
1.2. Organizimi i aktiviteteve edukative dhe vetëdijësuese për publikun e gjerë.	1.2.1. Organizimi i ligjeratave dhe seminareve për trashëgiminë kulturore.	TM2, TM3, TM4 2027, 2028	500.00	12,000.00	Komuna e Junikut, Organizatat Joqeveritare.	Folës të ftuar, lokale për aktivitetet, fonde për promovim.	Numri i pjesëmarrësve në лекsione dhe seminare, vlerësimi i njohurive të pjesëmarrësve.
	1.2.2. Organizimi i vizitave në monumentet kulturore.	TM2, TM3, TM4 2027, 2028	500.00	8,000.00	Shkollat, Komuna e Junikut, Agjencitë Turistike Lokale.	Transport, guida turistike, bileta hyrëse (nëse ka).	Numri i vizitave të organizuara, numri i pjesëmarrësve në vizita, vlerësimi i kënaqësisë së pjesëmarrësve.
1.3. Krijimi i materialeve promovuese dhe informative për trashëgiminë kulturore.	1.3.1. Hartimi dhe botimi i broshurave dhe fletushkave për monumentet.	TM 2027; TM4 2028; TM4 2029	1,000.00	15,000.00	Komuna e Junikut, Ekspertë të trashëgimisë kulturore.	Dizajner grafik, shtypshkronjë, fonde për botim.	Numri i broshurave dhe fletushkave të shpërndara, vlerësimi i cilësisë së materialeve.
	1.3.2. Krijimi i një faqeje interneti të dedikuar për trashëgiminë.	TM3 2026	200.00	9,000.00	Komuna e Junikut, Kompania e Dizajnit të Faqeve Ëeb.	Dizajner ëeb, server, fonde për mirëmbajtje.	Numri i vizitorëve në faqen e internetit, vlerësimi i përmbajtjes dhe dizajnit të faqes.

Objektivi i Përgjithshëm 2: Mbrojtja dhe Menaxhimi

Objektivi Specifik	Aktiviteti Kryesor	Afati Kohor	Buxheti komunal	Buxheti nga donatorët	Përgjegjësi Kryesore	Burimet e Nevojshme	Indikatorët e Suksesit
2.1. Hartimi i një plani të detajuar për mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e monumenteve kulturore.	2.1.1. Angazhimi i ekspertëve për vlerësimin e gjendjes së monumenteve.	TM1 2026	200.00	16,000.00	Komuna e Junikut, Instituti i Mbrojtjes së Monumenteve.	Ekspertë të arkitekturës, inxhinierisë, restaurimit, fonde për konsulencë.	Numri i monumenteve të vlerësuar, cilësia e raporteve të vlerësimit.
	2.1.2. Zhvillimi i një plani të detajuar të konservimit dhe restaurimit.	TM3 2026	500.00	65,000.00	Komuna e Junikut, Instituti i Mbrojtjes së Monumenteve, Pronarët e monumenteve.	Udhëzime dhe standarde të konservimit, fonde për hartimin e planit.	Plani i miratuar nga Këshilli Komunal, përfshirja e të gjitha monumenteve të rëndësishme, specifika e aktiviteteve dhe buxhetit.
2.2. Sigurimi i fondeve të nevojshme për restaurimin dhe konservimin e monumenteve.	2.2.1. Aplikimi për grante nga burime vendore dhe ndërkombëtare.	Vazhdimisht	500.00	10,000.00	Komuna e Junikut, Pronarët e monumenteve, Organizatat Joqeveritare.	Informacioni mbi programet e granteve, dokumentacioni i nevojshëm për aplikim, ekspertë për shkrimin e propozimeve.	Shuma e fondeve të siguruar, numri i projekteve të financuara.
	2.2.2. Alokimi i fondeve nga buxheti komunal për restaurimin dhe konservimin.	Çdo vit	500.00	400,000.00	Komuna e Junikut, Departamenti i Financave.	Buxheti i planifikuar, procesi i vendimmarrjes transparent, mbështetje politike.	Shuma e fondeve të alokuara, zbatimi i buxhetit të planifikuar, efikasiteti i shpenzimeve.
2.3. Përmirësimi i infrastrukturës rreth monumenteve kulturore.	2.3.1. Ndërtimi/Rikonstruimi i rrugëve të qasjes dhe shtigjeve për këmbësorë.	TM2 2027	10,000.00	500,000.00	Komuna e Junikut, Departamenti i Infrastrukturës, Kompanitë e ndërtimit.	Plani i detajuar i ndërtimit, lejet e nevojshme, fonde për ndërtim, mbikëqyrje e punimeve.	Gjendja e rrugëve dhe shtigjeve, numri i vizitorëve, siguria e qasjes.
	2.3.2. Vendosja e ndriçimit adekuat për të theksuar monumentet gjatë natës.	TM4 2027	15,000.00	150,000.00	Komuna e Junikut, Kompania e Energjisë Elektrike, Kompanitë e ndriçimit.	Plani i ndriçimit, pajisjet e ndriçimit, fonde për instalim dhe mirëmbajtje, lejet e nevojshme.	Numri i monumenteve të ndriçuara, cilësia e ndriçimit, efikasiteti energjetik.
	2.3.3. Instalimi i sinjalistikës	TM1 2028	2,500.00	25,000.00	Komuna e Junikut, Agjencia për	Dizajni i sinjalistikës,	Numri i tabelave të

Objektivi Specifik	Aktiviteti Kryesor	Afati Kohor	Buxheti komunal	Buxheti nga donatorët	Përgjegjësi Kryesore	Burimet e Nevojshme	Indikatorët e Suksesit
	turistike për të udhëzuar vizitorët drejt monumenteve.				Zhvillim Turistik, Kompanitë e sinjalistikës.	materialet e sinjalistikës, fonde për prodhim dhe instalim, lejet e nevojshme.	vendosura, qartësia dhe informacioni i sinjalistikës, vlerësimi i përdorimit nga vizitorët.
2.4 Parandalimi i ndërtimeve pa leje dhe harmonizimi i ndërtimeve të reja me arkitekturën tradicionale	Inspektimi rigorozi i territorit	Vazhdimisht	0.00	0.00	Komuna e Junikut, DSHPIMSH-Inspektorati Ndërtimor.	Logjistika, paga për inspektorët dhe automjetet.	Numri i ndërtimeve pa leje të ndaluara. Raporti mes ndërtimeve të vjetra dhe të reja.

Objektivi i Përgjithshëm 3: Zhvillimi Ekonomik

Objektivi Specifik	Aktiviteti Kryesor	Afati Kohor	Buxheti komunal	Buxheti nga donatorët	Përgjegjësi Kryesore	Burimet e Nevojshme	Indikatorët e Suksesit
3.1. Mbështetja e bizneseve lokale që ofrojnë produkte/shërbime kulturore.	3.1.1. Shpallja e thirrjeve për propozime projektesh për bizneset.	TM2 2026	500.00	300,000.00	Komuna e Junikut, Qeveria e Kosovës	Kriteret e vlerësimit, formulari i aplikimit, fondet për grante.	Numri i aplikacioneve të marra, shuma e kërkuar e financimit, diversiteti i ideve.
	3.1.2. Vlerësimi dhe përzgjedhja e projekteve fituese.	TM3 2026	0.00	0.00	Komisioni i Vlerësimit, ekspertë të jashtëm.	Ekspertë për vlerësimin e planeve të biznesit, kritere të qarta përzgjedhjeje.	Numri i projekteve të financuara, shuma totale e granteve të dhëna, vlerësimi i potencialit të ndikimit.
	3.1.3. Monitorimi i zbatimit të projekteve dhe vlerësimi i rezultateve.	Vazhdimisht	0.00	10,000.00	Qeveria e Kosovës, Komuna e Junikut.	Vizita në terren, raporte periodike, kritere për matjen e suksesit.	Numri i vendeve të punës të krijuara, rritja e të ardhurave të bizneseve, numri i vizitorëve të tërhequr,

Objektivi Specifik	Aktiviteti Kryesor	Afati Kohor	Buxheti komunal	Buxheti nga donatoret	Përgjegjësi Kryesore	Burimet e Nevojshme	Indikatorët e Suksesit
							vlerësimi i kënaqësisë së klientëve.
3.2. Zhvillimi i produkteve turistike të reja të bazuara në trashëgiminë kulturore.	3.2.1. Organizimi i punësorëve me aktorët lokalë për identifikimin e produkteve të reja.	TM1 2027	300.00	25,000.00	Komuna e Junikut, Institucionet relevante, Ekspertë.	Facilitatorë, materiale për punëtorë, lokale, fonde për organizim.	Numri i ideve të gjeneruara, vlerësimi i potencialit të tyre për treg.
	3.2.2. Pilotimi i produkteve të reja turistike.	TM3 2027	500	40,000.00	Komuna e Junikut, Institucionet relevante	Fonde për marketing, trajnime, infrastrukturë e vogël (nëse nevojitet), vullnetarë.	Numri i vizitorëve që provojnë produktet e reja, vlerësimi i reagimeve të vizitorëve, identifikimi i përmirësimeve të nevojshme.
3.3. Nxjtja e artizanatit lokal dhe prodhimit të suvenireve me motive tradicionale.	3.3.1. Ofrimi i trajnimeve falas për artizanët në teknika tradicionale dhe moderne.	TM2 2026	500	30,000.00	Qendra e Trajnimeve Profesionale, Artizanët e njohur.	Mjeshttra, materiale, lokale për trajnim, certifikata.	Numri i artizanëve të trajnuar, vlerësimi i aftësive të reja të fituara, numri i produkteve të reja të krijuara.
	3.3.2. Krijimi i një platforme online dhe offline për shitjen e produkteve artizanale.	TM4 2026	Sherbime nga personeli Komunal	20,000.00	Komuna e Junikut, Bizneset Lokale, Artizanët.	Dizajner ëb, ambient për dyqan, sistem pagese online, marketing.	Numri i produkteve të listuara, numri i shitjeve të realizuara, vlerësimi i kënaqësisë së klientëve, rritja e të ardhurave të artizanëve.

Objektivi i Përgjithshëm 4: Promovimi

Objektivi Specifik	Aktiviteti Kryesor	Afati Kohor	Buxheti komunal	Buxheti nga donatoret	Përgjegjësi Kryesore	Burimet e Nevojshme	Indikatorët e Suksesit
4.1. Zhvillimi i një strategjie marketingu për promovimin e Junikut.	4.1.1. Kryerja e një studimi të tregut për të identifikuar audiencën dhe kanalet e promovimit.	TM2 2026	500.00	10,000.00	Agjencia e Marketingut, Komuna e Junikut, Ekspertë të Jashtëm.	Fondet për studim, anketa, analiza të të dhënave, ekspertë.	Identifikimi i audiencës së synuar, përcaktimi i mesazheve kryesore, zgjedhja e kanaleve më

Objektivi Specifik	Aktiviteti Kryesor	Afati Kohor	Buxheti komunal	Buxheti nga donatore t	Përgjegjësi Kryesore	Burimet e Nevojshme	Indikatorë t e Suksesit
							efektive të promovimit.
	4.1.2. Hartimi i një plani të detajuar të marketingut.	TM3 2026	Sherbim nga personeli Komunal	5,000.00	Agjencia e Marketingut, Komuna e Junikut.	Të dhënat e studimit të tregut, kreativitet, buxhet i marketingut.	Plani i marketingut i miratuar, përcaktimi i objektivave SMART, buxheti i detajuar, kalendari i aktiviteteve.
4.2. Përdorimi i rrjeteve sociale për promovimin e trashëgimisë.	4.2.1. Krijimi i profileve tërheqëse në rrjetet sociale më të përdorura.	TM4 2026	200	3,000.00	Agjencia e Marketingut, Komuna e Junikut, Vullnetarë.	Ekspertë të rrjeteve sociale, krijues të përmbajtjes (foto, video, tekst).	Numri i ndjekësve, angazhimi i përdoruesve (pëlqime, komente, shpërndarje), arritja e postimeve.
	4.2.2. Postimi i rregullt i përmbajtjes cilësore për trashëgiminë kulturore.	Vazhdimisht	Sherbim nga personeli Komunal	2,000.00	Agjencia e Marketingut, Komuna e Junikut, Vullnetarë.	Kalendari editorial, foto dhe video cilësore, histori tërheqëse.	Frekuenca e postimeve, diversiteti i përmbajtjes, vlerësimi i ndikimit në ndërgjegjësimin e publikut.
4.3. Organizimi i festivaleve dhe ngjarjeve kulturore.	4.3.1. Hartimi i një kalendari vjetor të festivaleve dhe ngjarjeve kulturore.	TM1 2026	Sherbim nga personeli Komunal	1,000.00	Komuna e Junikut, Organizatat Kulturore Lokale, Sponsorët.	Lokale, fondet për organizim, artistë, logjistika.	Numri i festivaleve dhe ngjarjeve të organizuara, diversiteti i aktiviteteve, pjesëmarrja e komunitetit.
	4.3.2. Promovimi i festivaleve dhe ngjarjeve nëpërmjet mediave dhe kanaleve të tjera.	Përpara dhe gjatë çdo ngjarjeje	200.00	35,000.00	Komuna e Junikut, Organizatat Kulturore Lokale, Agjencia e Marketingut.	Materiale promovuese, kontakte me media, buxhet për reklamim.	Numri i artikujve dhe reportazheve në media, numri i pjesëmarrësve, vlerësimi i ndikimit ekonomik dhe kulturor.
4. 4 Promovimi i Junikut me anë të personaliteteve të njohura	Kontaktimi i personave me influencë si blogger, këngëtar, artist etj	Vazhdimisht	400.00	25,000.00	Komuna e Junikut Agjencia turistike	Buxhet për të ftuar	Numri I postimeve, storieve, artikujve, rritja e ndjekësve në rrjetet sociale dhe vizitorëve

Kapitulli 7

Monitorimi dhe Vlerësimi

Ky kapitull përshkruan procesin e monitorimit të zbatimit të Planit për trashigëminë Kulturore 2025-2030 dhe vlerësimin e rezultateve të saj. Monitorimi dhe vlerësimi do të sigurojnë që Plani të jetë në rrugën e duhur, që burimet të përdoren në mënyrë efektive, dhe që të bëhen përshtatjet e nevojshme për të arritur objektivat e përcaktuara.

7.1. Korniza e Monitorimit:

Indikatorët Kyç të Performancës : Numri i orëve mësimore kushtuar trashëgimisë kulturore në shkolla.

- Numri i aktiviteteve edukative të organizuara.
- Numri i vizitorëve në monumentet kulturore.
- Shuma e fondeve të investuara në restaurimin e monumenteve.
- Numri i bizneseve të mbështetura përmes granteve dhe trajnimeve.
- Numri i turistëve që vizitojnë Junikun.
- Numri i ndjekësve në rrjetet sociale.
- Numri i produkteve artizanale të shitura.

Burimet e të Dhënave:

- Regjistrat shkollorë.
- Raportet e aktiviteteve nga organizatat kulturore.
- Statistikat e turizmit.
- Raportet financiare të komunës.
- Të dhënat e rrjeteve sociale.
- Anketat me vizitorë dhe banorë.

Metodat e Mbledhjes së të Dhënave Rishikimi i dokumenteve.

- Anketat.
- Intervistat.
- Vëzhgimet.
- Analiza e të dhënave nga platformat dixhitale.

Afatet kohore Mbledhjes së të Dhënave:

- Çdo tremujor.
- Çdo gjashtëmujor.
- Çdo vit.

7.2. Procesi i Vlerësimit:

Analiza e të Dhënave:

- Krahاسimi i të dhënave me objektivat e përcaktuara.
- Identifikimi i tendencave dhe modeleve.
- Analiza statistikore.

Raportimi:

- Raporte gjashtëmujore për Kabinetin e Kryetarit të Komunës dhe Kuvendin Komunal.
- Raporte vjetore për publikun e gjerë.
- Prezantime publike.

Përgjegjësitë:

- Komuna e Junikut (DAKRS, DZHE).
- Një komision i pavarur monitorues.
- Ekspertë të jashtëm.

7.3. Përshtatja dhe Përmirësimi:

- **Rishikimi i Planit:**
 - Çdo dy vjet.
 - Në fund të periudhës së planit.
- **Përshtatjet:**
 - Rishikimi i objektivave.
 - Rialokimi i burimeve.
 - Ndryshimi i aktiviteteve.

Kapitulli 8

Tab.1. Monumentet arkitektonike me mbrojtje të përkohshme.

Emërtimi	Periudha	Statusi
Kulla e Sadik Shehut	Shek. XIX	Mbrojtje e përkohshme
Kulla e Jah Ymerit	Shek. XIX	Mbrojtje e përkohshme
Kulla e Brahim Hoxhës	Shek. XVIII	Mbrojtje e përkohshme
Kulla e Tafë Hoxhës	Shek. XIX	Mbrojtje e përkohshme
Kulla e Ram Zyber Krasniqit	Shek. XIX	Mbrojtje e përkohshme
Teqja e madhe amë e Tarikatit Alije - Halvetije në Junik	Shek. XX	Mbrojtje e përkohshme
Tyrbja e Dadës Hatë	Shek. XIX	Mbrojtje e përkohshme
Xhamia e Qokut	1580	Mbrojtje e përkohshme
Kulla e Rustë Zeqirit	Shek. XIX	Mbrojtje e përkohshme
Tyrbja e Sheh Osmanit	Shek. XIX	Mbrojtje e përkohshme
Kulla e Osmon Lollunit	Shek. XIX	Mbrojtje e përkohshme

Shkolla fillore “Edmon Hoxha”	Shek. XX	Mbrojtje e përkohshme
Kroni i Hoxhajve	Shek. XIX	Mbrojtje e përkohshme
Kulla e Kukajve	Shek. XIX	Mbrojtje e përkohshme
Kulla e Nur Shalës	Shek. XIX	Mbrojtje e përkohshme
Mulliri i Sallajve	Shek. XIX	Mbrojtje e përkohshme
Tyrbja e Dervish Hajdarit	Shek. XIX	Mbrojtje e përkohshme
Tyrbja e Dervish Sadikut	Shek. XIX	Mbrojtje e përkohshme
Kulla e Halit Hoxhës	Shek. XIX	Mbrojtje e përkohshme
Kështjella e Junikut - Gradina		Mbrojtje e përkohshme

Tab. 2. Pejsazhet kulturore me mbrojtje të përkohshme.

Emri	Periudha	Statusi
Liqejt e Gjeravicës		Mbrojtje e përkohshme
Moronica (park me pisha)		Mbrojtje e përkohshme
Kroni i Priftit		Mbrojtje e përkohshme

Shkurtesat:

DAKRS - Drejtoria për Arsim, kulturë, Rini dhe Sport

DZHE - Drejtoria për Zhvillim Ekonomik

DSHPIMSH - Drejtoria për Shërbime Publike Inspeksion Mbrojtje dhe Shpëtim

SWOT- (Strength-Perparësite, Wikeaknes-Dobësitë-, Opportunities-Mundësitë dhe Threats-Kërcënimet)

TM1-Tremujori i parë

TM2-Tremujori i dytë

TM3- Tremujori i tretë

TM4 -Tremujori i katërt



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLICA E KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTRETVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org. Unit	50-02
Nr. i Fajevë Pr. Stranica No. Pages	-03-
Nr. i Prot. Ibroj Prot. Prot. No.	5463-2/2r
Data:	20.08.25
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Kabineti i Ministrimit / Kabinet Ministra / Kabinet of the Minister

DATË/A:	15.08.2025
REFERENC-Ë:	25/5463/MMPHI
PËR/ZA/TO:	Komunat: Pejë, Istog, Klinë, Deçan dhe Junik
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Liburn Aliu, Ministër në detyrë i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka pranuar kërkesën nga Komunat: Pejë, Istog, Klinë, Deçan dhe Junik me nr.: 25/5463/423/DMM, dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

1. Vendimi për Pëlqim Mjedisor për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) për Planin Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM), për komunat e rajonit të Gjilanit dhe Ferizajt

Me respekt,

Faqe 1 nga 3

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://www.ks-gov.net/mmphi>, E-mail: zsp.mmphi@ks-gov.net



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit , Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Kabinet of the Minister

Ministri i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, duke u bazuar në nenin 93 paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 10 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr.7, 01 Mars 2019), nenin 11 paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, Nr.34/22 dt. 18.11.2022), Shtojcën 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive si dhe nenit 13 të Ligjit për Vlerësim Strategjik Mjedisor Nr. 03/L-230 (Gazeta Zyrtare Nr. 83/29 tetor 2010), nxjerr:

V E N D I M

APROVOHET kërkesa e Komunave: Pejë, Istog, Klinë, Deçan dhe Junik për paisje me Pëlqim Mjedisor për Vlerësimin Strategjik Mjedisor për Planin Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM), për komunat e rajonit të Dukagjinit.



Faqe 2 nga 3

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://www.ks-gov.net/mmphi>, E-mail: zsp.mmphi@ks-gov.net

Arsyetim

Gjatë shqyrtimit të kërkesës së Komunave: Pejë, Istog, Klinë, Deçan dhe Junik, Komisioni për shqyrtimin e Raporteve të VSM-së i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka konstatuar se Komunat: Pejë, Istog, Klinë, Deçan dhe Junik, kanë ofruar të gjitha dokumentet e parapara me Ligjin Nr. 03/L-230 për Vlerësim Mjedisor si dhe i ka përmbushur të gjitha obligimet tjera ligjore përfshirë organizimin e debateve publike, publikimin e Raporteve të VSM-së në ueb faqen e Komunave për komente dhe trajtimin e komenteve të marura nga palët e interesit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimin të të njëjtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Nr.: 25/5463/ /24 datë: 15.08.2025

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VSM
3. Inspektoratit të MMPHI-së
4. Zyrës të Sekretarit të Përgjithshëm
5. Kabinetit të Ministrit
6. Arkivi i MMPHI
7. Divizionit për komunikim me publikun
8. Komunave: Pejë, Istog, Klinë, Deçan dhe Junik

z. Liburn Aliu

Ministër në detyrë i Ministrisë së Mjedisit,
Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Faqe 3 nga 3



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
 KOMUNA JUNIK
 OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



REFERENC-Ë:	Numër: 02-07/25
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik
NGA/OD/FROM	Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik
DATË/A	29.08.2025
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Procesverbal

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut, dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, KK - Junik mbanë këtë:

PROCESVERBAL

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së tetë (08) të Kuvendit të Komunës së Junikut, me datë: 29.08.2025, duke filluar në ora 10:00. Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Junikut: z. Shpejtim Gacaferi: i cili në fillim përshëndeti, nënkryetarin e Komunës së Junikut z.Besart Tofaj, drejtorët e drejtorive komunale, anëtarët të Kuvendit Komunal, zyrtarët Komunal dhe gjithë të pranishmit me pas konstatoi se mbledhje marin pjesë të 10 anëtarët e kuvendit. Në mbledhje nga drejtorët prezent ishin: znj.Leonora Shehu AD,znj.Vjollca Qestaj-DBF,z.Jetmir Jasiqi-DEZH, z.Zenun Shala DUKM, z.Fatos Shala-DSHMS, z.Demokrat Ganiqaj-DSHPMSI.

Anëtarët prezent

- | | |
|---------------------------------------|--------------------------------------|
| 1. Shpejtim Gacaferi - Kryesues, LDK | 10. Rajmonda Krasniqi - Anëtare, AAK |
| 2. Sadri Krasniqi – Anëtar, LDK | 11. Erleta Qestaj - Anëtare, AAK |
| 3. Alfred Gaxherri - Anëtar, LDK | 12. Festina Maloku - Anëtare, AAK |
| 4. Mursel Salihaj-Anëtar,LDK | 13. Lulzim Gacaferi- Anëtar, LVV |
| 5. Ermelinda Lllolluni - Anëtare, LDK | 14. Eliza Pepshi-Anëtare,LVV |
| 6. Lirjeta Shehu - Anëtare, LDK | 15. Xhemë Tofaj-Anëtar LVV |
| 7. Leonard Lllolluni - Anëtar, AAK | |
| 8. Zenel Maloku - Anëtar, AAK | |
| 9. Dervish Bajraktari - Anëtar, AAK | |

Rendi i ditës i paraparë

1. Arsytimi i mungesave në mbledhje,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara,
3. Rishqyrtimi i Vendimit nr:02-180/4898 për zgjerimin e zonës urbane në Komunën e Junikut, miratua nga Kuvendi Komunal i Junikut, datë 27.06.2025,
4. Informatë rreth përgaditjeve për fillimin e vitit të ri shkollor 2025-2026,
5. Raport mbi fushatën e korrje-shirjeve në Komunën e Junikut,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i planit Ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave.
7. Miratimi i Deklaratës për Eliminimin e të gjitha Formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe në jetën publike,
8. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit, dhe
9. Të ndryshme

z.Leonard Lolluni, përshëndetje për të gjithë, kryesues unë për pikën e tretë (3) nuk kam material.

z.Shpejtim Gacaferi, këtë pikë e kemi shqyrtuar edhe në mbledhjen e kaluar, por sido qoftë materialin jau sjelli kur të vimë të ajo pikë, e qes në votim rendin e ditës me pikën shtesë, kush është për? për 9 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se rendi i ditës u miratua.

1. Arsytimi i mungesave në mbledhje,

Për këtë mbledhje munguan: z.Zenel Maloku-AAK, znj.Lirjeta Shehu-LDK, z.Alfred Gaxherri-LDK, z.Lulzim Gacaferi-LVV dhe z.Xhemë Tofaj-LVV, ndërsa znj.Festina Maloku pritet të vijë në mbledhje.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara,

z.Shpejtim Gacaferi, për mbledhjen e sotit i kemi në shqyrtim tri (3) procesverbale të muajve Maj, Qershor dhe Korrik, kërkesë nuk ka e qes në votim procesverbalin e Maj-2025, kush është për? për 9 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, e qes në votim procesverbalin e Qershorit-2025, kush është për, për 9 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, e qes në votim procesverbalin e Korrikut-2025, kush është për? për 9 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se procesverbalet për Maj, Qershor dhe Korrik 2025 u miratuan.

Gjatë përgaditjes së materialit për pikën e tretë të rendit të ditës në sallë arrin edhe znj.Festina Maloku, dhe tani në sallën e kuvendit janë prezent 10 anëtarët e kuvendit.

3. Rishqyrtimi i Vendimit nr:02-180/4898 për zgjerimin e zonës urbane në Komunën e Junikut, miratua nga Kuvendi Komunal i Junikut, datë 27.06.2025,

Aryetimin e rishqyrtimit të vendimit me nr.02-180/4898 e beri z.Shpejtim Gacaferi, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Komunës së Junikut. Kërkesë nuk ka, e qes në votim rishqyrtimin e Vendimit, kush është për? për 10 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se rishqyrtimi i vendimit me nr.02-180/4898 u miratua.

4. Informatë rreth përgaditjeve për fillimin e vitit të ri shkollor 2025-2026,

Informatën e beri z.Xhavit Velijaj- drejtor në DAKRS i cili fillimisht i përshëndeti të gjithë me pas informoi kuvendin lidhur me fillimin e vitit të ri shkollor 2025-2026.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë nuk ka, kalojmë në pikën e radhës së ditës.

5. Raport mbi fushatën e korrje-shirjeve në Komunën e Junikut,

Informatën e beri z.Besart Tofaj- nënkryetar i Komunës së Junikut, si kryesues i komisionit për korrje-shirje në komunën e Junikut, cili fillimisht i përshëndeti të gjithë me pas informoi kuvendin lidhur me korrje-shirjet në komunën e Junikut.

z.Shpejtim Gacaferi-pyetje nuk ka kalojmë në pikën e radhës të ditës.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i planit Ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave

Shqyrtimin dhe arsyetimin e planit ndërkomunal të menaxhimit të mbeturinave e bëri z.Demokrat Ganiqaj-drejtor në DSHPMISI i cili fillimisht i përshëndeti të gjithë me pas e arsyetoi planin ndërkomunal për menaxhimin e mbeturinave para anëtarëve të kuvendit.

z.Shpejtim Gacaferi, pyetje nuk ka, e qes në votim planin ndërkomunal për menaxhimin e mbeturinave, kush është për? për 10 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se plani ndërkomunal për menaxhimin e mbeturinave u miratua.

7. Miratimi i Deklaratës për Eliminimin e të gjitha Formave të Dhunës ndaj Grave në politikë dhe në jetën publike,

Shqyrtimin dhe arsyetimin e kësaj deklarate e bëri Kryesuesi i Kuvendit z.Shpejtim Gacaferi, meqë nuk pati asnjë pyetje rreth kësaj deklarate, e qes në votim kush është për? për 10 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se kjo deklaratë u miratua edhe nga Kuvendi i Komunës së Junikut.

8. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit

Pyetje nuk pati

9. Të ndryshme

Nuk pati asnjë çështje.

z.Shpejtim Gacaferi e shpalli te mbyllur mbledhjen e Gushtit-2025

Procesmbajtësi:
z. Esat Hoxha

Kryesuesi i Kuvendit:
z. Shpejtim Gacaferi

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA PEJË – OPŠTINA PEĆ – MUNICIPALITY PEJA

KOMUNA ISTOG – OPŠTINA ISTOG – MUNICIPALITY ISTOG

KOMUNA KLINË – OPŠTINA KLINA – MUNICIPALITY KLINA


KOMUNA DEÇAN – OPŠTINA DEĆANE – MUNICIPALITY DECAN

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK



VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR PËR

PLANIN NDËRKOMUNAL PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETURINAVE 2025-2035 PËR PESË KOMUNAT E RAJONIT TË DUKAGJINIT¹: PEJË, ISTOG, KLINË, DEÇAN DHE JUNIK



¹ Termi “Rajoni i Dukagjinit” në këtë dokument i referohet Zonës së Menaxhimit të Mbeturinave (ZMM) 3 – Pejë, të përcaktuar me Strategjinë për Menaxhimin e IntegrUAR të Mbeturinave në Kosovë (SMIMK) 2024-2035. ZMM 3 i përfshin qytetet Pejë, Istog, Klinë, Deçan dhe Junik.

Maj 2025

Mohim i përgjegjësisë

Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) për Planin Ndërkomunal të Menaxhimit të Integruar të Mbeturinave për komunitet e rajonit të Dukagjinit¹ është hartuar për zyrën e GIZ-it në Kosovë. Raporti është përgatitur në mënyrë të pavarur nga Lumnije Gashi-Shabani, eksperte e VSM-së. Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e vetme e ekspertes së VSM-së dhe në asnjë mënyrë nuk pasqyron pikëpamjet e zyrës së GIZ-it në Kosovë.

Regjistri i raportit

Titulli i projektit: Mbështetje në hartimin e raportit të Vlerësimit strategjik mjedisor për Planin ndërkomunal të mbeturinave të integruara në rajonin e Dukagjinit¹

Numri i projektit: PN 22.2123.2-001.00 – TN 83486378

Titulli i raportit: Vlerësimi strategjik mjedisor për Planin ndërkomunal të mbeturinave të integruara në rajonin e Dukagjinit¹ në Kosovë

Numri i raportit: 001

Rishikim	1
Data	Korrik 2025
Detajet	Komentimi në draft-PNMIM
Përgatitur nga	Lumnije Gashi Shabani
Asistuar nga	Aida Dobruna Vlerë Krasniqi
Kontrolluar nga	Vjollca Podvorica, GIZ Menaxhere e kontratës Drita Binaj, GIZ, Menaxhere e komponentës për menaxhim të mbeturinave
Pëlqimi nga	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Aprovuar nga	Kuvendi Komunal i Pejës Kuvendi Komunal i Istogut Kuvendi Komunal i Deçanit Kuvendi Komunal i Junikut Kuvendi Komunal i Klinës

TABELA E PËRMBAJTJES

I. HYRJE

- 1.1. Prapavija
- 1.2. Baza ligjore
- 1.3. Qëllimi i raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM)
- 1.4. Metodologjia për hartimin e raportit të VSM-së
- 1.5. Struktura e raportit të VSM-së

II. ASPEKTET PËRKATËSE TË GJENDJES AKTUALE TË MJEDISIT DHE OBJEKTIVAT E VSM-SË

- 2.1. Përshkrimi i gjendjes ekzistuese në mjedis
- 2.2. Analiza e çështjeve mjedisore dhe mundësive, të rëndësishme për Planin ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave (PNMIM);
- 2.3. Objektivat e VSM-së

III. PËRSHKRIMI I PËRMBAJTJES SË PNMIM-SË DHE OBJEKTIVAT E VSM-SË

- 3.1. Përshkrimi i përmbajtjes së PNMIM-së
- 3.2. Objektivat kryesore të PNMIM-së

IV. VLERËSIMI I EFEKTEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS SI RRJEDHOJË E ZBATIMIT TË AKTIVITETEVE TË PNMIM DHE MASAT LEHTËSUESE

- 4.1. Metodologjia e vlerësimit
- 4.2. Vlerësimi i përputhshmërisë së prioriteteve të PNMIM-së dhe efekteve të tyre me objektivat e VSM-së
- 4.3. Gjetjet kryesore mbi efektet e pritshme nga zbatimi i PNMIM-së
- 4.4. Masat e parapara lehtësuese

V. KORNIZA E MONITORIMIT

VI. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

ANEKSI 1. PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE

LISTA E SHKURTESAVE

OR	Oborret e Riciklimit
MND	Mbeturinat nga ndërtimi dhe demolimi
PH	Pikat e hedhjes
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
AM	Automjetet mbeturinë
EPR	Përgjegjësia e Zgjeruar e Prodhuesit
BE	Bashkimi Evropian
BPV	Bruto Produkti Vendor
GS	Gazrat Serrë
MRRSH	Mbeturinat e rrezikshme shtëpiake
IBA	Zonë e Rëndësishme për Shpendët
IHMK	Instituti Hydro-meteorologjik i Kosovës
MIM	Menaxhimi I integruar i mbeturinave
PMIM	Plani I Menaxhimit të integruar të Mbeturinave
PNMIM	Plani Ndër-Komunal i Menaxhimit të Integruar të Mbeturinave
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
SNK	Strategjia per Ndryshime Klimatike 2019-2028
KMDK	Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë
SMIMK	Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Kosovë
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
TMB	Trajtimi mekanik - biologjik
MSH	Ministria e Shëndetësisë
ORM	Objektet e Rikuperimit të Mbeturinave
PMMNK	Plani I Menaxhimit të Mbeturinave të Ngurta Komunale
PKMMND	Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbeturinave të Ndërtimit dhe Demolimit
OJQ	Organizata Jo - Qeveritare
VPRrP	Vlerësimi Paraprak i Rrezikut nga Përmbytjet
PNP	Parimi ndotësi paguan
KRM	Kompania Rajonale e Mbeturinave
VSM	Vlerësimi strategjik mjedisor
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
ITUZ	Impianti I trajtimit të ujërave të zeza
ST	Stacioni i Transferit
SHMM	Shërbimi I mbledhjes së mbeturinave
MPEE	Mbeturinat e pajisjeve elektrike dhe elektronike
OBSh	Organizata Botërore e Shëndetësisë
ZMM	Zona e Menaxhimit të Mbeturinave
MITUZ	Mbeturinat nga Impianti i Trajtimit të Ujërave të Zeza

LISTA E TABELAVE

Tabela1. Gjenerimi I mbeturinave në rajonin e Pejës, 2023

Tabela 2: Numri i ekonomive familjare dhe mbeturinave të gjeneruara

Tabela 3: Deponitë ilegale të mbeturinave

Tabela 4: Lista e florës së rrezikuar në komunat e rajonit të ZMM-stë ZMM-së

Tabela 5: Lista zonave të mbrojtura të natyrës

Tabela 6: Lista e burimeve ujore si zona të mbrojtura të natyrës

Tabela 7: Numri i trashëgimisë kulturore sipas kategorive nën mbrojtje

Tabela 8: Informacioni mbi kamionët për mbledhjen e mbeturinave

Tabela 9: Çështjet kryesore mjedisore dhe mundësitë dhe ndikimet e tyre të mundshme

Tabela 10: Objektivat e VSM-së

Tabela 11: Përbërja e mbeturinave

Tabela 12: Përmbledhje e sistemit të preferuar për sistemin e integruar të menaxhimit të mbeturinave të ngurta

Tabela 13: Projektet kryesore që do të zbatohen në nivel të rajonit dhe në komuna individuale

Tabela 14: Skenarët për zhvillimin e sistemit të integruar të menaxhimit të mbeturinave

Tabela 15: Kriteret e vlerësimit

Tabela 16: Vlerësimi i objektivave të VSM-së kundrejt prioritetit të PNMIM-it për parandalimin e mbeturinave

Tabela 17: Vlerësimi i objektivave të VSM-së kundrejt prioritetit të PNMIM-it për deponimin e mbeturinave

Tabela 18: Vlerësimi i objektivave të VSM-së kundrejt prioritetit të PNMIM-it për transportin dhe transportin e mbeturinave

Tabela 19: Vlerësimi i objektivave të VSM-së kundrejt prioritetit të PNMIM-it për transportin dhe krijimin e sistemeve të riciklimit dhe rikuperimit të mbeturinave

Tabela 20: Vlerësimi i objektivave të VSM-së kundrejt prioritetit të PNMIM-it për menaxhimin e mbeturinave bujqësore

Tabela 21: Vlerësimi i objektivave të VSM-së kundrejt prioritetit të PNMIM-it për menaxhimin e fraksioneve tjera të mbeturinave

Tabela 22: Vlerësimi i objektivave të VSM-së kundrejt prioritetit të PNMIM-it për fuqizimin e strukturës institucionale

Tabela 23: Përmbledhje e Efekteve të Mundshme Negative dhe Masave Zbutëse

Tabela 24: Plani i Monitorimit për zbatimin e masave zbutëse të identifikuar në VSM

LISTA E OF FIGURAVE

Figura 1: Harta e shfrytëzimit të tokës

Figura 2: Burimet e ujit të përdorura nga KRU “HidroDrini”

Figura 3: Vendbanimet me sistem publik të furnizimit me ujë të menaxhuar nga KRU Hidro-Drini

Figura 4: Vendbanimet me sistem publik të furnizimit me ujë të zeza të menaxhuara nga KRU Hidro-Drini

Figura 5: Komunikatë për shtyp “Disa fakte rreth mjedisit”

Figura 6: Raporti i përmytjeve në Kosovë: Zonat e ekspozuara ndaj rrezikut të mundshëm të përmytjeve në Kosovë

Figura 7: Zona e djegur nga zjarret në peizazhe në Kosovë, 2008-2023

Figura 8: Veprimet e propozuara gjatë periudhës 2025-2035

LISTA E KUTIVE

Kutia 1: Ligjet, strategjitë dhe dokumentet e tjera të rëndësishme për hartimin e raportit VSM-së

LISTA E HARTAVE

Harta 1: Hartë që ilustron deponinë ilegale të mbeturinave në ose në afërsi të trupave ujorë

Harta 2: Zonat e ekspozuara ndaj rrezikut të mundshëm nga përmytjet në Zonën e Menaxhimit të Mbeturinave 3 - Pejë (përfshihen Peja, Istogu, Klina, Deçani dhe Juniku) dhe deponitë ilegale të mbeturinave

Harta 3: Hartë që ilustron deponitë e paligjshme të mbeturinave në afërsi të zonave të djegura nga zjarret në peizazh

Harta 4: Deponia rajonale dhe deponitë ilegale në varësi të madhësisë së tyre në Zonën e Menaxhimit të Mbeturinave 3 - Pejë (përfshihen Peja, Istogu, Klina, Deçani dhe Juniku)

Harta 5: Paraqitja vizuale e zhvillimeve të planifikuara sipas PNMIM-it, duke nxjerrë në pah zonat potencialisht të ekspozuara ndaj përmytjeve, zjarreve dhe burimeve kryesore natyrore.

HYRJE

1.1. Prapavija

Ky Vlerësim Strategjik i Mjedisit (VSM) është realizuar për Planin ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave (PNMIM) për Zonën e Menaxhimit të Mbeturinave 3 - Pejë (përfshihen Peja, Istogu, Klina, Deçani dhe Juniku) në Kosovë, që përfshin komunat Pejë, Klinë, Istog, Deçan dhe Junik.

PNMIM është një nismë kyçe që synon të adresojë sfidat ekzistuese në sektorin e menaxhimit të mbeturinave duke promovuar një kalim drejt një sistemi të integruar, modern dhe të qëndrueshëm nga pikëpamja mjedisore. Duke njohur nevojën për qeverisje të përgjegjshme mjedisore, VSM siguron që ndikimet e mundshme të Planit të vlerësohen me kujdes dhe që mbrojtja e mjedisit të integrohet në procesin e marrjes së vendimeve që nga fillimi.

Qëllimi kryesor i VSM-së është të identifikojë, parashikojë dhe vlerësojë efektet e mundshme mjedisore të PNMIM-së dhe të propozojë masa që mund të zbusin ndikimet negative duke përforcuar rezultatet pozitive. Nëpërmjet këtij procesi, VSM promovon integrimin e konsideratave mjedisore në PNMIM-në dhe kontribuon në arritjen e objektivave më të gjera të Kosovës për zhvillim të qëndrueshëm, mbrojtje të mjedisit dhe përmirësim të shëndetit publik.

1.2. Baza ligjore

Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës (Neni 7) bazohet në parimet e mbrojtjes së mjedisit. Neni 52 përcakton përgjegjësitë e mëposhtme për Mjedisin:

- Natyra dhe biodiversiteti, mjedisi dhe trashëgimia kombëtare janë përgjegjësi e secilit;
- Autoritetet publike janë të përkushtuara të sigurojnë që çdo person të ketë mundësi të ndikojë në vendimet që prekin mjedisin e tij jetësor;
- Ndikimi në mjedis merret parasysh nga autoritetet publike në procesin e vendimmarrjes.

Baza ligjore e VSM-së është Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor Nr. 03/L-230, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2010. Ky ligj ka transpozuar parimet e direktivës së Bashkimit Evropian “Direktiva e Këshillit 2001/42/EC për vlerësimin e efekteve të disa planeve dhe programeve në mjedis”, e miratuar në vitin 2001, si dhe Ligjin Nr. 08/L-176 për plotësimin dhe ndryshimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me Ligjin Nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative (2023)

Përmes VSM-së të planeve, Ligji synon të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut, duke integruar parimet e mbrojtjes së mjedisit në procedurën e përgatitjes, miratimit dhe zbatimit të planit. Ligje të tjera të rëndësishme për hartimin e raportit të VSM-së të PNMIM-së janë paraqitur në kutinë më poshtë, të strukturuar sipas fushave tematike siç janë përcaktuar në ligjin për VSM: biodiversiteti, popullsia dhe shëndeti i njeriut, toka, uji, ajri dhe klima, peizazhi dhe trashëgimia kulturore dhe pasuritë materiale.

Kutia 1. Ligje, strategji dhe dokumente tjera të rëndësishme për hartimin e raportit të VSM

Ligje	Përshkrimi	Aspektet e VSM-së
Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit	Ligji rregullon sistemin e integruar për mbrojtjen e mjedisit, zvogëlimin e rrezikut për ndotjen e mjedisit, jetën dhe shëndetin e njeriut sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm. Qëllimi i këtij ligji është të promovojë krijimin e mjedisit të shëndetshëm për popullin e Kosovës me sjelljen graduale të standardeve për mjedis të	Të gjitha

	Bashkimit Evropian.	
Ligji Nr. 03/L-043 për parandalimin e integruar të kontrollit të ndotjes, plotësuar/ndryshuar me Ligjin nr. 08/L-262 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me ligjin nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative faza e dytë	Qëllimi i këtij ligji është parandalimi i ndërrhyrjes, kontrolli i ndotjes që rrjedh nga aktivitetet industriale, në veçanti duke parandaluar ose reduktuar mbeturinat dhe shkarkimet në ajër, ujë dhe tokë.	Të gjitha (në veçaniti ajri, uji, toka)
Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis	Qëllimi i tij është të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit përmes parandalimit të dëmeve dhe efekteve negative në mjedis të projekteve publike apo private, përcaktoj rregullat dhe procedurat për identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve të projekteve në mjedis, për të siguruar parandalimin ose zvogëlimin e ndikimeve negative të projekteve të propozuara publike dhe private si dhe garantimin e një procesi gjithëpërfshirës dhe të hapur vendimmarrjeje përmes përcaktimit të rregullave dhe procedurave administrative, gjatë procesit të vendimmarrjes për pajisje me pëlqim mjedisor. Ky ligj është pjesërisht në përputhje me Direktivën 2014/52/EU e Parlamentit Europian dhe Këshillit e dt.16 prill 2014 e cila ndryshon Direktivën 2011/92/EU mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis të projekteve të caktuara publike dhe private.	Të gjitha
Ligji nr. 08/L-025 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja	Qëllimi i këtij ligji është të përcaktojë kompetencat dhe përgjegjësitë e institucioneve për të siguruar të drejtën e qytetarëve për të jetuar në një mjedis me ajër të pastër, duke mbrojtur shëndetin e njeriut, faunën, florën dhe vlerat natyrore e kulturore të mjedisit nga ndotja e ajrit.	Ajri
Ligji Nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma, ndryshuar/plotësuar nga Ligji nr. 08/L-176 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me ligjin nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative	Qëllimi i këtij ligji është të shmangë, parandalojë ose zvogëlojë në bazë të prioritetëve efektet e dëmshme, përfshirë edhe bezdisjen, për shkak të ekspozimit ndaj zhurmës. Ky ligj do të sigurojë bazën për zhvillimin e masave për reduktimin e zhurmës së emetuar nga burimet kryesore, veçanërisht nga trafiku ajror, rrugor dhe hekurudhor, pajisjet e jashtme dhe industriale, makineritë e lëvizshme dhe për burime të tjera të ndotjes akustike dhe bezdisjes së mjedisit.	Zhurma
Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, ndryshohet/ plotësohet nga Ligji nr. 08/L-176 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me ligjin nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative	Ky ligj rregullon çështjet që kanë të bëjnë me: ujërat sipërfaqësore, liqenet, depozitat, rezervuarët, burimet natyrore, ujërat nëntokësore, tokat e lagështa, tokat afër brigjeve të lumenjve, çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin, përdorimin dhe shpërndarjen e tyre të ujit, mbrojtjen dhe ruajtjen e ujit, mbrojtjen nga veprimet e dëmshme të ujit, duke përfshirë zhytjen, përmytjet, thatësitë, erozionin; objektet dhe infrastruktura ujore, financimi i ujit si dhe kushtet, metodat dhe aktivitetet me të cilat mund të shfrytëzohen apo lirohen ujërat.	Uji

Ligji Nr.04/L-060 për Mbeturina, ndryshohet/plotësohet nga ligji nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-060 për mbeturina si dhe plotësuar/ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-262 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me ligjin nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative faza e dytë	Ky ligj ka për qëllim: evitimin dhe reduktimin sa më të madh të mundshëm të gjenerimit të mbeturinave; ripërdorimin e komponentëve të përdorshëm nga mbeturinat; zhvillimin e qëndrueshëm përmes mbrojtjes dhe ruajtjes së resurseve natyrore; parandalimin e ndikimeve negative të mbeturinave në mjedis dhe shëndetin e njeriut; deponimin përfundimtar të mbeturinave në mënyrë të pranueshme mjedisore.	Mbeturinat
Ligji Nr. 03/L-043 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes, ndryshuar/ plotësuar nga ligji nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-060 për mbeturina si dhe plotësuar/ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-262 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me ligjin nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative faza e dytë	Ky është instrumenti kryesor për parandalimin e ndotjes së ujërave nga shkarkimet industriale. Zbatimi i këtij ligji do të mundësojë parandalimin e shkarkimeve të pa trajtuara të ujërave industriale në lumenj.	Uji, toka dhe shfrytëzimi i tokës
Ligji Nr. 02/L-26 për tokën bujqësore Udhëzimi Administrativ nr. 41/2006 për ndryshimin e përdorimit të tokës bujqësore	Ligji përcakton përdorimin, mbrojtjen, rregullimin dhe dhënien me qira të tokës bujqësore me qëllim të ruajtjes dhe mbrojtjes së përhershme të potencialit bujqësor, bazuar në parimet për një zhvillim të qëndrueshëm. Udhëzimi administrativ synon të vendosë procedurën administrative dhe kriteret e vendimmarrjes për ndryshimin e përhershëm ose të përkohshëm të shfytëzimit të tokës bujqësore. Procedura kërkon një bashkëpunim të ngushtë të personave përkatës autoritetet kompetente për planifikim hapësinor dhe bujqësi.	Shfrytëzimi i tokës dhe cilësia e tokës
Ligji Nr. 04/L-197 për Kimikatet, ndryshuar/plotësuar nga Ndryshohet/Plotësohet nga Ligji nr. 08/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-197 për kimikate	Qëllimi i këtij ligji është menaxhimi i qëndrueshëm i kimikateve të rrezikshme, mbrojtja dhe zvogëlimi i rrezikut të mundshëm nga kimikatet që mund të ndikojnë në pasoja të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe mjedisin.	Shëndeti public, toka, uji, ajri
Ligji Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës, ndryshuar/plotësuar nga: Ligji nr. 08/L-176 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me ligjin nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, Ligji nr. 08/L-276 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve të veçanta për krijimin e bazës ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore nga qeveria dhe ministrat, Ligji nr. 08/L-283 për harmonizimin e ligjeve të veçanta me ligjin nr. 05/L-087 për kundërvajtje	Ky ligj rregullon mbrojtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të natyrës dhe burimeve natyrore, restaurimin e zonave të dëmtuara dhe parandalimin e dëmeve mjedisore. Ai përcakton zonat e mbrojtura, sistemet e monitorimit dhe mbron speciet dhe habitatet e rralla e të rrezikuara. Gjithashtu siguron pjesëmarrjen e publikut, qasjen në natyrë dhe përputhshmërinë me standardet e Bashkimit Evropian për ruajtjen e natyrës.	Biodiversiteti, zonat natyrore të mbrojtura, peizazhi
Ligji Nr. 04/L-120 për mbrojtjen e bimëve, shtuar aneksi, ndryshuar/plotësuar nga ligji nr.08/L-082 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-120 për mbrojtjen e bimëve si dhe nga ligji nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-060 për mbeturina si dhe plotësuar/ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-262 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me ligjin nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative faza e dytë	Ky ligj parashikon kushtet për: a) mbrojtjen e bimëve dhe produkteve bimore nga organizmat e dëmshëm; b) parandalimin e hyrjes dhe përhapjes së organizmave të dëmshëm dhe çrrënjësjes së tyre; c) identifikimin e organizmave të dëmshëm; d) prodhimin dhe transferimin optimal të bimëve dhe produkteve bimore; f) zbatimin e mbikëqyrjes së përhershme të organizmave të dëmshëm, të vlerësimit dhe menaxhimit të rrezikut të tyre, të masave për mbrojtjen e bimëve dhe kryerjen e detyrave dhe	Biodiversiteti

	raporteve të tjera; g) orientimin dhe monitorimin e zhvillimit të aktiviteteve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e bimëve; h) mbledhjen, mirëmbajtjen dhe shkëmbimin e të dhënave dhe informacionit;	
Ligji nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore	Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore, duke siguruar që ajo të jetë e qasshme dhe e vlerësuar nga gjeneratat aktuale, ndërsa njëkohësisht të mbrohet për brezat e ardhshëm.	Trashëgimia kulturore
Ligji nr. 03/L-039 për Zonat e veçanta mbrojtëse Shtojca - Hartat për zonat e veçanta të mbrojtura	Ky ligj siguron mbrojtjen e manastireve, kishave ortodokse serbe, objekteve të tjera fetare, si vende me rëndësi të veçantë historike dhe kulturore për komunitetin serb dhe komunitetet tjera në Republikën e Kosovës, përmes krijimit të Zonave të Veçanta të Mbrojtura. “Zonë e posaçme e mbrojtur” është një zonë e përcaktuar nga një hartë, ose nga një zonë e përcaktuar që rrethon një monument, ndërtesë, grup ndërtesash, ansambël, fshat ose qendër qyteti historik që mbrohet nga çdo zhvillim ose aktivitet që mund të dëmtojë historinë e tij, kontekstin kulturor, arkitekturor ose arkeologjik, mjedisin natyror ose mjedisi vizual estetik.	Trashëgimia kulturore
Ligji nr. 2003/L-11 për rrugët i ndryshuar me Ligjin nr. 03 /L-120 dhe Ligji nr.06/L-068	Ky ligj rregullon statusin juridik të rrugëve publike; ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve publike; ofron masat për mbrojtjen e rrugëve dhe qarkullimit; financimi dhe mbikëqyrja e rrugëve publike.	Zhurma dhe dridhjet, peizazhi, biodiversiteti
Ligji nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor	Ky ligj ka për qëllim të sigurojë një zhvillim të qëndrueshëm dhe të balancuar të planifikimit hapësinor në gjithë territorin e Kosovës si një vlerë kombëtare e përbashkët, përmes qeverisjes së mirë, përdorimit racional të hapësirës, mbrojtjes së mjedisit dhe trashëgimisë kulturore..	Të gjitha e në veçanti shfrytëzimi i tokës
Ligji nr. 04/L-110 për ndërtimin	Ky ligj përcakton dispozitat që rregullojnë dhënien e lejes së ndërtimit, respektimin e kërkesave për leje ndërtimi dhe lëshimin e certifikatës së përdorimit. Ky ligj rregullon ndërtimin e të gjitha objekteve ndërtimore në Kosovë, projektimin, ndërtimin, rindërtimin, rrënimin, nëse nuk është paraparë ndryshe me ligj të veçantë.	Të gjitha
Ligji Nr. 04/L-027 për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera	Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e njerëzve, pronës dhe mjedisit përmes menaxhimit dhe zvogëlimit të ndikimit të fatkeqësive natyrore dhe atyre tjera. Ai përcakton përgjegjësinë shtetërore për një sistem të unifikuar të mbrojtjes nga fatkeqësitë.	Të gjitha
Ligji Nr. 02/L-78 për Shëndetësi Publike	Ky ligj trajton mbrojtjen e përgjithshme të shëndetit publik, siç janë zgjidhja e problemeve shëndetësore në komunitet, parandalimi i sëmundjeve, edukimi rehabilitues shëndetësor dhe çështjet sociale.	Popullsia dhe shëndeti publik
Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë Nr. 04/L-161, ndryshuar/plotësuar Ligji nr. 08/L-283 për harmonizimin e ligjeve të veçanta me ligjin nr. 05/L-087 për kundërvajtje	Ky ligj ka për qëllim të sigurojë kushte të sigurt dhe të shëndetshme pune duke parandaluar lëndimet në vendin e punës dhe duke promovuar sigurinë në punë.	Shëndeti publik – siguria në punë

Ligji Nr. 04/L-183 për Transportin Rrugor të Mallrave të Rrezikshme	Ky ligj ka për qëllim përmirësimin e sigurisë së transportit të mallrave të rrezikshme me rrugë ose hekurudhë, duke mbrojtur njerëzit, pronën dhe mjedisin përmes parandalimit të ndotjes dhe mbështetjes së bizneseve që merren me këtë lloj transporti.	Shëndeti publik – siguria në punë
Ligji Nr. 04/L-086 për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”	Përmes këtij ligji, zona e Bjeshkëve të Nemuna, e njohur për ekosistemet e saj të pasura natyrore, speciet endemike dhe peizazhet e ndryshme, është shpallur Park Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" për shkak të rëndësisë së saj ekologjike, shkencore, kulturore dhe ekonomike.	Biodiversiteti, zonat natyrore të mbrojtura, peizazhi

Strategjitë dhe politikat kombëtare

Strategjia	Përshkrimi	Aspektet e VSM-së
Strategjia për mbrojtjen e mjedisit 2013 – 2022	Dokument i cili përcakton objektivat dhe prioritetet që duhet të zbatohen nëpërmjet Planit të Kosovës për Veprim në Mjedis (PKVM) 2013 - 2017. Kjo strategji rekomandon integrimin e menaxhimit të mjedisit dhe të mbrojtjes në të gjithë sektorët e Kosovës. Është rishikim i Strategjisë së Kosovës për Mjedisin dhe zhvillimin e Qëndrueshem (2005-2015).	Të gjitha
Strategjia e Kosovës për menaxhim të mbeturinave 2013-2022	Ka rol kyç për të arritur një menaxhim të qëndrueshëm të mbeturinave. Përmes strategjisë synohet të vendosen politikat që ofrojnë një kornizë të planifikimit e cila për menaxhimin e mbeturinave do të përcaktojë caqet sipas Planit të veprimit për menaxhimin e mbeturinave dhe planeve lokale që janë instrumentet më të rëndësishme për zbatimin e politikave dhe arritjen objektivave për menaxhimin e mbeturinave, si komponentë të zhvillimit ekonomik.	Mbeturinat
Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Kosovë (2024-2035) dhe Plani i Veprimit (2024-2026)	Kjo strategji përcakton qasjen e Qeverisë për menaxhimin e integruar të mbeturinave të ngurta në Kosovë, duke avancuar prioritetet kombëtare. Ajo definon objektivat strategjike, qëllimet dhe treguesit për menaxhimin e mbeturinave dhe riciklimin. Strategjia shtrihet nga viti 2024 deri në vitin 2035, me një Plan Veprimi të detajuar për periudhën 2024-2026.	Mbeturinat
Strategjia dhe Plani i veprimit për cilësinë e ajrit 2013- 2022	Strategjia cakton objektivat për cilësinë e ajrit dhe politikat alternative për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së ajrit, për të siguruar përfitime të rëndësishme për cilësinë e jetës dhe ndihmesë në mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm.	Ajri
Strategjia Shtetërore e Ujërave të Kosovës 2017-2033 dhe Strategjia e Rishikuar e Ujërave 2023–2027	Strategjia ka për qëllim të sigurojë zhvillimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve ujore në Kosovë për shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit dhe rritjen socio-ekonomike. Ajo përcakton udhëzime për shpërndarjen optimale të ujit, masa mbrojtëse kundër ndotjes dhe shfrytëzimit të tepruar, si dhe definohen strukturat institucionale për menaxhimin e burimeve ujore.	Uji
Strategjia për Ndryshimet Klimatike 2019- 2028 dhe Plani i Veprimit për Ndryshime Klimatike 2019- 2021	Strategjia përcakton politikat për zvogëlimin e emisioneve të gazrave serrë dhe për përshtatje me ndryshimet klimatike. Po ashtu, ajo paraqet një mundësi që të gjenden dhe përcaktohen masat për zvogëlimin e emisioneve të gazrave serrë dhe përshtatjes me ndryshimet klimatike, të cilat do të nxisin zhvillimin e qëndrueshëm.	Faktorët dhe ndryshimet klimatike

Strategjisë Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore 2017-2027	Synon vendosjen e kornizave afatgjata për vizionin dhe ofrimin e zgjidhjeve të bazuara në parimin e qëndrueshmërisë, avancimin e sistemit dhe të mekanizmave për mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore të Kosovës në përputhje me kornizën ligjore, parimet dhe standardet ndërkombëtare, si dhe mbi bazën e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, shoqëror dhe kulturor.	Trashëgimia kulturore
Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2011 – 2020	Është dokument bazë për mbrojtjen e natyrës, i cili përcakton synimet afatgjata të ruajtjes së biodiversitetit dhe laramanisë peizazhore, vlerave të mbrojtura të natyrës, si dhe mënyrën e zbatimit në harmoni me zhvillimin e gjithëmbarshtëm ekonomik, shoqëror dhe kulturor.	Biodiversiteti
Libri i kuq i faunës 2019	Identifikon dhe përcakton masat për mbrojtjen e llojeve të egra të mbrojtura.	Biodiversiteti
Libri i Kuq i Florsë Vaskulare të Republikës së Kosovës 2013	Fokusohet në vëmendjen ndaj kërcënimeve që i bëhen biodiversitetit, identifikon ato specie që kanë nevojë për masa mbrojtëse dhe krijon një bazë informacioni për monitorimin e mëtejshëm.	Biodiversiteti
Plani Hapësinor i Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"	Plani përcakton orientimet bazë për mbrojtjen dhe përdorimin racional të Parkut.	Biodiversiteti dhe zonat natyrore të mbrojtura
Strategjia për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural 2022–2030	Strategjia për Zhvillim Rural dhe Bujqësor 2022–2028 është në përputhje me Politikën e Përbashkët Bujqësore të BE-së dhe mbështet Programin e Qeverisë 2021–2025. Ajo fokusohet në rritjen e konkurrueshmërisë së sektorit agro-ushqimor, menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve, zhvillimin e bizneseve rurale, sigurinë ushqimore dhe zbatimin e reformave.	Shfrytëzimi i tokës
Strategjia për Zhvillimin e Pylltarisë dhe Plani i Veprimit 2021–2030	Strategjia për Zhvillimin e Pylltarisë, në përputhje me qasjen evropiane, ka për qëllim mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve të Kosovës. Qëllimi kryesor është ruajtja dhe zgjerimi i burimeve pyjore duke balancuar rolet e tyre ekonomike, ekologjike dhe shoqërore.	Shfrytëzimi i tokës
Strategjia e Turizmit të Kosovës 2024–2030	Ka për qëllim zhvillimin e turizmit në një bazë konkurruese, rritjen e zhvillimit ekonomik dhe krijimin e mundësive për punësim.	Mirëqenia sociale

Planet dhe strategjitë lokale

Strategjia/plani	Përshkrimi	Aspektet e VSM-së
Plani zhvillimor komunal	Është një plan strategjik shumësektorial që përcakton objektiva afatgjata për zhvillimin ekonomik, social dhe hapësinor të komunës	Të gjitha
Harta Zonale Komunale	Është dokument që, përmes grafikëve, fotografive, hartave dhe tekstit, përcakton në mënyrë të detajuar llojin, destinacionin, përdorimin e planifikuar të hapësirës dhe masat e veprimit, të bazuara në kohëzgjatje dhe projeksione të realizueshme të investimeve publike dhe private në të gjithë territorin e komunave	Të gjitha
Planet komunale për menaxhimin e mbeturinave	Veçse janë analizuar me PNMIM	Mbeturinat
Planet lokale të veprimit në mjedis	Rekomandon integrimin e menaxhimit dhe mbrojtjes së mjedisit në të gjitha sektorët komunalë	Të gjitha

1.3. Qëllimi i raportit të VSM-së

Qëllimi i VSM-së është të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe të kontribuojë në promovimin e qëndrueshmërisë, duke propozuar masa për të eliminuar ose zvogëluar efektet në mjedis që mund të shkaktohen nga zbatimi i veprimeve të PNMIM-së

Raporti i VSM-së duhet të lexohet në bashkë me PNMIM-në.

1.4. Metodologjia për hartimin e raportit të VSM-së

Metodologjia e punës në hartimin e raportit të VSM-së dhe procedurat mund të përmbliidhen si në vijim:

- Përgatitja e raportit VSM-së në të cilin janë identifikuar çështjet kryesore të cilat mund të kenë ndikim potencial nga propozimet e dhëna me PNMIM, për të cilat janë propozuar masat për eliminimin/zvogëlimin e këtyre efekteve në mjedis
- Takime me institucionet dhe intervista me palët përkatëse për të siguruar të dhëna mbi çështje specifike mjedisore;
- Debati publik mbi raportin VSM-së;
- Trajtimi i komenteve para se të miratohet PNMIM-ja;
- Pëlqimi nga MMPHI-ja
- Aprovimi nga Kuvendet komunal.

1.5. Struktura e raportit të VSM-së

Struktura e raportit përcjell strukturën që e përcakton Ligji për VSM-në, e cila përfshin këta kapituj:

- Kapitulli hyrës ofron sfondin dhe informacionin e përgjithshëm mbi qëllimin e hartimit të raportit të VSM-së për PNMIM-in. Ky kapitull shpjegon metodologjinë e përdorur dhe jep informacion mbi legjislacionin që rregullon këtë fushë, si dhe dokumentet e tjera të konsultuara gjatë hartimit të këtij raporti për të kuptuar më mirë ndikimet e PNMIM-it në mjedis.
- Kapitulli II paraqet studimin e çështjeve mjedisore dhe socio-ekonomike. Vlerësimi i kësaj analize rezulton në identifikimin e problemeve ekzistuese mjedisore dhe në përcaktimin e objektivave për mbrojtjen e mjedisit që lidhen me planin.
- Kapitulli III ofron përshkrimin e përmbajtjes së PNMIM-it për të cilin është hartuar raporti i VSM-së.
- Kapitulli IV analizon dhe vlerëson përputhshmërinë e objektivave kryesore të PNMIM-it me objektivat e VSM-së si dhe ndikimeve të mundshme më të rëndësishme të PNMIM-it në mjedis. Propozohen masa për të shmangur, zvogëluar dhe, për aq sa është e mundur, eliminuar ndikimet e rëndësishme negative në mjedis gjatë zbatimit të planit.
- Kapitulli V paraqet kornizën e monitorimit për zbatimin e masave të propozuara.
- Kapitulli VI përmban konkluzionin me rekomandimet e nevojshme për marrjen në konsideratë të raportit të VSM-së gjatë zbatimit të PNMIM-it.
- Shtojca 1 përmban një përmbledhje jo-teknike të destinuar për përdorim publik.

II. ANALIZA E ASPEKTEVE MJEDISORE

2.1. Përshkrimi i gjendjes ekzistuese në mjedis

Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM) kërkon që Raporti i VSM-së të përfshijë një përshkrim të gjendjes aktuale të mjedisit dhe zhvillimit të mundshëm të tij në rast të moszbatimit të planit apo programit, si dhe një përmbledhje të çështjeve ekzistuese mjedisore. Nënkapitulli i parë jep një përmbledhje të karakteristikave kyçe gjeografike, sociale dhe ekonomike të Zonës së Menaxhimit të Mbeturinave 3 - Pejë (përfshihen Peja, Istogu, Klina, Deçani dhe Juniku), duke ofruar një kontekst më të qartë. Nënkapitulli i dytë përmbush kërkesën ligjore për të përshkruar aspektet mjedisore të përcaktuara në Ligjin për VSM. Studimi i gjendjes fillestare të mjedisit bazohet në analizën e burimeve të informacionit të referuara në Hyrjen e raportit.

2.1.1. Karakteristikat gjeografike dhe socio-ekonomike të rajonit të Dukagjinit

Karakteristikat fizike dhe gjeografike

Zona e Menaxhimit të Mbeturinave 3 - Pejë (përfshihen Peja, Istogu, Klina, Deçani dhe Juniku), i vendosur në pjesën veriperëndimore të Kosovës, shtrihet në një sipërfaqe prej 1,808.67 km² dhe përfshin pesë komuna: Pejë, Deçan, Istog, Klinë dhe Junik. Ai kufizohet me Malin e Zi dhe Shqipërinë, dhe përshkruhet nga një terren që përfshin luginat pjellore, male të thepisura dhe formacione gjeologjike të rëndësishme, si Gryka e Rugovës. Rajoni ka rëndësi të madhe ekologjike dhe ekonomike dhe njihet për gjeologjinë dhe shfrytëzimin e larmishëm të tokës. Formacionet shkëmbore dominojnë zonat malore në veri dhe perëndim, ndërsa luginat pjellore përgjatë lumenjve Lumbardhi i Pejës dhe Drini i Bardhë mbështesin bujqësinë.

Rajoni është i pasur me burime ujore, përfshirë lumenj të shumtë, kroje dhe liqene artificiale, të cilat janë thelbësore për ujitje dhe furnizim me ujë të pijshëm².

Rajoni ka një klimë të mesme-kontinentale, e zbutur nga ndikimi mesdhetar i Adriatikut përmes luginës së lumit Drini i Bardhë, me vera të ngrohta, ku temperatura mesatare në muajin gusht është 19.7°C, dhe dimra të ftohtë, me një mesatare prej -1.9°C në janar.

Sasia mesatare vjetore e reshjeve në këtë rajon është rreth 700 mm³, ndërsa sasia më e madhe vjetore e reshjeve regjistrohet në Bjeshkët e Nemuna, me rreth 1,750 mm⁴.

Zona e Menaxhimit të Mbeturinave 3 - Pejë (përfshihen Peja, Istogu, Klina, Deçani dhe Juniku) është e rëndësishme si ekologjikisht ashtu edhe ekonomikisht. Peizazhi i saj është tepër i larmishëm, duke u shtrirë nga malet e thepisura deri te luginat pjellore. Falë burimeve të bollshme ujore, rajoni luan një rol kyç në mbështetjen e bujqësisë dhe sigurimin e ujit të pijshëm në të gjithë Kosovën. Klima e butë dhe tiparet unike gjeologjike i shtojnë gjithashtu bukurisë së tij natyrore dhe potencialit zhvillimor.

Ekonomia dhe mirëqenisa sociale

Anketa e Fuqisë Punëtore⁵ ofron të dhëna për punësimin në nivelin e Kosovës, por mungojnë të dhënat për papunësinë në nivel lokal dhe rajonal. Shkalla e punësimit në Kosovë në vitin 2023 ishte 36.30%, duke shënuar një rritje prej 2.5% krahasuar me vitin e kaluar.

Punësimi në këtë rajon është kryesisht i përqendruar në sektorët e mëposhtëm:

- Bujqësia: Sipas PNMIM, mbi 50% e familjeve janë të angazhuara në aktivitete bujqësore dhe blegtori. Në përgjithësi, rreth 8–10% e popullsisë sigurojnë të ardhura ose jetesën nga

² Ministria e Zhvillimit rajonal, Strategjia për zhvillim regjioanl 2020-2030

³ Instituti Hidrometeorologjik I Kosovës 2024

⁴ Raporti paraprak i vlerësimit të rrezikut nga përmbytjet për pellgjet e lumenjve të Kosovës 2024

⁵ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Anketa e Fuqisë Punëtore 2023

sektori i pylltarisë dhe përpunimit të drurit. Kontributi i sektorit të pylltarisë në BPV është afërsisht 1.8–2.6%.

- Shërbimet: Përfshijnë tregtinë me pakicë, mikpritjen (veçanërisht shërbimet e lidhura me turizmin) dhe administratën publike.
- Industria: Ndërmarrje të vogla dhe të mesme (NVM) të përfshira në prodhimtari, veçanërisht në tekstil, mobilje dhe përpunimin e ushqimeve.
- Sektori Publik: Punësimi në arsim, kujdes shëndetësor dhe shërbimet e qeverisjes lokale.

Norma e papunësisë në Kosovë, përfshirë Zonën e Menaxhimit të Mbeturinave 3 - Pejë (përfshihen Peja, Istogu, Klina, Deçani dhe Juniku), është relativisht e lartë, veçanërisht në mesin e të rinjve dhe grave. Çështje strukturore si mospërputhja e aftësive, mungesa e mundësive për punësim jashtë qendrave urbane dhe varësia ekonomike nga remitencat kontribuojnë në këto sfida.

Rajoni është i njohur për pyjet, tokën bujqësore pjellore, rezervat e ujërave termale, thëngjillin në Klinë, trashëgiminë e pasur kulturore dhe një traditë të fuqishme në bujqësi, tregti dhe turizëm. Lidhja ndërkufitare e Pejës me Malin e Zi e pozicionon atë si një nxitës kyç të zhvillimit ekonomik dhe zgjerimit të tregut. Peizazhet e larmishme të rajonit mbështesin bujqësinë, përfshirë kultivimin e kulturave si gruri dhe misri, si dhe blegtorinë, bletarinë dhe pylltarinë. Ekziston një traditë në prodhimin dhe përpunimin e ushqimit. Rrafshi i Dukagjinit është një zonë shumë e përshtatshme për prodhimin hortikulturor, ku shumica e komunitetit bujqësor është e angazhuar në kultivimin e kulturave me vlerë të lartë dhe merr pjesë në sistemet e ujitjes.

Rajoni posedon burime minerare, përfshirë plumbin, zinkun dhe argjendin, megjithëse aktivitetet minerare në të kaluarën kanë pasur ndikim negativ në mjedis⁶. Nëntëmbëdhjetë vendbanime në komunat e Istogut dhe Klinës, që mbulojnë një sipërfaqe prej 5.83 km², ndodhen mbi një depozitë thëngjilli në pellgun e Dukagjinit. Megjithatë, në rajon nuk ka miniera aktive – zhvillohen vetëm aktivitete gurore. Rajoni ka potencial të madh për krijimin e vendeve të punës nëpërmjet zhvillimit të turizmit, me sektorë kyç si turizmi malor me sporte dhe rekreacion, speleologjia në Pejë, Deçan dhe Klinë, turizmi shëndetësor dhe relaksues i bazuar në ujërat termo-minerale në Pejë dhe Istog, si dhe aktivitete të ndryshme sportive. Gjithashtu, ofron mundësi për agroturizëm në zona me peizazhe të pasura dhe jetë rurale, si dhe për turizëm kulturor dhe trashëgimi⁷. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), numri i vizitorëve vendorë dhe të huaj është rritur në mënyrë të qëndrueshme nga viti 2019 deri në vitin 2021.

Sa i përket menaxhimit të mbeturinave, sektorë si administrata publike, bizneset, prodhimi dhe turizmi gjenerojnë mbeturina tregtare, industriale dhe shtëpiake. Sektori i prodhimit dhe tregtisë krijon mbeturina industriale dhe ambalazhesh. Industritë gjenerojnë lloje të ndryshme mbeturinash, të cilat kryesisht kategorizohen në dy grupe kryesore: mbeturina industriale jo të rrezikshme dhe të rrezikshme. Turizmi kontribuon në rritjen e mbeturinave organike dhe atyre të lidhura me shërbimet. Aktivitetet bujqësore prodhojnë mbeturina organike dhe mbeturina shtazore. Mbeturinat shtazore paraqesin një shqetësim në rritje në Klinë dhe Istog. Në Istog, aktualisht ato po deponohen në deponinë komunale të Tupeqit pa trajtim të duhur, duke paraqitur rrezik potencial për mjedisin dhe shëndetin publik.

Të dhënat për mbeturinat e gjeneruara në vitin 2023 nga aktivitete të ndryshme ekonomike (kur janë të disponueshme) në secilën komunë paraqiten në tabelën në vijim:

⁶ Ministrria e Zhvillimit rajonal, Strategjia e Zhvillimit rajonal 2020-2030

⁷ Ministrria e Zhvillimit rajonal, Strategjia e Zhvillimit rajonal 2020-2030

Tabela 1. Gjenerimi i mbeturinave sipas sektorëve në rajonin e Pejës, 2023

Burimi	Total	
	kg	%
Tregtia/bizneset	7,284	72.82%
Institucionet	2,362	23.62%
Industria	356	3.56%
Total	10002	100%

Burimi: MNKMIM, 2025

Ekonomia e larmishme e rajonit, e nxitur nga bujqësia, agro-industria dhe turizmi, prodhon lloje të ndryshme mbeturinash, duke krijuar si sfida ashtu edhe mundësi në menaxhimin e tyre. Menaxhimi i duhur i mbeturinave është thelbësor jo vetëm për mbrojtjen e burimeve natyrore, por edhe për mbështetjen e rritjes ekonomike dhe promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm.

Popullsia dhe shëndeti publik

Demografia: Sipas Regjistrimit të Popullsisë 2024, në këtë rajon jetojnë 177,974 banorë, që përbëjnë 11.2% të popullsisë së përgjithshme të Kosovës. Rajoni po përballet me migrim të vazhdueshëm të popullsisë nga zonat rurale në ato urbane, kryesisht drejt kryeqytetit, me të rinjtë që janë më të prekurit nga ky fenomen. Gjithashtu, ka një trend të dukshëm të emigrimit drejt vendeve të Evropës Perëndimore.

Mesatarja e anëtarëve për një ekonomi familjare është 4.4 banorë. Dendësia e popullsisë ndryshon sipas komunave: në Pejë, ajo varion nga 100 deri në 150 banorë për km², ndërsa në komunat tjera është nën 100 banorë për km². Sipas Regjistrimit të Popullsisë 2024, shkalla e urbanizimit është e ndryshme: mbi 50% e popullsisë së Pejës jeton në zona urbane, ndërsa në Istog dhe Klinë kjo përqindje varion nga 20.1% deri në 38%. Në Deçan dhe Junik, shkalla e urbanizimit është më e ulët se 20%.

Popullsia urbane është kryesisht e angazhuar në shërbime, tregti dhe industri, duke kontribuar në mbeturinat komunale, përfshirë ato shtëpiake, tregtare dhe industriale. Popullsia rurale merret kryesisht me bujqësi dhe industri të vogla, duke gjeneruar mbeturina komunale dhe bujqësore. Mbeturinat që gjenerohen në rajon ndryshojnë sipas komunave, duke varuar nga 133 kg/person/vit në Junik deri në 374 kg në Pejë, me një mesatare rajonale prej 279 kg/vit ose 0.76 kg/dite. Kjo reflekton ndryshimet në konsum lokal dhe praktikatat e menaxhimit të mbeturinave⁸.

Edhe pse popullsia e rajonit pritet të mbetet relativisht e qëndrueshme, sasia e mbeturinave pritet të rritet me rreth 7% deri në fund të periudhës së planifikimit, duke arritur afërsisht 65,000 tonë në vitin 2035. Kjo rritje lidhet me pritjet për rritjen e BPV-së gjatë kësaj periudhe⁹.

Tabela 2: Numri ekonomive familjare dhe mbeturinat e gjeneruara

Komuna	Numri i banorëve	Numri ekonomive familjare *	Shkalla e urbanizimit* %	Parashikimi i sasisë së mbeturinave /ek.familjare/t**				
				Viti bazë	Parashikimi			
				2023	2024	2030	2035	2040
Deçan	27 775	5,909	<20%	7,115	7,169	7,170	7,091	6,959
Istog	33 008	7,591	>20-38.3	11,569	11,656	11,658	11,530	11,316
Junik	3 943	895	<20%	860	866	867	857	841
Klinë	30 503	6,753	>20-38.3	7,738	7,796	7,798	7,712	7,569
Pejë	82 745	19,639	>50	37,300	37,581	37,588	37,174	36,484

⁸ Draft PNMIM, 2025⁹ Draft PNMIM, 2025

Tabela 2: Numri ekonomive familjare dhe mbeturinat e gjeneruara

Komuna	Numri i banorëve	Numri ekonomive familjare *	Shkalla e urbanizimit* %	Parashikimi i sasisë së mbeturinave /ek.familjare/t**				
				Viti bazë	Parashikimi			
				2023	2024	2030	2035	2040
Total	177,974	40,787		6,455	65,068	65,080	64,364	63,170

Burimi *Regjistrimi i popullsisë 2024 dhe **PNMIM 2025

Duke qenë se përbën 11.2% të popullsisë së Kosovës, Zona e Menaxhimit të Mbeturinave 3 - Pejë (përfshihen Peja, Istogu, Klina, Deçani dhe Juniku) po përjeton urbanizim dhe emigrim të vazhdueshëm, veçanërisht në mesin e të rinjve. Këto ndryshime demografike theksojnë rëndësinë e zhvillimit të strategjive për menaxhimin e mbeturinave që janë të përshtatshme si për rritjen urbane, ashtu edhe për nevojat unike të zonave rurale.

Shëndeti publik

Sistemi shëndetësor i Kosovës është i strukturuar në tre nivele: parësor (mjekësia familjare), dytësor (kujdesi i specializuar) dhe tretësor. Të gjitha komunat e Zonës së Menaxhimit të Mbeturinave 3 - Pejë (përfshihen Peja, Istogu, Klina, Deçani dhe Juniku) ofrojnë kujdes shëndetësor parësor, ndërsa Peja ofron gjithashtu edhe shërbime të kujdesit dytësor.

Qasja në shërbime shëndetësore është e pabarabartë dhe rezultatet shëndetësore në Kosovë janë përgjithësisht të dobëta krahasuar me Rajonin Evropian të OBSH-së. Në vitin 2019, jetëgjatësia në lindje për gratë në Kosovë ishte 74.8 vjet, ndërsa për burrat 70.3 vjet. Këto shifra janë ndjeshëm më të ulëta sesa mesataret e Rajonit Evropian të OBSH-së, të cilat në vitin 2019 ishin 81.29 vjet për gratë dhe 75.09 vjet për burrat¹⁰.

Vlerësimi i rrezikut¹¹ i kryer në vitin 2023 identifikoi disa kërcënime madhore për shëndetin publik, përfshirë përmbytjet, zjarret në natyrë, ndotjen e ajrit dhe kërcënimet biologjike. Në lidhje me menaxhimin e mbeturinave, Diarreja Akute Ujore dhe Gastroenteriti u theksuan si rreziqe me konsideratë të lartë, për shkak të potencialit të lartë të përhapjes, frekuencës së shfaqjes dhe kapaciteteve të kufizuara për reagim. Këto rreziqe prekin si zonat urbane ashtu edhe ato rurale në të gjitha rajonet.

Zonat urbane në Zonën e Menaxhimit të Mbeturinave 3 - Pejë (përfshihen Peja, Istogu, Klina, Deçani dhe Juniku) përgjithësisht kanë qasje të mirë në shërbimet e mbledhjes së mbeturinave, me katër nga pesë komunat që arrijnë një mbulim prej 100%, ndërsa komuna e Klinës ka një mbulim prej 98% dhe plane për arritjen e mbulimit të plotë. Megjithatë, asnjë nga komunat nuk ka zbatuar sisteme për ndarjen e mbeturinave të rrezikshme shtëpiake. Si pasojë, mbeturinat mjekësore dhe ato të rrezikshme shpesh përzihen me mbeturinat shtëpiake, duke rritur rrezikun për ndotje të tokës dhe ujit.

Trajtimi jo i duhur i mbeturinave shtazore e përkeqëson më tej situatën, duke kontribuar në ndotje, aroma të pakëndshme, përhapje sëmundjesh dhe rritje të dëmtuesve. Kjo gjendje përkeqësohet nga ekzistenca e rreth 70 deponive ilegale, të cilat përbëjnë rreziqe serioze për shëndetin publik për shkak të mbeturinave të përziera dhe të patrajtuara, përfshirë materiale të rrezikshme. Këto deponi kontribuojnë në ndotjen e ajrit, tokës dhe ujërave, tërheqin dëmtues që bartin sëmundje dhe lehtësojnë përhapjen e sëmundjeve infektive te popullatat përreth.

Të gjitha komunat e rajonit deponojnë mbeturinat komunale në deponinë e Pejës, e cila ka tejkaluar kapacitetin e saj prej kohësh. Planet për mbylljen e saj dhe ndërtimin e një deponie të re janë në proces përgatitjeje dhe rishikimi prej disa vitesh.

Emetimet e pakontrolluara të metanit dhe gazeve toksike nga kjo deponi mund të shkaktojnë probleme me frymëmarrjen, dhimbje koke dhe çrregullime të tjera shëndetësore. Lëngu i ndotur që

¹⁰ Ministria e Shëndetësisë, Raporti Teknik i Rezultateve të Vlerësimit Strategjik të Rrezikut të Kosovës, Shkurt 2023

¹¹ Ministria e Shëndetësisë, Raporti Teknik i Rezultateve të Vlerësimit Strategjik të Rrezikut të Kosovës, Shkurt 2023

rrjedh nga mbeturinat (lëngu kullues) mund të depërtojë në ujërat nëntokësore ose në burimet ujore përreth, duke përhapur bakterie, metale të rënda dhe kimikate të dëmshme. Akumulimi i gazit ose djegiet spontane mund të çojnë në zjarre, duke liruar tym toksik dhe duke rrezikuar komunitetet përreth. Për më tepër, jetesa pranë këtyre zonave shkakton stres të vazhdueshëm, ankth dhe ulje të cilësisë së jetës për banorët lokalë.

Tabela3: Deponitë ilegale komunale

Komuna	Numri i deponive ilegale			
	2017	2019	2021	2024*
Pejë	19	73	21	21
Istog	22	22	16	16
Klinë	9	46	31	19
Deçan	31	21	2	8
Junik	22	0	0	0
Total	103	162	70	64

*Burimi: draft-PNMIM dhe *të dhënat nga intervistat-raportimi në AMME*

Menaxhimi i dobët i mbeturinave, veçanërisht kur mbeturinat shtëpiake nuk trajtohen siç duhet, luan një rol të madh në përhapjen e sëmundjeve si diarrea akute ujore dhe gastroenteriti. Kur mbeturinat nuk asgjësohen në mënyrë të sigurt, ato mund të ndotin burimet e ujit që përdoren për pirje, gatim dhe higjienë, duke krijuar një mjedis të përshtatshëm për shumimin e baktereve, viruseve dhe parazitëve të dëmshëm.

Deponitë e hapura, automjetet mbeturinë (mbeturinat metalike) dhe kushtet jo-higjienike përreth pikave të grumbullimit të mbeturinave rrisin mundësinë për përhapjen e sëmundjeve duke tërhequr dëmtues, ndotur tokën dhe ujin dhe duke rritur rrezikun nga zjarret.

Trajtimi i papërshtatshëm i mbeturinave shtazore mund të kontaminojë ujin dhe tokën, të përhapë sëmundje, shkaktojë erëra të pakëndshme dhe të rrisë rrezikun nga dëmtuesit, të gjitha këto ndikojnë negativisht në shëndetin publik.

Emetimet dhe rrjedhjet e pakontrolluara nga deponia e Pejës mund të shkaktojnë probleme shëndetësore, të kontaminojnë ujin, të nxisin zjarre dhe të ndikojnë negativisht në mirëqenien e komuniteteve përreth.

2.1.2. Gjendja në mjedis

Biodiversiteti dhe zonat natyrore të mbrojtura

Biodiversiteti

Relievi i thyer i zonës, së bashku me burimet ujore, ujëvarat dhe shpellat, mbështet një larmi të pasur habitatësh dhe bimësie, përfshirë edhe specie endemike, sub-endemike dhe relikte të bimëve. Si pjesë e Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” dhe disa rezervateve natyrore, rajoni karakterizohet nga burime të pasura pyjore dhe një biodiversitet i lartë, që përfshin një shumëllojshmëri të madhe të bimësisë drunore, shkurreve dhe barishtore. Zonat malore janë të mbuluara me pyje gjetherënëse, të dominuara nga dushku (*Quercus*), gështenja (*Castanea sativa*) dhe ahu malor (*Fagetum montanum*), ndërsa pyjet halore përbëhen kryesisht nga bredhi (*Picea abies*), abeti i bardhë (*Abies alba*) dhe pisha relikte (*Pinus peuce*), si dhe kërleka (*Pinetum mugo*). Midis shkurreve, komunitetet bimore më të përhapura përfshijnë komunitetin e dëllinjës (*Astero - Juniperetum oxycedri*), të dominuar nga dëllinja (*Juniperetum oxycedri*), si dhe komunitetet e shëlgut të bardhë (*Salicetum albae fragilis*), shëlgut të kuq (*Salicetum purpurea*) dhe verit të zi (*Alnetum glutinosae*).

Disa specie barishtore endemike të Ballkanit kanë vlerë të madhe shkencore dhe farmaceutike. Ndër to përfshihen *Draba karabensis* (*Draba e Korabit*), e cila është e rrezikuar, *Cerastium dinaricum* (*Cerasti Dinarik*), që përballlet me rrezikun e zhdukjes së plotë, *Sempervivum macedonicum* (*Burgulli Maqedonas*), *Lilium albanicum* (*Zambaku Shqiptar*), *Rumex balcanicus* (*Lëpushtra Ballkanike*) dhe *Gentiana lutea* (*Sanza*). *Gentiana lutea*, për shkak të mbledhjes së tepruar për rrënjën e saj, është

pothuajse e zhdukur në disa zona. Burgulli Maqedonas është përfshirë në Listën e Kuqe Evropiane dhe u njoh nga UNESCO në vitin 1991 për shkak të rrezikut të lartë të zhdukjes.

Një listë e specieve të rrezikuara të florës në komunat e rajonit paraqitet në tabelën në vijim.

Tabela 4: Lista e florës së rrezikuar në komunat e ZMM-së

Nr.	Familja/tipi	Ulëzimi / Frutëzimi	Lokacioni	Përharja	Endemike në	Gjendja
	ARISTOLOCHACEAE					
1	<i>Aristolochia merxmuelieri</i> Greuter et Mayer 1985. (Petriku i Grojterit)	IV/ V-VI	Rajoni I Mirushës	Kosovë	Kosovë	Popullata të zhvilluara mirë, por me një gamë të kufizuar.
	CARYOPHYLLACEAE				Kosovë	
9	<i>Sempervivum kosaninii</i> Praeger 1930 (Burgulli i Koshaninit)	VII-VIII / IX	Bjeshkët e Nemuna	Kosovë	Kosovë	Të mbrohet me Ligj
	DIPSACACEAE			Kosovë	Kosovë	
10	<i>Cephalaria pastricensis</i> Dorfl. et Havek. 1921 (Cefalaria e Pashtrikut)	VI-VII/ VIII	Bjeshkët e Nemuna (malet e Lumbardhit), Zhleb	Kosovë	Kosovë	Popullatë e rrezikuar Të mbrohet me Ligj
	FABACEAE			Kosovë	Kosovë	
11	<i>Astragalus fialae</i> Degen 1900. (Arithja e Fialit)	VII/ VIII	Bjeshkët e Nemuna (malet e Lumbardhit)	Kosovë	Kosovë	Popullatë e rrezikuar Të mbrohet me Ligj
14	<i>Thymus albanus</i> H. Braun 1892. (Listra shqiptare)	V-VI/ VIII-IX	Oshlak, Koritnik, Bjeshkët e Nemuna	Kosovë	Ballkan	Të mbrohet me Ligj
15	<i>Thymus doerfleri</i> Ronn. 1924. (Listra e Dorflerit)	VI-VII/ VIII-IX	Koritnik	Kosovë	Kosovë	Popullatë e vogël Të mbrohet me Ligj
16	<i>Thymus rohlenae</i> Vel. 1903. (Listra e Rohlenes)	VI/ VII	Rrethina e Oshlakut- Deçan	Kosovë	Kosovë	Popullatë e rrezikuar Të mbrohet me Ligj
	LILIACEAE			Kosovë	Kosovë	
17	<i>Lilium albanicum</i> Griseb. 1845. (Zambaku shqiptar)	VI-VII/ VII	Bjeshkët e Nemuna	Kosovë	Kosovë	Të mbrohet me Ligj
	POACEAE			Kosovë	Kosovë	
18	<i>Stipa mayer</i> Mart. 1971. (Pendëkaposhi i Mayerit)	V-VI/ VII	Koznik, rajoni i Mirushës, Godanc, Gllanasellë etj.	Kosovë	Kosovë	Të mbrohet me Ligj
	RANUNCULACEAE			Kosovë	Kosovë	
19	<i>Aconitum pentheri</i> Hauek 1916 (Akoniti i Rusolisë)	VII / VIII	Bjeshkët e Nemuna (Zhleb, Rusoli)	Kosovë	Kosovë	Popullatë e vogël Të mbrohet me Ligj
	ROSACEAE			Kosovë	Kosovë	
	<i>Rubus ipecensis</i> rech. 1935 (Manaferra e Pejës)	!	Gubavc (Pejë)	Kosovë	Kosovë	Popullatë e rrezikuar Të mbrohet me Ligj
	SAXIFRAGACEAE			Kosovë	Kosovë	
	<i>Saxifrage scardica</i> Griseb. 1843. (Iriqëza e Sharrit)	VI-VIII/ VIII- X	Koritnik, Bjeshkët e Nemuna (Leqinak, Koprivnik..)	Kosovë	Kosovë	Popullatë e rrezikuar Të mbrohet me Ligj
	<i>Ëulfenia bleicii</i> Lak. 1971 (Vulfenia e Bleçiqit). Dy nën-lloje Ë. bleicii subsp. bleicii Ë. bleicii subsp. rohlenae	VI-VIII/ VIII	Bjeshkët e Nemuna	Kosovë	Kosovë	!

Burimi: "Biodiversiteti i Kosovës" Qenan Maxhuni, AKMM/MMPHI

Rajoni është habitat për një larmi të madhe të faunës, duke përfshirë shpendë uji, zvarranikë, zogj dhe gjitarë. Speciet më të dalluara përfshijnë: Rreqebullin ballkanik (*Lynx lynx balcanicus*) dhe dhinë e egër (*Rupicapra rupicapra*), të cilat gjenden në Rezervatin e Kozhnjarit dhe janë të klasifikuara si specie të rralla dhe në rrezik kritik zhdukjeje (CR) në nivel evropian. Bretkosa e zezë e Alpeve (*Salamandra atra*), e klasifikuar si specie e rrezikuar (EN). Ariu i murrmë (*Ursus arctos*), i klasifikuar si gati i rrezikuar (NT) për shkak të ndjeshmërisë ndaj zhurmës së sharrave, pranisë njerëzore dhe shpyllëzimit. Insekti *Baetis melanonyx*, peshku skorta shqiptare (*Pachychilon pictum*) dhe vidra (*Lutra lutra*), e rrezikuar nga shpyllëzimi, ndotja e ujërave, menaxhimi i paqëndrueshëm i aktiviteteve turistike dhe rekreative, ndotja me mbeturina të ngurta dhe të tjera, si dhe thatësirat.

Lloje të tjera, të tilla si dreri i egër (*Capreolus capreolus*) dhe macja e egër (*Felis silvestris*) të dyja të klasifikuara si specie të rrezikuara që po përjetojnë një rënie të numrit të tyre. Gjeli i egër perëndimor (*Tetrao urogallus*) një zog i rrallë shumë i ndjeshëm ndaj zhurmës dhe pranisë njerëzore, që gjendet kryesisht në zonën e Gjeravicës; Gërdella e Lajthisë (*Bonasa bonasia*); disa zogj grabitqarë nga familja Accipitridae, më i njohuri Shqiponja e Malit (*Aquila chrysaetos*) etj.

Lumenjtë e rajonit janë të pasur me peshq, veçanërisht me troftë, dhe rajoni gjithashtu është habitat për një larmi amfibish dhe zvarranikësh. Speciet e shquara përfshijnë kurrizorë dhe bretkosë të pyllit dhe të moçalit, bretkosat, guackat, gjarpërinjtë, si dhe guackat e llojit *Iglica illyrica* dhe *Montenegrina sporadica*, etj.

Bjeshkët e Nemuna janë shtëpi për 129 specie fluturë nga lloji Lepidoptera, duke e bërë atë një nga habitatet më të pasura të fluturave në Evropë. Për këtë arsye, është shpallur një Zona Kryesore e Fluturave (PBA). Gjithashtu, për shkak të pasurisë së saj ornitologjike dhe pranisë së rrugëve kyçe migratore, rajoni është njohur si një Zona e Rëndësishme për Zogjtë (IBA)¹².

Zonat e mbrojtura natyrore

Zona e Menaxhimit të Mbeturave 3 - Pejë (përfshihen Peja, Istogu, Klina, Deçani dhe Juniku) është i pasur me zona natyrore të konservuara që ndihmojnë në ruajtjen e rëndësisë së tij ekologjike dhe kulturore.

Tabela 5: Lista e zonave të mbrojtura natyrore

Kodi	Emri i zonës së mbrojtur	Komuna/ Zona	Sipërfaqja / ha	Kategoria sipas IUCN	Viti i mbrojtjes	Përshkrim i shkurtër i vlerës
Parku Kombëtar Bjeshkët e Nemuna është i njohur për peizazhet e tij mahnitëse dhe biodiversitetin e larmishëm.						
NP_001	Parku Kombëtar 'Bjeshkët e Nemuna'	Istog (8.1%) Pejë (52.1%) Deçan (26.6%) Junik (8.4%) dhe Gjakova	62.488 ha total	II	2012	I pasur me specie endemike të florës dhe faunës, me veçori të rëndësishme gjeologjike dhe hidrologjike.
Monumentet natyrore (10,085 ha, total)						
NM_20_1	Gryka e Rugovës	Pejë	450	III	1985	Rëndësia gjeologjike, hidrologjike, peizazhore, speleologjike dhe botanike. Kanion spektakolar me rëndësi gjeomorfologjike dhe hidrologjike.
NM_02	Burimi i Drinit të Bardhë	Pejë	20	III	1985	Vend i rëndësishëm hidrologjik me vlerë të konsiderueshme ekologjike.
NM_20_3	Shpella e Radavcit	Pejë	10	III	2000	Monument speleologjik i shquar me formacione unike shpellash.
NM_20_4	Gryka e Istogut	Istog	15	III	2010	Vend i rëndësishëm gjeologjik dhe hidrologjik me florë dhe faunë të larmishme.
NM_20_5	Gërmia (Gryka e Deçanit)	Deçan	5	III	2015	Monument gjeologjik me biodiversitet të shquar.
NM_20_6	Bjeshkët e Junikut	Junik	100	III	2000	Vargmale me biodiversitet të pasur dhe bukuri pamore.
NM_20_7	Ujëvarat e Mirushës	Klinë	598.4 përfshirë	III	1983	Ujëvara me vlerë të rëndësishme ekologjike dhe turistike. E njohur

¹² Mustafa B et al "Identifikimi paraprak i zonave të Natura 2000 në Kosovë- pikat kyçe të biodiversitetit", Prishtinë 2009

mbeturinave të riciklueshme dhe ato nën sistemin e PZP-së transportohen brenda dhe jashtë rajonit, në varësi të lokacionit të objekteve të licencuara për mbledhje, deponim, përpunim/riciklim/trajtim. Aktualisht, në ZMM nuk ka stacione transferimi funksionale. Një lokacion në Istog ishte planifikuar fillimisht të shërbente si stacion transferimi, nga ku mbeturinat do të transportoheshin në deponinë rajonale të Pejës. Megjithatë, për shkak të problemeve fillestare me pajisjet dhe kostove të larta të transportit deri në Pejë, vendi në Istog përfundoi duke u përdorur si vend deponimi. Ky vend tani është mbyllur, dhe mbeturinat nga Istogu transportohen drejtpërdrejt në deponinë rajonale të Pejës²⁴. Kjo ka shkaktuar rritje të qarkullimit të mjeteve, duke shkaktuar bllokime të përkohshme ose afatgjata në rrjetin rrugor të afërt, me ndikime të mundshme në komunitetet lokale dhe ekosistemet përreth. Transporti i mbeturinave i menaxhuar në mënyrë të papërshtatshme ngre gjithashtu shqetësime për siguri në trafik. Kur mbeturinat nuk janë të vendosura në mënyrë të sigurtë ose automjetet mirëmbahen dobët, mund të krijohen pengesa në rrugë dhe të rritet rreziku i aksidenteve. Këto rreziqe jo vetëm që vënë në rrezik shoferët dhe këmbësorët, por gjithashtu ndërpresin qarkullimin e trafikut duke nxjerrë më tej në pah joefikasitetin e sistemit aktual të transportit të mbeturinave. Rreziqet bëhen edhe më të mëdha kur përfshihen mbeturinat e rrezikshme, pasi trajtimi i papërshtatshëm i tyre mund të sjellë pasoja shumë më të rënda për shëndetin publik dhe mjedisin. Edhe pse ekziston legjislacion i mjaftueshëm në fuqi që përcakton se si duhet të trajtohet heqja, mbledhja, transporti dhe deponimi i mbeturinave voluminoze, mbeturinave të pajisjeve dhe makinerive me përmasa të mëdha fizike, si dhe një Ligj i veçantë për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme, zbatimi i tyre mbetet i dobët.

Kjo situatë paraqet disa rreziqe mjedisore:


- Mbështetja në deponinë e tejmbushur të Pejës çon në ndotje të tokës dhe ujit, pasi mbeturinat mund të lëshojnë kimikate të dëmshme në mjedis.
- Mungesa e impianteve të trajtimit formal do të thotë se mbeturinat nuk përpunohen siç duhet, duke kontribuar potencialisht në ndotjen e ajrit, tokës dhe ujërave.
- Menaxhimi i joadekuat i mbeturinave të rrezikshme, bujqësore dhe industriale rrit rrezikun e ndotjes dhe dëmtimit të ekosistemeve.
- Riciklimi informal i përhapur, ndonëse ndihmon në reduktimin e disa mbeturinave, shpesh realizohet në mënyrë joefikase dhe të pasigurt, duke dëmtuar më tej mjedisin.
- Deponitë ilegale, veçanërisht ato me mbeturina të mëdha, kontribuojnë në degradimin e peizazhit dhe humbjen e biodiversitetit.
- Sektori i mbeturinave përfaqëson 5% të emetimeve totale të gazeve serrë në Kosovë, çka tregon se ndonëse ka një rol më të vogël krahasuar me sektorë të tjerë, mbetet një kontribuues i rëndësishëm dhe ofron mundësi për ndërhyrje të synuara për reduktim.
- Ndotja e tokës dhe burimeve ujore, ndotja e ajrit, zhurma dhe dridhjet, sidomos në zonat urbane për shkak të funksionimit të kamionëve të vjetër.

Menaxhimi i mbeturinave në rajon përballë me një sërë sfidash. Edhe pse mbulimi me shërbime të grumbullimit të mbeturinave është relativisht i lartë, programe të veçanta për riciklim nuk pritet të fillojnë gjatë këtij viti (2025). Aktualisht, rajoni varet nga deponia e tejmbushur në Pejë, pa stacione transferi ose objekte zyrtare për trajtimin e mbeturinave. Riciklimi jonformal është i zakonshëm, por mungojnë të dhënat e besueshme mbi shkallën dhe efektivitetin e tij. Menaxhimi fraksioneve tjera të mbeturinave, si mbeturinat e rrezikshme shtëpiake dhe ato ndërtimore, është i pamjaftueshëm, dhe ka boshllëqe të mëdha në zbatimin e sistemit të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit. Mbeturinat bujqësore dhe industriale gjithashtu nuk menaxhohen siç duhet, ndërsa mbeturinat e mëdha shpesh

²⁴ Draft PNMIM

hidhen ilegalisht në zona të hapura. Kamionët e vjetër për grumbullimin e mbeturinave kontribuojnë në ndotjen e ajrit, ndotjen e tokës dhe ujit si dhe në rritjen e zhurmës dhe dridhjeve, veçanërisht në zonat urbane, për shkak të motorëve të vjetruar dhe sistemeve të amortizuara.

Me infrastrukturë të kufizuar si stacionet e transferit, sistemi aktual shpesh çon në rritje të trafikut, rreziqe për sigurinë dhe ngarkesë mjedisore, pasi mbeturinat duhet të transportohen në distanca të gjata nga vendi i gjenerimit deri në deponinë e Pejës.



Harta 4: Të dhëna të autorit: Deponia rajonale dhe deponitë ilegale sipas madhësisë së tyre në Zonën e Menaxhimit të Mbeturinave 3 - Pejë (përfshihen Peja, Istogu, Klina, Deçani dhe Juniku)

2.2. Analiza e problemeve ekzistuese mjedisore dhe mundësitë relevante për PNMIM

Bazuar në kontekstin mjedisor dhe socio-ekonomik të paraqitur në kapitullin e mëparshëm si dhe në të dhënat e mbledhura nga takimet me palët e interesit, është përpiluar një listë e sfidave kyçe mjedisore, e paraqitur në tabelën më poshtë.

Sfidat e identifikuara kanë shërbyer si bazë për zhvillimin e objektivave të VSM-së, të cilat janë organizuar sipas fushave tematike të përcaktuara në Ligjin për VSM: biodiversiteti, popullsia dhe shëndeti i njeriut, toka, uji, ajri dhe klima, peizazhi dhe trashëgimia kulturore, si dhe asetet materiale.

Tabela 9: Çështjet kryesore mjedisore, ndikimet e mundshme të tyre dhe mundësitë

Biodiversiteti dhe zonat natyrore të mbrojtura	
Çështjet mjedisore dhe ndikimi i mundshëm i tyre	Mundësitë
Praktikat e papërshtatshme aktuale për menaxhimin e mbeturinave ndikojnë negativisht në biodiversitetin dhe ekosistemet, veçanërisht në zonat ekologjike të ndjeshme. Ndikimet përfshijnë: - Kafshët mund të gëlltisnin ose të ngatërrohen me mbeturinat. - Habitata natyrore shqetësohen ose shkatërrohen, duke çuar në humbjen e specieve. - Përhapja e specieve invazive.	Përmirësimi i sistemeve të menaxhimit të mbeturinave përmes investimeve në infrastrukturë më të mirë të mbeturinave për të zbutur dëmet ndaj ruajtjes së natyrës dhe biodiversitetit.

Deponitë ilegale si dhe deponia rajonale e mbingarkuar në Pejë është i mbingarkuar dhe nuk ka masa mbrojtëse mjedisore, duke shkaktuar ndotje të tokës, ujërave nëntokësore dhe ajrit, që dëmton ekosistemet. Funksionimi i infrastrukturës së menaxhimit të mbeturinave, veçanërisht rreth deponive të mbeturinave, shkakton emetime në ajër, tokë dhe ujë, të cilat mund të ndikojnë në habitatet, speciet dhe qëndrueshmërinë më të gjerë të ekosistemit. Mungesa e përvojës në menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe të ruajtjes së tyre e bën më të ndieshme këto zona nga hedhja e paligjshme e mbeturinave, për shkak edhe të mos-zbatimit të ligjeve ose mungesës së monitorimit të duhur.	Fuqizimi i monitorimit kundër hedhjes së paligjshme të mbeturinave mund të mbrojë ekosistemet. Projektet e restarurimit në zonat e degraduara mund të përmirësojnë disa nga dëmet mjedisore. Organizimi i aktiviteteve për menaxhimin, ruajtjen dhe mbrojtjen e biodiversitetit mund të gjenerojë vende të reja pune. Organizimi i kampanjave vetëdijësuese
Popullsia dhe shëndeti	
Çështjet mjedisore dhe ndikimi i mundëshmë i tyre	Mundësitë
Ndryshimet demografike në Zonën e Menaxhimit të Mbeturinave 3 - Pejë (përfshihen Peja, Istogu, Klina, Deçani dhe Juniku), veçanërisht emigrimi i të rinjve, ndikojnë në nevojat për resurse njerëzore në menaxhimin e mbeturinave dhe planifikimin e shërbimeve. Rënia e popullsisë mund të ketë efekte pozitive dhe negative në menaxhimin e mbeturinave: Pozitive – gjenerim më i ulët i mbeturinave, kërkesë më e vogël për burime dhe shpërndarje më efikase e mbeturinave Negative – ndikim ekonomik në sistemet e mbeturinave, mungesë e fuqisë punëtore, braktisje e pronave dhe grumbullim i mbeturinave Praktikat dhe menaxhimi i jo i mirëfilltë i mbeturinave, veçanërisht në deponi të hapura, mund të: - çojnë në rreziqe për shëndetin publik, veçanërisht diarje të akute dhe sëmundje të transmetueshme nëpërmjet ushqimit - lirim i gazra të dëmshëm si metani dhe toksina si plumbi apo mercuri në mjedis. Këto kontribuojnë në ndotjen e ajrit, e cila lidhet me sëmundje respiratore si astma, bronkiti dhe gjendje të tjera kronike të mushkërive që ndikojnë shëndetin e njeriut - përhapjen e sëmundjeve përmes kontaktit të drejtpërdrejtë ose përmes tërheqjes së insekteve dhe kafshëve që bartin mikrobe - çojë në aksidente nga trajtimi manual i përdorimit duke paraqitur kështu efekte profesionale në shëndetin e punëtorëve të grumbullimit të mbeturinave - krijojnë ndotje akustike dhe erëra të pakëndshme gjatë ndërtimit dhe funksionimit të infrastrukturës së menaxhimit të mbeturinave, që gjithashtu mund të kenë efekte negative në shëndetin dhe mirëqenien e njerëzve - kontaminojnë tokën dhe ujin, duke mundësuar përhapjen e patogjenëve, gjë që ndikon negativisht në shëndetin e njeriut	Përshtatja e planeve lokale të menaxhimit të mbeturinave në: - politikat lokale që lidhen me shëndetin e njeriut, duke marrë parasysh nevojat urbane dhe rurale, si dhe duke adresuar ndryshimet demografike dhe kapacitetet vendore; - kombinim me politikat ekonomike lokale, mund të mbështesin zhvillimin e ekonomisë qarkore duke siguruar një qasje të qëndrueshme. Investimi në mbledhje më të mirë të mbeturinave, depozitimin e sigurt dhe objektet sanitare ndihmon në uljen e ndotjes dhe rrezikut nga sëmundjet. Ndërtimi i infrastrukturës për menaxhimin e mbeturinave kërkon investime të konsiderueshme, por mund të krijojë vende pune dhe të rrisë aftësitë e fuqisë punëtore. Angazhimi i komunitetit dhe ngritja e ndërgjegjësimit: - përmes paraqitjes së shembujve konkretë të mënyrave më të mira për menaxhimin e mbeturinave dhe inkurajimit të pjesëmarrjes së banorëve; - përmes mbështetjes së projekteve që promovojnë ndryshimin e sjelljes së konsumatorëve, si riciklimi ose përdorimi i produkteve të ripërdorshme, për të përmirësuar menaxhimin e mbeturinave; - për mënyrën se si ndryshimet në mbledhjen e mbeturinave mund të ndikojnë pozitivisht me kalimin e kohës në mundësitë e punësimit në sektorin e mbeturinave.
Toka dhe shfrytëzimi i tokës	
Çështjet mjedisore dhe ndikimi i mundëshmë i tyre	Mundësitë

Hedhja e papërshtatshme e mbeturinave, deponitë ilegale, deponia e mbingarkuar në Pejë dhe riciklimi i kufizuar mund: - dëmtojnë cilësinë e tokës dhe ulin produktivitetin bujqësor - shkaktojnë degradim të tokës, duke reduktuar pjellorinë dhe kapacitetin prodhues të saj - kufizojnë aftësinë e tokës për të mbështetur zhvillimin e ardhshëm (si zgjerimi urban, duke kufizuar hapësirën e disponueshme për banim, infrastrukturë apo zhvillim ekonomik) - shkaktojnë ndotje të ujërave	Përmirësimi i praktikave të menaxhimit të mbeturinave dhe sistemeve përkatëse përmes modernizimit të deponisë rajonale në Pejë dhe vendosjes së praktikave më të mira për depozitimin e mbeturinave. Zbatimi i iniciativave më efektive dhe gjithëpërfshirëse për riciklimin mund të: - ndihmojë në zvogëlimin e mbeturinave, ruajtjen e burimeve dhe parandalimin e degradimit të tokës; - minimizojë nevojën për vendgrumbullime të reja; - ofrojë mundësi për përdorimin e mbeturinave organike të kompostuara. Ndërmarrja e iniciativave që synojnë rikuperimin e pjellorisë së tokës do të mbështesë bujqësinë dhe do të ruajë ekosistemet. Fuqizimi i zbatimit të legjislacionit dhe gjobave për deponim të mbeturinave
Uji	
Çështjet mjedisore dhe ndikimi i mundshëm i tyre	Mundësitë
Ndotja e ujit nga hedhja e mbeturinave e llojeve të ndryshme si dhe praktikave të tjera të jo të mirëfillta të menaxhimit të mbeturinave mund të: - ndikojnë në cilësinë e ujit; - ndotin tokat bujqësore duke reduktuar produktivitetin bujqësor; - përhapin sëmundje të transmetueshme përmes ujit; - shkatërrojnë ekosistemet ujore dhe shkaktojnë humbje të biodiversitetit, veçanërisht të specieve të ndjeshme; - kontaminojnë ujërat nëntokësore duke ndikuar në cilësinë e ujit të pijshëm. Mungesa e impianteve të mjaftueshme për trajtimin e mbeturinave bën që mbeturinat e patrajuara të derdhen në trupat natyrorë të ujit.	Përmirësimi i rrjetit dhe investimi në infrastrukturë të modernizuar për mbeturinat që parandalojnë ndotjen e ujit duke reduktuar rrjedhjen e mbeturinave, kontrolluar rrjedhjet sipërfaqësore dhe mbrojtur ujërat nëntokësore dhe burimet e afërta të ujit nga ndotësit e dëmshëm. Investimi në ndarjen e sistemit të ujërave të shiut nga ujërat e zeza Vendosja e monitorimit të ujërave nëntokësore nga IHMK Fushatat e vetëdijesimit publik mund të reduktojnë ndotjen e ujit nga kategori të ndryshme mbeturinash.
Kualiteti i ajrit, zhurma dhe dridhjet	
Çështjet mjedisore dhe ndikimi i mundshëm i tyre	Mundësitë
Ndotja e ajrit: - Djegia e mbeturinave liron ndotës toksikë në atmosferë, duke paraqitur rreziqe serioze për shëndetin publik, përfshirë sëmundjet respiratore dhe kardiovaskulare si dhe degradimin e ekosistemeve; - Emetimet e metanit nga deponitë e hapura të mbeturinave mund të shkaktojnë shqetësime për shëndetin publik dhe ekosistemet; - Pluhuri i shaktuar nga lëvizjet logjistike të makinerive për grumbullimin e mbeturinave mund të çojë në probleme të frymëmarrjes dhe të sistemit kardiovaskular për punëtorët, si dhe në parehati të përgjithshme për banorët përreth. Ndotja akustike dhe dridhjet nga trafiku i makinerisë së mbeturinave, aktivitetet e përpunimit të mbeturinave ndikojnë negativisht në shëndetin dhe mirëqenien e njerëzve, duke	Cilësia e ajrit: - Përmirësimi i gjelbërimit urban dhe planifikimit për të ndihmuar në përthithjen e ndotësve. - Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave përmes zhvillimit të një sistemi të duhur të grumbullimit, ndarjes dhe riciklimit të mbeturinave për të reduktuar nevojën për djegie. - Nisja e fushatave të vetëdijesimit për të dekurajuar djegien joformale të mbeturinave. - Parandalimi i gjenerimit të mbeturinave dhe ripërdorimi i materialeve mund të zvogëlojë sasinë e mbeturinave në deponi duke parandaluar kështu emetimet e dëmshme në ajër. Zhurma dhe dridhjet: - Zhvillimi i brezave mbrojtës, barrierave të gjelbra dhe teknologjive izoluese të zërit përreth impianteve të mbeturinave dhe venddepozitimeve redukton zhurmën pranë zonave të banuara.

kontribuar në stres, ulje të përqendrimit dhe ndërprerje të përditshme për banorët përreth.	- Për zhvillime të reja në fushën e menaxhimit të mbeturinave, në fazat e planifikimit të kërkohet vlerësimi i ndikimit të zhurmës si pjesë e VNM-së - Promovimi i fushatave të vetëdijësisë mbi ndikimet shëndetësore të zhurmës nga aktivitetet dhe objektet e menaxhimit të mbeturinave dhe mënyrat për ta zbutur atë.
Faktorët klimatikë dhe ndryshimet klimatike	
Çështjet mjedisore dhe ndikimi i mundshëm i tyre	Mundësitë
Menaxhimi i joadekuat i mbeturinave, veçanërisht hedhja e mbeturinave të ngurta në lumenj dhe kanale, bllokun rrjedhat e ujit dhe zvogëlon kapacitetin e tyre, duke rritur si rrezikun ashtu edhe ashpërsinë e <i>përmbytjeve</i>. Përmbytjet e shpeshta, veçanërisht në pellgun e lumit Drini i Bardhë, mund të dëmtojnë infrastrukturën e menaxhimit të mbeturinave, ndërsa mbeturinat në sistemet ujore e përqesojnë më tej rrezikun e përmbytjeve. Menaxhimi i joadekuat i mbeturinave dhe deponitë e hapura përkeqësojnë efektet e <i>nxehtësisë dhe thatësisë</i>, pasi temperaturat e larta përshpejtojnë dekompozimin e mbeturinave, duke lëshuar gazra dhe erëra të dëmshme, ndërsa thatësitë mund të kufizojnë ujin e nevojshëm për menaxhimin dhe izolimin e sigurt të mbeturinave. <i>Rrëshqitjet e dheut</i>, të shkaktuara nga deponite ilegale sidomos atyre të ngurta, çojnë në bllokime dhe rrisin paqëndrueshmërinë e tokës në zonat e ndjeshme. Menaxhimi i dobët i mbeturinave në zonat e rrezikuara nga <i>tërmetet</i> shton rrezikun, pasi tërmetet mund të dëmtojnë venddepozitimet dhe ndotin tokën dhe ujin. Menaxhimi i dobët i mbeturinave përkeqëson ndikimet e <i>erërave dhe stuhive të breshër</i>, duke shpërndarë mbeturinat, bllokuar kanalizimet dhe rritur rrezikun për shëndetin dhe pastrimin. Erërat e fuqishme dhe stuhitë mund të dëmtojnë gjithashtu infrastrukturën dhe objektet e menaxhimit të mbeturinave. <i>Zjarret</i>, aktualisht ende jo të shkaktuara nga faktorët e ndryshimeve klimatike, por kryesisht nga neglizhenca njerëzore, po bëhen një rrezik në rritje për shkak të akumulimit të mbeturinave të djegshme dhe praktikave të këqija bujqësore. Menaxhimi i dobët i mbeturinave, veçanërisht materialet e djegshme, dhe praktikave e pakujdesshme bujqësore rrisin rrezikun e zjarreve në pyje. Emetimet e <i>gazeve serra</i> nga sektori i mbeturinave në Kosovë përbëjnë 5% të totalit, duke treguar një ndikim modest, por domethënës, me potencial për reduktime të synuara.	Zvogëlimi i mbeturinave në zonat natyrore mund të zbusë rrezikun nga përmbytjet, erozioni dhe zjarret. Brezat mbrojtës përreth venddepozitimeve dhe infrastrukturës së mbeturinave, si dhe hapësirat e gjelbra, rrisin qëndrueshmërinë ndaj përmbytjeve dhe valëve të të nxehtit. Prezantimi i infrastrukturës për ftohje rezervuarëve të ujit dhe planifikimit urban rezistent ndaj nxehtësisë ndihmon në uljen e efektit të “ishujve të nxehtësisë urbane”. Rritja e vetëdijes së komunitetit mbi ndikimet e ndryshimeve klimatike dhe lidhjen e tyre me praktikave të duhura të menaxhimit të mbeturinave mund të përmirësojë reagimin ndaj fatkeqësive natyrore.
Trashëgimia kulturore	
Çështjet mjedisore dhe ndikimi i mundshëm i tyre	Mundësitë
Praktikat e papërshtatshme të hedhjes së mbeturinave në afërsi të vendeve të trashëgimisë kontribuojnë në dëmtimin e trashëgimisë kulturore dhe prishjen e pamjes. Funksionimi i infrastrukturës për menaxhimin e mbeturinave pranë vendeve të trashëgimisë mund të ndikojë negativisht në rëndësinë e tyre, duke rrezikuar dëmtimin si të pasurive, ashtu edhe të mjedisit përreth, në varësi të afërsisë dhe vendndodhjes së infrastrukturës.	Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave pranë vendeve të trashëgimisë përmes krijimit të stabilimenteve të përshtatshme për hedhjen e mbeturinave dhe zbatimit të iniciativave të rregullta për pastrim në zonat me rëndësi kulturore. Rritja e ndërgjegjësisë së publikut mbi vlerën e mbrojtjes së trashëgimisë dhe rolin e menaxhimit të mbeturinave.
Peizazhi dhe vlerat vizuale estetike	
Çështjet mjedisore dhe ndikimi i mundshëm i tyre	Mundësitë
Deponitë e hapura ilegale pranë vendeve natyrore dhe ekologjike ikonike e dëmtojnë peizazhin dhe pamjen vizuale	Eliminimi i deponive ilegale të mbeturinave dhe rikthimi i tyre në habitate natyrore

dhe minojnë aftësinë e tyre për të tërhequr dhe zhvilluar turizmin.	Zbatimi i programeve për zvogëlimin e mbeturinave, pastrimin dhe mbrojtjen mjedisore për të ruajtur bukurinë e vendeve natyrore me rëndësi,
Aspekte të tjera të rëndësishme	
Çështjet mjedisore dhe ndikimi i mundshëm i tyre	Mundësitë
<i>Mbeturinat</i> Deponia e mbingarkuar në Pejë krijon ndotje dhe rreziqe mjedisore. Menaxhimi i dobët i mbeturinave të rrezikshme shtëpiake, ndërtimore, bujqësore dhe industriale mund të shkaktojë ndotje të ajrit, tokës dhe ujërave. Mbeturinat voluminoze shpesh përfundojnë në deponi ilegale duke shkaktuar dëme në ekosisteme dhe humbje të biodiversitetit. Emetimet e metanit nga deponitë mund të shkaktojnë pasoja serioze për mjedisin dhe shëndetin, duke kontribuar në ndryshimet klimatike, duke krijuar rreziqe për zjarr dhe shpërthime, si dhe duke ndikuar në cilësinë e ajrit. <i>Transporti i mbeturinave</i> Grumbullimi i mbeturinave me makineri të vjetra dhe të rënda shkakton pengesa në trafik dhe shton presionin mbi rrjetet rrugore, veçanërisht në zonat urbane dhe të mbingarkuara. Distanca midis gjenerimit të mbeturinave dhe vendndodhjes së hapësirave për menaxhimin e tyre ndikon në gjatësinë e transportit, duke rritur kostot e transportit dhe ndotjen e shkaktuar nga trafiku. Transporti dhe grumbullimi i jo-adekuat i mbeturinave mund të paraqesin rreziqe për sigurinë rrugore, pengesa në qarkullim dhe rritje të mundësisë për aksidente. Trajtimi i jo-adekuat i mbeturinave të rrezikshme gjatë transportit mund të paraqesë rreziqe për shëndetin e njerëzve, sigurinë e punonjësve dhe mjedisin.	<i>Mbeturinat</i> Programet e planifikuara për riciklim të ndarë janë mundësi për të formalizuar dhe zgjeruar përpjekjet për riciklim. Mundësia për të ndërtuar impiante të trajtimit të mbeturinave dhe stacione të transferit paraqet përfitime afatgjata në uljen e ndotjes, përmirësimin e shëndetit publik dhe mbrojtjen e ekosistemeve. Integrimi i ricikluesve informalë në sistemin formal mund të përmirësojë efikasitetin dhe mbledhjen e të dhënave. Zbatimi dhe fuqizimi i zbatimit të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit (EPR) mund të përmirësojë menaxhimin e mbeturinave dhe përgjegjshmërinë. Krijimi i sistemeve të dedikuara për mbeturinat e rrezikshme, ndërtimore, bujqësore dhe voluminoze mund të zvogëlojë ndikimin mjedisor. <i>Transporti i mbeturinave</i> Ndryshimet në sistemet e grumbullimit të mbeturinave ofrojnë mundësi për të përmirësuar efikasitetin dhe për të ulur presionin mbi rrjetet rrugore të mbingarkuara. Nxitja e zhvillimit të impianteve për trajtimin e mbeturinave më afër pikave të gjenerimit mund të zvogëlojë distancat e transportit, të ulë kostot dhe të zvogëlojë ndotjen e lidhur me trafikun.

2.3. Objektivat e VSM-së

Bazuar në problemet e identifikuara nga vlerësimi i mësipërm, janë përcaktuar objektiva të VSM-së për secilin aspekt mjedisor, të cilët janë përshkruar në tabelën më poshtë.

Tabela 10: Objektivat e VSM-së

Temat e VSM-së sipas kornizës ligjore	Temat e VSM-së të ndërlidhura me PNMIM-në	Objektivat e VSM-së
Biodiversiteti	Biodiversitetit (Flora, Ffuna) dhe zonat natyrore të mbrojtura	O1. Mbrojtja dhe përmirësimi i biodiversitetit dhe ekosistemeve nëpërmjet adoptimit të praktikave për menaxhimin e mbeturinave që janë të qëndrueshme dhe miqësore ndaj mjedisit

Popullsia dhe shëndeti i popullatës	Mirëqenia e popullatës dhe ekonomia lokale	O2. Mbështetja e zhvillimit ekonomik lokal (ekonomia qarkore) përmes zbatimit të praktikave innovative dhe efikase të menaxhimit të mbeturinave që zvogëlojnë konsumin e burimeve dhe gjenerimin e mbeturinave.
	Shëndeti i popullatës	O3. Eliminimi ose zvogëlimi i rreziqeve shëndetësore të lidhura me hedhjen dhe trajtimin e mbeturinave si rezultat i zbatimit të PNMIM-së. O4. Zvogëlimi i shqetësimeve për banorët lokal që rrjedhin nga zbatimi i aktiviteteve të PNMIM-së.
Toka	Shfrytëzimi i tokës dhe cilësia e saj	O5. Mbrojtja e tokës (tokës bujqësore) nga ndikimet e mundshme negative të aktiviteteve të PNMIM-së.
Uji	Uji	O6. Të mbrohen burimet ujore dhe të parandalohet ndotja e mundshme si rezultat i zbatimit të aktiviteteve të PNMIM-së. O7. Të përmirësohet cilësia e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe të promovohet menaxhimi i qëndrueshëm i ujit përmes zbatimit të PNMIM-së.
Ajri dhe klima	Kualiteti i ajrit, zhurma dhe dridhjet	O8. Të zvogëlohen emetimet e gazeve dhe grimcave të dëmshme nga aktivitetet e trajtimit dhe transportit të mbeturinave O9. Të minimizohen shqetësimet nga zhurmat dhe dridhjet e shkaktuara nga aktivitetet që lidhen me zbatimin e PNMIM-së..
	Ndryshimet klimatike	O10. Të minimizohen emetimet e gazërave serrë që rezultojnë nga aktivitetet e PNMIM-së dhe të rritet qëndrueshmëria ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike. O11. Të merren parasysh dhe të minimizohen rreziqet që lidhen me ndryshimet klimatike, veçanërisht përmbytjet, gjatë planifikimit dhe zbatimit të PNMIM-së.
Peisazhi dhe trashëgimia kulturore	Trashëgimia kulturore dhe arkeologjike	O12. Të ruhet dhe mbrohet trashëgimia kulturore dhe asetet e saj, së bashku me mjedisin përreth, gjatë zbatimit të aktiviteteve të PNMIM-së.
	Peisazhi i ndërtuar dhe i pandërtuar	O13. Të mbrohet dhe përmirësohet cilësia e peisazhit natyror dhe urban, si dhe pamja vizuale, gjatë planifikimit dhe zbatimit të aktiviteteve të PNMIM-së.
Asetet tjera	Mbeturinave	O14. Të përmirësohet menaxhimi i mbeturinave në Zonën e Menaxhimit të Mbeturinave 3 - Pejë (përfshihen Peja, Istogu, Klina, Deçani dhe Juniku), të promovohet ekonomia qarkore, të reduktohen ndikimet mjedisore dhe shoqërore, si dhe të mbështetet përdorimi i qëndrueshëm i burimeve.
	Transportimi i mbeturinave	O15. Të minimizohet volumi i trafikut të lidhur me aktivitetet e menaxhimit të mbeturinave në kuadër të PNMIM-së dhe të promovohen zgjedhje më të qëndrueshme të transportit.

III. PËRSHKRIMI I PËRMBAJTJES SË PLANIT NDËRKOMUNAL PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETURINAVE (PNMIM) NË ZONËN E MENAXHIMIT TË MBETURINAVE 3 - PEJË (PËRFSHIHEN PEJA, ISTOGU, KLINA, DEÇANI DHE JUNIKU)

3.1. Përshkrim i shkurtër i përmbajtjes së PNMIM-së

PNMIM-ja përbëhet nga katër komponentë:

1. Vlerësimi i gjendjes fillestare dhe nevojave
2. Raporti i parashikimit (projeksioneve) dhe kompozicionit të mbeturinave

3. Analiza e opsioneve
4. Plan i veprimit për zbatimin e PNMIM-së

3.1.1. Vlerësimi fillestar dhe i nevojave

Qëllimi i PNMIM-së

Vlerësimi fillestar dhe i nevojave përcakton qëllimin kryesor të këtij PNMIM-i për Zonën e Menaxhimit të Mbeturinave 3 - Pejë (përfshihen Peja, Istogu, Klina, Deçani dhe Juniku), i cili është përmirësimi i kushteve për ofrimin e shërbimeve publike dhe zhvillimin e ekonomive lokale në përputhje me kërkesat e BE-së, përmes promovimit të bashkëpunimit ndërkomunal rajonal dhe transferimit të njohurive ndërmjet sektorit publik, sektorit privat dhe shoqërisë civile. Duke paraqitur një vizion për menaxhimin e mbeturinave në vitet e ardhshme dhe duke identifikuar masat për përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave në Zonën e Menaxhimit të Mbeturinave 3 - Pejë (përfshihen Peja, Istogu, Klina, Deçani dhe Juniku), Plan i synon gjithashtu të sigurojë vendosjen e praktikave më të mira mjedisore për menaxhimin e integruar të mbeturinave në Zonën e Menaxhimit të Mbeturinave 3 - Pejë (përfshihen Peja, Istogu, Klina, Deçani dhe Juniku).

Plan i synon t'u mundësojë autoriteteve lokale përmirësimin e shërbimeve komunale në përputhje me Agjendën e Gjellbër të BE-së për Ballkanin Perëndimor, duke kontribuar në arritjen e Agjendës 2030 dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Korniza ligjore dhe rregullative

Brenda kornizës ligjore dhe rregullative, përshkruhen Direktivat kryesore të BE-së dhe Legjislacioni për Menaxhimin e Mbeturinave në Kosovë (primar dhe sekondar). Plan i referohet Direktivës Kornizë për Mbeturinat (Direktiva 2008/98/KE) si direktiva kryesore e BE-së, e cila konfirmon 'parimin ndotësi paguan (PNP)', sipas të cilit prodhuesi fillestar i mbeturinave duhet të paguajë për kostot e menaxhimit të mbeturinave. Ajo prezanton konceptin e 'përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit (PZP)', sipas të cilit prodhuesit e produkteve mbajnë përgjegjësi financiare ose përgjegjësi financiare dhe organizative për menaxhimin e mbeturinave gjatë fazës së fundit të ciklit jetësor të produktit.

Dispozitat kryesore të Direktivës përfshijnë:

- Menaxhimi i mbeturinave duhet të kryhet pa rrezik për ujin, ajrin, tokën, bimët apo kafshët, pa shkaktuar shqetësime përmes zhurmës apo aromave të pakëndshme, ose duke dëmtuar peizazhin apo vendet me interes të veçantë.
- Prodhuesit ose mbajtësit e mbeturinave duhet t'i trajtojnë ato vetë ose t'i dorëzojnë një operatori të njohur zyrtarisht. Të dyja rastet kërkojnë leje dhe inspektohen periodikisht.
- Autoritetet kompetente kombëtare duhet të hartojnë plane për menaxhimin e mbeturinave dhe programe për parandalimin e tyre.
- Aplikohen kushte të veçanta për mbeturinat e rrezikshme, vajrave mbeturinë dhe bio-mbeturinat.
- Ajo vendos objektiva për riciklimin dhe rikuperimin që duhet të arrihen deri në vitin 2020 për mbeturinat shtëpiake (50%) dhe mbeturinat nga ndërtimi dhe demolimi (70%).

Direktiva përcakton hierarkinë e mëposhtme të veprimtarive të menaxhimit të mbeturinave:

- Parandalimi
- Përgatitja për ripërdorim
- Riciklimi
- Rikuperimi
- Deponimi

Direktivat e tjera të lidhura janë paraqitur dhe elaboruar shkurtimisht.

Në lidhje me ligjin përkatës të Kosovës, nr. 04/L-060 për mbeturinat, Plani thekson dobësinë e tij për shkak të mungesës së skemave të përcaktuara për “kërkesat minimale për përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit (PZP)” dhe procedurës së lejeve për organizatat që zbatojnë detyrimet e PZP-së në emër të prodhuesve të produkteve, e cila duhet të trajtohet në Ligjin e ri që pritet të përgatitet, për të cilin është zhvilluar një Koncept-dokument dhe është në pritje të miratimit nga Qeveria.

Në lidhje me harmonizimin e kornizës ligjore të Kosovës për mbeturinat me acquis-në e BE-së, ende ekzistojnë boshllëqe të konsiderueshme në kornizën ligjore ekzistuese që duhet të adresohen, në mënyrë që të mund të zbatohet politika kombëtare për menaxhimin e mbeturinave, siç është parashikuar në SKMIM-në e rishikuar.

Korniza institucionale dhe organizative

Entitetet institucionale përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave në të dy nivelet janë listuar dhe përgjegjësitë e tyre janë shpjeguar.

Raporti me planet dhe programet e tjera përkatëse dhe Direktivat e BE-së

Përgatitja e PNMIM-it udhëhiqet nga **Strategjia e Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (SKMIM)** 2024-2035 dhe Plani i Veprimit për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PVMIM) 2024-2026. PNMIM përshkruan shkurtimisht objektivat e SKMIM-së dhe qëllimet e saj, të cilat përfshijnë: objektiva për ripërdorimin dhe riciklimin e mbeturinave komunale; objektiva për grupe specifike mbeturinash, objektiva për riciklimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi. Këto objektiva duhet të përfshihen në PNMIM. Plani ka identifikuar një boshllëk, pasi disa objektiva kalojnë afatin kohor të PVMIM-it.

Është dhënë një pasqyrë e **Planeve të menaxhimit të mbeturinave inerte komunale (PMMIK)** për komunat në Zonën e Menaxhimit të Mbeturinave 3 - Pejë (përfshihen Peja, Istogu, Klina, Deçani dhe Juniku), duke dëshmuar se të gjitha komunat në këtë rajon kanë miratuar PMMIK-të deri në vitin 2027 dhe Juniku deri në vitin 2025.

Përshkrimi i karakteristikave të rajonit

Kapitulli i dytë i PNMIM-së ofron një përshkrim të karakteristikave fiziko-gjeografike, popullsisë dhe profilit socio-ekonomik të rajonit. Kushtet e mira klimatike, pozita gjeografike dhe relievi e mbështesin bujqësinë, blegtorinë, bletarinë dhe pylltarinë, ndërsa lumenjtë dhe burimet natyrore të ujit sigurojnë burime të rëndësishme ujore për ujitje dhe pije. Rajoni është i pasur me burime minerale, përfshirë plumbin, zinkun dhe argjendin, megjithëse aktivitetet minerare kanë ndikuar në mjedis. Meqenëse popullsia rurale është mbizotëruese, bujqësia, pylltaria dhe turizmi janë shtytësit kryesorë të ekonomisë lokale, duke bërë që punësimi të jetë i përqendruar kryesisht në bujqësi (bujqësi, blegtori dhe pylltari), si dhe në sektorin e shërbimeve (shitje me pakicë, mikpritje dhe administratë publike), industri (ndërmarrje të vogla dhe të mesme të tekstilit, mobilieve dhe përpunimit të ushqimit) dhe sektorin publik (arsim, shëndetësi dhe qeverisje lokale). Shkalla e papunësisë, veçanërisht te të rinjtë dhe gratë, është relativisht e lartë në Kosovë, përfshirë edhe Pejën. Faktorët kontribues përfshijnë mospërputhjen e aftësive me kërkesat e tregut, mungesën e mundësive të punësimit jashtë qendrave urbane dhe varësinë ekonomike nga remitancat, gjë që e bën ekonominë të ndjeshme ndaj kushteve të jashtme ekonomike. Sfidat infrastrukturore, veçanërisht në transport dhe shërbime komunale, gjithashtu pengojnë rritjen ekonomike dhe qasjen në shërbime. Modernizimi i bujqësisë, promovimi i praktikave të qëndrueshme dhe rritja e produktivitetit mund të rrisin të ardhurat në zonat rurale. Zhvillimi i turizmit, veçanërisht eko-turizmit në zona si Gryka e Rugovës, dhe mbështetja për bizneset e vogla me trajnime dhe financime mund të krijojnë vende pune. Investimi në arsim dhe aftësim profesional do të përmirësojë mundësitë për punësim. Përmirësimi i infrastrukturës, si rrugët, shërbimet komunale dhe telekomunikimi, do të tërheqë investime dhe do të përmirësojë standardin e jetesës.

Adresimi i këtyre sfidave do të ndihmojë në nxitjen e një rritjeje të qëndrueshme, uljen e varfërisë dhe përmirësimin e cilësisë së jetës në Pejë.

Gjendja Fillestare e Menaxhimit të Mbeturinave

Kapitulli i tretë jep një përmbledhje të vlerësimit të sasisë së mbeturinave të prodhuara në Zonën e Menaxhimit të Mbeturinave 3 - Pejë (përfshihen Peja, Istogu, Klina, Deçani dhe Juniku) nga secila prej tre kategorive kryesore: *a) amvisëritë, b) bizneset dhe c) institucionet.*

Gjenerimi mesatar i mbeturinave nga amvisëritë për person ndryshon midis komunave nga 133 (Junik) në 374 (Pejë) kg/vit me një mesatare të përgjithshme për rajonin prej 279 kg/person/vit ose 0.76 kg/person/ditë.

Vlerësimi i **mbeturinave të gjeneruara nga subjektet komerciale** dhe institucionet, të njohura si mbeturina të ngjashme me ato shtëpiake, bazohet zakonisht në dy supozime: në zonat urbane ato përbëjnë 15% të totalit të mbeturinave shtëpiake, ndërsa në zonat rurale përbëjnë 5%. Ky vlerësim përdoret në mungesë të të dhënave të besueshme.

Sa i përket **mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi (MND)**, burimi më i rëndësishëm i gjenerimit të MND-ve është sektori i ndërtimit – rreth 70%. Sipas Planit Kombëtar për Menaxhimin e Mbeturinave nga Ndërtimi dhe Demolimi (PKMMND), amvisëritë kontribuojnë në gjenerimin e përgjithshëm të MND-ve me vetëm 3%.

Vlerësimi i **mbeturinave të gjelbra nga hapësirat publike të gjelbra** zakonisht bazohet në dy supozime: në zonat urbane ato përbëjnë 30 kg për person në vit, ndërsa në zonat rurale përbëjnë 10 kg për person në vit. Ky vlerësim përdoret në mungesë të të dhënave të besueshme.

Sa i përket **përbërjes së mbeturinave**, përbërja e mbeturinave komunale në këtë rajon nga tetori 2021 deri në nëntor 2022 ka treguar se mbeturinat organike përbëjnë përqindjen më të lartë (~30%), të ndjekura nga plastika dhe letra/kartoni. Mbeturinat e rrezikshme paraqesin përqindjen më të ulët, me vetëm 0.1% nga kategoria e mbeturinave.

Tabela 11: Përbërja e mbeturinave

Kategoria e mbeturinave	Rezultati mesatar	Kategoria e mbeturinave	Rezultati mesatar
Mbeturinat organike	29.7%	Xham	7.1%
Mbeturinat e gjelbra	3.3%	Dru	1.8%
Tetrapak	1.9%	MND	2.4%
Plastikë	18.5%	Mbeturinat e rrezikshme	0.1%
Letër/karton	16.8%	Pelenat	2.4%
Tekstil	6.8%	Mbeturinat e imëta	7.4%
Metal	1.8%		
Gjithsej	100.0%		

Në kuadër të seksionit të shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave komunale, shërbimi i mbledhjes së mbeturinave (SHMM) në Pejë, Istog dhe Klinë kryhet nga një Kompani Rajonale e Mbeturinave (KRM), Deçani ka kompaninë e vet dhe në Junik përmes një kompanie private të kontraktuar. Shërbimi i mbledhjes së mbeturinave ofrohet për 100% të banorëve të përhershëm në 4 nga 5 komunat e rajonit. Në Klinë, raportohet se mbledhja e mbeturinave ofrohet për 98% të popullsisë me plane për të rritur mbulimin e shërbimit në 100%.

Edhe pse një përpjekje e tillë në Pejë nuk pati sukses, **mbledhja e ndarë e mbeturinave** për materialet e riciklueshme ende nuk është e organizuar në asnjë nga pesë komunat. Megjithatë, komunat

planifikojnë të fillojnë zbatimin e saj në vitin 2025. Të gjitha pesë komunat kanë identifikuar lokacionet për ngritjen e oborreve të riciklimit (OR).

Asnjë **stacion transferi** nuk është në përdorim në ZMM. Një lokacion në Istog fillimisht ishte paraparë të shfrytëzohej si stacion transferi nga ku mbeturinat do të transportoheshin në deponinë rajonale të Pejës. Mirëpo, për shkak të problemeve fillestare të pajisjeve dhe kostove të larta të transportit deri në deponinë e Pejës, lokacioni në Istog përfundoi duke u përdorur si deponi. Ky i fundit tani është i mbyllur dhe mbeturinat nga Istogu transportohen direkt në deponinë rajonale në Pejë.

Në ZMM mungojnë **objektet formale të trajtimit** të mbeturinave, gjë që kufizon menaxhimin e duhur të tyre. SKMIM-i i përditësuar parasheh infrastrukturë për riciklimin dhe rikuperimin e mbeturinave për të gjitha ZMM-të.

Të gjitha komunat e rajonit i **deponojnë mbeturinat e tyre komunale** në deponinë e Pejës. Aktualisht, trupi i deponisë është shumë i lartë dhe pothuajse nuk zbatohen procedura operative. Kapaciteti i deponisë është varfëruar për një kohë të gjatë. Numri i **deponive të hapura** ka shënuar rënie të ndjeshme vitet e fundit; Në vitin 2021 ishin evidentuar 70 deponi ilegale të mbeturinave. Juniku është përjashtim, pasi nuk ka **deponi të hapura** që nga viti 2019.

Informacioni mbi **lëvizjen e mbeturinave** brenda dhe jashtë ZMM-së është i kufizuar. Komuna e Pejës ka vlerësuar se në vitin 2023 janë eksportuar 12,176 tonë mbeturina të riciklueshme. Mbeturinat e riciklueshme dhe fraksionet tjera të mbeturinave nga PZP-të transportohen brenda dhe jashtë rajonit në varësi të lokacionit të objekteve të licencuara për mbledhje, ruajtje, përpunim/riciklim/trajtim të tyre. Sektori informal luan një rol kyç në procesin e riciklimit në gjithë vendin, veçanërisht në ZMM, duke ndarë materialet e riciklueshme. Ai mbledh materiale të riciklueshme me vlerë tregu dhe i dorëzon te operatorët e riciklimit. Të dhënat mbi sasinë e materialeve të riciklueshme të mbledhura veçmas në ZMM nuk janë të disponueshme.

PNMIM ofron gjithashtu informacion mbi **stafin dhe tarifat e menaxhimit të mbeturinave**.

PNMIM gjithashtu ofron informacion mbi menaxhimin e llojeve të tjera të mbeturinave, përfshirë:

- **Fraksionet e veçanta të mbeturinave** (automjete jashtë përdorimit – AJP, vajra të përdorur, mbeturina nga pajisjet elektrike dhe elektronike – MPEE, goma të vjetra dhe të shpenzuara, bateri të shpenzuara). Megjithëse korniza rregullative kombëtar përcakton që këto duhet të menaxhohen përmes mekanizmit të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit (PZP), një mekanizëm i tillë ndë nuk është krijuar. PNMIM identifikon boshllëqe në kuadrin rregullativ, i cili nuk përcakton kërkesat minimale për themelimin e skemave të PZP-së, siç parashihet në Direktivën Kuadër për Mbeturinat.
- **Mbeturinat e rrezikshme të amvisërisë (MRrA):** Asnjë nga komunat e Zonës së Menaxhimit të Mbeturinave 3 - Pejë (përfshihen Peja, Istogu, Klina, Deçani dhe Juniku) nuk zbaton sistem për mbledhjen e ndarë të mbeturinave të rrezikshme të amvisërisë.
- **Mbeturinat medicinale** gjenerohen përmes shërbimeve të kujdesit parësor shëndetësor në secilën komunë dhe përmes shërbimeve dytësore dhe tretësore në Pejë. Mbeturinat infektive dhe të mprehta trajtohen në autoklava hibride në spitalin rajonal në Pejë. Autoklava është instaluar në vitin 2012 dhe ka kapacitet prej 350 litra për cikël.
- **Mbeturinat e ndërtimit dhe demolimit (MND)** aktualisht trajtohen vetëm në Komunën e Junikut, e cila ka marrëveshje me operatorë privat në ZMM. Disa komuna, si Peja dhe Klina, kanë ndarë lokacione specifike për deponim të përkohshëm.
- **Mbeturinat e vëllimshme:** Nuk ka të dhëna të disponueshme për sasinë e mbeturinave të vëllimshme në mbeturinat e përziera komunale dhe raportohet se këto mbeturina shpesh përfundojnë në deponitë ilegale. Megjithatë, mbeturinat e vëllimshme nuk u hasën në

deponitë ilegale në vitin 2022 (AMMK). Komuna e Pejës ofron shërbimin e grumbullimit të mbeturinave të vëllimshme edhe pse ende nuk ka një sistem për trajtimin e tyre.

- **Mbeturinat bujqësore:** Nuk ka informacion mbi menaxhimin e mbeturinave bujqësore, të cilat pritet të gjenerohen në sasi të konsiderueshme çdo vit. Menaxhimi i mbeturinave bujqësore duhet të ndjekë parimin “ndotësi paguan”, sipas të cilit prodhuesit janë përgjegjës për menaxhimin dhe kostot e tyre.
- **Mbeturinat industriale:** Asnjë minierë aktive nuk është në funksion në rajon. Mbeturinat industriale të rrezikshme, të cilat gjenden vetëm në Pejë, përbëjnë 1% të mbeturinave në deponitë ilegale. Mbeturinat industriale jo të rrezikshme, rreth 8,500 tonë në vitin 2023, deponohen në deponinë rajonale. Industrive të mëdha u kërkohet të kenë plane për menaxhimin e mbeturinave për tu pajisur me Lejet Mjedisore të integruara (LMI) për parandalimin dhe kontrollin e ndotjes së integruar.
- **Mbeturinat nga ITUZ:** Në rajon ekziston vetëm një impiant për trajtimin e ujërave të zeza (ITUZ), në qytetin e Pejës, i ndërtuar në vitin 2022. Proceset e trajtimit që përdoren në impiant janë stacionet e pompimit, trajtimi mekanik dhe biologjik i kanalizimeve, tretja anaerobe e lymit, prodhimi dhe shfrytëzimi i biogazit dhe prodhimi i energjisë elektrike dhe nxehtësisë që mbulojnë shumicën e kërkesave të impiantit për furnizim me energji elektrike.

Seksioni i **Analizës së mangësive** të situatës aktuale të menaxhimit të mbeturinave paraqet masat për përmirësim dhe vendos objektiva të qarta.

3.1.2. Raporti për parashikimin dhe përbërjen e mbeturinave

Parashikimi i popullsisë është zhvilluar bazuar në të dhënat e Regjistrimit të publikuara në vitin 2024. Pritet që popullsia e Zonës së Menaxhimit të Mbeturinave 3 - Pejë (përfshihen Peja, Istogu, Klina, Deçani dhe Juniku) të zvogëlohet në mënyrë të papërfillshme gjatë periudhës së planifikimit dhe të mbetet pak nën 180,000 banorë. Megjithatë pritet që popullsia e rajonit të mbetet relativisht e qëndrueshme, sasia e mbeturinave pritet të rritet për 7% në fund të periudhës së planifikimit dhe të arrijë rreth 73,000 tonë në vitin 2035. Kjo rritje i atribuohet pritjes për rritje të BPV-së gjatë kësaj periudhe. Brenda përbërjes së mbeturinave, fraksioni më i madh është ai i mbeturinave ushqimore (29.74%), i ndjekur nga plastika (18.45%) dhe letra dhe kartoni (16.82%).

3.1.3. Analiza e opsioneve

Objektivat dhe synimet për sistemin e menaxhimit të mbeturinave në Zonën e Menaxhimit të Mbeturinave 3 - Pejë (përfshihen Peja, Istogu, Klina, Deçani dhe Juniku), në përputhje me dispozitat e SKMIM 2024-2035, përfshijnë:

- O.1. Rritja e mbulueshmërisë së shërbimit të mbledhjes së mbeturinave në 100% deri në vitin 2026
- O.2. Rritja e riciklimit dhe rikuperimit të burimeve
 - Mbeturinat komunale të përgatitura për ripërdorim dhe riciklim nga <5% në 20% deri në vitin 2030, 50% deri në vitin 2035 dhe 60% deri në vitin 2045.
 - Popullsia e pajisur me shërbime për mbledhje të veçantë të mbeturinave: 80% deri në vitin 2030, 90% deri në vitin 2035 dhe 100% deri në vitin 2045.
 - Rikuperimi i të gjitha mbeturinave të ambalazhit nga <5% (aktualisht) në 45% deri në vitin 2028, 60% deri në vitin 2030 dhe 70% deri në vitin 2035.
 - Riciklimi i të gjitha mbeturinave të ambalazhit (Plastikë, Letër dhe karton, Xham, Metale të hekurta, Alumin dhe Dru) nga niveli aktual bazë prej <5% në objektiva të ndryshme për secilin lloj ambalazhi gjatë periudhës 2028–2035.
- O.3. Reduktimi i varësisë nga depozitimi i mbeturinave

- Depozitimi i mbeturinave komunale nga >95% aktualisht në <30% deri në vitin 2035 dhe <10% deri në vitin 2045.
 - Mbyllja e 70 deponive komunale deri në vitin 2028.
- O.4. Rritja e riciklimit dhe rikuperimit të mbeturinave nga ndërtimi dhe shembjet
- Ripërdorimi dhe riciklimi i mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi (MND) nga 0% aktualisht në 40% deri në vitin 2030 dhe 50% deri në vitin 2035.
 - Ripërdorimi, riciklimi dhe rikuperimi i materialeve të tjera nga MND nga 0% aktualisht në 60% deri në vitin 2030 dhe 70% deri në vitin 2035.

Analiza e Opsioneve

Metodologjia për zhvillimin e opsioneve për një sistem të integruar të menaxhimit të mbeturinave në ZMM bazohet në kritere që përfshijnë infrastrukturën ekzistuese dhe të planifikuar, vlerësimin e nevojave aktuale dhe të ardhshme, përputhshmërinë me legjislacionin dhe objektivat e SKMIM 2024-2035 dhe analizën e opsioneve bazuar në praktikat më të mira, standardet e BE-së, mundësinë financiare dhe aplikueshmërinë lokale. Analiza e opsioneve bazohet në supozimin kryesor që shërbimet e menaxhimit të mbeturinave në ZMM do të ofrohen ose në bazë rajonale ose në bazë nën-rajonale, përkundër ofrimit të shërbimeve të mbeturinave nga çdo autoritet lokal publik.

Përshkrimi në terma të situatës aktuale, opsioneve, krahasimit të kostove të opsioneve, teknologjive që do të përdoren, etj., për **komponentët e mëposhtëm të mbeturinave** (Parandalimi i mbeturinave, Deponimi i mbeturinave, Transporti dhe transferimi i mbeturinave, Mbledhja e ndarë e mbeturinave, Riciklimi dhe rikuperimi i mbeturinave dhe depozitimi i mbeturinave) është ofruar.

Menaxhimi i fraksioneve tjera të mbeturinave

- *Mbeturinat nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve (MND):* MND-të e gjeneruara nga kantieret ndërtimore komunale dhe private përfshijnë dheun nga gërmimet, mbeturinat e ndërtimit dhe mbeturinat nga demolimi si betoni, tullat, druri dhe plastika. Një pjesë e konsiderueshme (~80-85%) e MND-ve përbëhet nga materiale të riciklueshme si betoni, asfalti, qeramika, shpatat dhe mbeturinat minerale, të cilat mund të ripërdoren në aplikime si ndërtimi i rrugëve, ngritja e argjinaturave dhe sistemet e kullimit. Për të menaxhuar këtë në mënyrë efektive, Zona e Menaxhimit të Mbeturinave 3 - Pejë (përfshihen Peja, Istogu, Klina, Deçani dhe Juniku) duhet të zhvillojë një sistem të integruar për menaxhimin e mbeturinave, në përputhje me Planin Kombëtar për Menaxhimin e Mbeturinave nga Ndërtimi dhe Demolimi (PKMMND). Deri në vitin 2030, pritet që Zona e Menaxhimit të Mbeturinave 3 - Pejë (përfshihen Peja, Istogu, Klina, Deçani dhe Juniku) të gjenerojë 59,010 tonë (71,045 m³) MND, që kërkon ngritjen e një rrjeti pikash për hedhjen e mbeturinave (PH) në: Pejë (që do të shërbejë për Deçan dhe Junik), Istog, Klinë, dhe Deçan. Secila pikë do të jetë e pajisur për mbledhjen dhe deponimin e përkohshëm të këtyre mbeturinave. Një qendër rajonale e riciklimit, e pajisur me një makinë lëvizëse për thërmimin e mbeturinave (kapaciteti: 12,800 m³/vit), është planifikuar për përpunimin dhe ndarjen e MND-ve për qëllime ripërdorimi. Ndërkohë, 15% e mbeturinave hyrëse dhe atyre të pambledhura do të përfundojnë në deponi. Një seksion i veçantë do të përdoret për trajtimin e mbeturinave të rrezikshme që përmbajnë azbest (500 m³/vit), ndërsa kostot e menaxhimit do të mbulohen nga përdoruesit, jo nga amvisëritë.
- *Mbeturinat e vëllimshme:* Në nivel ndërkombëtar, mbeturinat e vëllimshme përbëjnë rreth 5% të mbeturinave komunale dhe përfshijnë artikuj si mobilje të vjetra, dyshekë, pajisje të mëdha shtëpiake dhe disa mbeturina ndërtimi ose kopshti. Menaxhimi fillestar në rajon do të përqendrohet në mbledhjen e planifikuar komunale dhe PH-të e centralizuara. Mbeturinat e vëllimshme do të çmontohen në deponinë rajonale ose në objektin e TMB-së, me copëtim për të zvogëluar vëllimin. Strategjitë afatgjata përfshijnë promovimin e ripërdorimit përmes

donacioneve, shitësve të dorës së dytë ose qendrave të riparimit që përfshijnë OJQ-të dhe grupet vulnerabël.

- *Fraksionet e veçanta të mbeturinave:* Pasi të zbatohen plotësisht skemat e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit (PZP), komunat brenda ZMM do të bashkëpunojnë me operatorët PZP-së për të menaxhuar fraksione specifike të mbeturinave, duke përfshirë: pajisjet elektronike, vajrat, bateritë, gomat, dhe automjetet.

Do të krijohen Oborret e Riciklimit (OR) në të pesë qendrat komunale, për të mbledhur materiale të riciklueshme, mbeturina të vëllimshme, mbeturina të rrezikshme dhe lloje të tjera të veçanta të mbeturinave, në lokacione të përshtatshme të identifikuara tashmë.

- *Mbeturinaturinat bujqësore,* të cilat përfshijnë indet bimore, nënprodukte shtazore, plehun organik, dhe mbeturinave agro-kimike, nuk kanë një sistem të dokumentuar të menaxhimit dhe duhet të trajtohen nga vetë prodhuesit, në përputhje me parimin "ndotësi paguan".
 - Mbeturinat e indeve bimore duhet të menaxhohen siç duhet për të parandaluar dëmet mjedisore, siç janë emetimet e metanit, ndotja e ujërave dhe ndotja e ajrit. Menaxhimi i tyre duhet të ndjekë hierarkinë e mbeturinave, duke prioritetizuar riciklimin (p.sh. kompostimi ose përdorimi industrial), dhe, kur kjo nuk është e realizueshme, shfrytëzimin për prodhimin e energjisë. Kostot e trajtimit duhet të mbulohen nga prodhuesit e mbeturinave.
 - Lidhur me nënproduktet e kafshëve (NeK), një objekt qendror për trajtimin e NeK-ve është ndërtuar afër Prishtinës, por ende nuk është funksional; derisa të bëhet funksionalizimi i tij dhe të ofrohet shërbimi i mbledhjes dhe trajtimit të NeK-ve për të gjithë prodhuesit në mbarë vendin, NeK-të duhet të deponohen në lokacione të autorizuara.
 - Përqendrimi total i lëndëve të ngurta përcakton nëse plehu i bagëtive klasifikohet si i ngurtë, gjysmë i ngurtë apo i lëngshëm, gjë që ndikon në trajtimin dhe përshtatshmërinë e tij për metodat e menaxhimit siç janë deponimi, aplikimi në tokë, kompostimi ose tretja anaerobe.
 - Mbeturinat e rrezikshme agrokimike, siç janë lubrifikantët e përdorur, pesticidet dhe herbicidet, kërkojnë menaxhim të veçantë, mundësisht përmes riciklimit ose djegies në temperaturë të lartë (p.sh. në furrat e çimentos që përmbushin standardet e BE-së). Nëse trajtimi nuk është i realizueshëm, ato duhet të ruhen në mënyrë të sigurt derisa të vihet në funksion objekti kombëtar për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme i parashikuar nga SKMIM-ja.

Analiza gjithashtu shqyrton Opsionet për ngritjen e strukturës institucionale dhe organizative.

- Lidhur me **mbledhjen e mbeturinave**, është vendosur tashmë që deponia rajonale e përmirësuar në Sferkë do të operohet nga Kompania për Menaxhim të Deponive të Kosovës (KMDK). Megjithatë, për aktivitetet e tjera të menaxhimit të mbeturinave u morën në konsideratë opsione të ndryshme për aranzhime operationale dhe opsioni 1: Ruajtja e situatës aktuale është zgjedhur si më i përshtatshmi. Sipas këtij opsioni, KRM Ambienti do të vazhdojë të ofrojë shërbime të mbledhjes së mbeturinave për komunat e Pejës, Istogut dhe Klinës, ndërsa Deçani do të shërbehet nga ndërmarrja e saj komunale Higjiëna, dhe Juniku do të vazhdojë me aranzhime vetanake.
- Analiza rekomandon **stacione transferimi** për Istogun dhe Deçanin përfshirë Junikun. Sipas opsionit të preferuar, komunat do të menaxhojnë stacionet dhe do të vendosin për operatorët, ku Istogu potencialisht do të zgjedhë KRM Ambienti ose një operator privat, dhe Deçani do të vendosë midis kompanisë së tij Higjiëna ose një operatori privat.
- Opsioni i preferuar për **kompostimin e mbeturinave të gjelbra të mbledhura ndaras** është një model i decentralizuar me objekte në secilën komunë. Ai përfshin menaxhimin komunal

të objekteve, ku komunat zgjedhin operatorët e tyre. Peja, Istogu dhe Klina mund të zgjedhin KRM Ambienti ose një operator privat, ndërsa Deçani mund të zgjedhë kompaninë e saj Higjiena ose një operator privat. Komunat gjithashtu mund të përdorin shërbimet e departamenteve të tyre të përgjegjëse për mirëmbajtjen e hapësirave publike.

- Rekomandohet që **grumbullimi ndaras dhe klasifikimi i mëpasshëm i mbeturinave të ambalazhit** të menaxhohet përmes skemave të ardhshme PZP.
- **Operacionet e rikuperimit të mbeturinave:** Objektet e rikuperimit të mbeturinave do të jenë objekte rajonale.
- Opsionet e preferuara marrin në konsideratë **integrimin gjinor dhe grupet e cenueshme**. Mbledhësit informalë të mbeturinave, rreth 2,000 në Kosovë, mbledhin materiale të riciklueshme dhe ua shesin ato kompanive të licencuara. Përpjekjet për të formalizuar punën e tyre kanë qenë të kufizuara dhe investimet e propozuara mund të ndikojnë në grupet e cenueshme dhe barazinë gjinore. Janë identifikuar ndikimet dhe masat e mundshme për integrimin gjinor dhe përfshirjen sociale.

Një përmbledhje e sistemit të preferuar për menaxhimin e integruar të mbeturinave të ngurta është dhënë në tabelën në vijim, ndërsa lokacioni i objekteve të parashikuara për menaxhimin e mbeturinave në ZMM paraqitet në hartën më poshtë.

Tabela 12: përmbledhje e sistemit të preferuar për menaxhimin e integruar të mbeturinave të ngurta

Përbërësit e sistemit	Përshkrimi	Kapaciteti	Viti/periudha
Parandalimi i mbeturinave	Zhvillimi dhe zbatimi i programeve të kompostimit shtëpiak Miratimi i udhëzimeve për prokurimin e gjelbër publik Mbështetja e bizneseve lokale në zbatimin e masave për parandalimin e mbeturinave ushqimore Pjesëmarrja në nismat kombëtare për reduktimin e plastikës njëpërdorimshe	n/a	Vazhdimisht
Grumbullimi i mbeturinave të përziera	Shporta individuale plastike 120/240 l për shtëpi familjare Shporta plastike individuale 120/240 l ose kontejnerë 1.1 m³ për ndërtesa shumëkatëshe në zonat urbane	54,234 tonë mbeturina të përziera të mbledhura në vitin 2026 37,644 ton të mbledhura në vitin 2035	Ndërrimi gradual i kontejnerëve dhe automjeteve grumbulluese
Mbledhja ndaras e mbeturinave	Shporta individuale plastike 120/240 l për grumbullimin e materialeve të riciklueshme, Kontejnerë 1.1 - 1.5 m³ për grumbullimin e veçantë të qelqit	100% e banorëve në zonat urbane dhe 80% e banorëve në zonat rurale 19,000 tonë mbeturina të mbledhura ndaras më 2035	2026 në zonat urbane 2030 për zonat rurale
Oborret e Riciklimit (OR)	Oborret e Riciklimit (OR)	Fraksionet e mbeturinave që do të grumbullohen: - Mbeturinat e vëllimshme - Mbeturinat e rrezikshme shtëpiake - Fraksionet e veçanta të mbeturinave	2025
Transporti dhe transferimi	Stacionet e transferit do të ngriten në Istog dhe Deçan	- Istog – kapacitet prej 9,700 tonë/vit - Deçan – kapacitet prej 6,700 tonë/vit	2026
Klasifikimi i mbeturinave	Një stacion klasifikimi për materialet e grumbulluara ndaras do të ngritet në deponinë rajonale në Sferkë	Kapaciteti i objektit ORM – 21,000 tonë/vit të lëndëve të riciklueshme të mbledhura ndaras	2026

Tabela 12: përmbledhje e sistemit të preferuar për menaxhimin e integruar të mbeturinave të ngurta

Përbërësit e sistemit	Përshkrimi	Kapaciteti	Viti/periudha
Kompostimi	Katër objekte kompostimi për mbeturinat e gjelbra të grumbulluara veçmas do të ngriten në komunat Pejë, Istog, Klinë dhe Deçan. Kompostimi në Pejë do të organizohet në lokacion të përhershëm, ndërsa në komunat tjera do të zbatohet kompostimi i decentralizuar duke përdorur pajisje mobile.	- Objekti i kompostimit në Pejë – kapacitet prej 2,400 tonë/vit - Objekti i kompostimit në Istog – kapacitet 600 tonë/vit - Objekti i kompostimit në Klinë – kapacitet 600 tonë/vit - Objekti i kompostimit në Deçan – kapacitet 550 tonë/vit	2026
	Filiimi me kompostimin shtëpiak në zonat rurale	• n/a	I përhershëm
Rikuperimi i mbeturinave	Do të ngritet 1 impiant TMB i cili do të trajtojë mbeturinat e përziera komunale nga të pesë komunat	- Kapaciteti prej 40,000 tonë/ vit - Prodhimi prej 12,000 tonë/vit KDM	2031
	1 impiant kompostimi brenda kontonjerëve të specializuar do të ngritet ²⁵ në hapësirën e impiantit TMB ose në objektin e kompostimit në Pejë	• Kapaciteti prej 3500 tonë/vit	2031
Deponimi i mbeturinave	Përmirësimi i deponisë sanitare rajonale ekzistues për të gjithë ZMM	• Kapaciteti i deponisë prej rreth 475 mijë tonë ²⁶ për një periudhë 20-vjeçare	2026 për qelinë e parë dhe infrastrukturën e përbashkët
MND	Rrjeti i pikave të hedhjes	• Pejë (që shërben edhe Deçanin dhe Junikun) me kapacitet prej 5,400 m ³ /vit	2025-2027
		• Istog - kapaciteti 2,900 m ³ /vit	2025-2027
		• Kline - kapaciteti 2,400 m ³ /vit	2025-2027
		• Decan (që shërben edhe Junikun) me kapacitet 2,400 m ³ /vit	2025-2027
	Një objekt riciklimi me një thërmues mobil	• Kapaciteti 12,800 m ³ /vit	2027
	Një objekt deponimi	• kapaciteti 19,300 m ³ /vit	2027

²⁵ Si alternativë, mund të ngrihet një impiant tretjeje anaerobe në vendin e planit të TMB-së, varësisht nga gjetjet e studimit përkatës të fizibilitetit.

²⁶ Nuk përfshihen mbeturinat industriale jo të rrezikshme




Figura 8: Veprimet e propozuara gjatë periudhës 2025-2035 (burimi: PNMIM)

Pjesa financiare e analizës tregon se **kostot e investimit** gjatë periudhës së planifikimit vlerësohen në 54.6 milionë euro, duke përfshirë zëvendësimin e aseteve. Kostoja më e ulët për **njësi për ton mbeturina** është në Pejë (115.82 euro), dhe më e larta është në Klinë (147.40 euro), me një mesatare prej 127.29 euro. Deri në vitin 2035, shkalla e riciklimit do të arrijë në 50.1%, dhe mbeturinat e deponuara do të reduktohen në 17.8%.

3.1.4. Plani i Veprimeve për zbatimin e PNMIM

Plani i Veprimeve përfshin aktivitete që do të trajtohen nga secila komunë veçmas si dhe aktivitete të tjera që lidhen me ngritjen e objekteve rajonale për menaxhimin e mbeturinave, të cilat do të kërkojnë bashkëpunimin e të gjitha komunave (shih tabelën më poshtë).

Tabela 13: Projektet kryesore që do të zbatohen në nivel rajonal dhe në komunat individuale

Niveli rajonal	Komunat individuale
Përmirësimi i deponisë rajonale sanitare ekzistuese në Sverkë, Pejë	Masat për parandalimin e mbeturinave
Objekti për klasifikim të mbeturinave të riciklueshme të mbledhura veç e veç	Të fillohet me grumbullimin veç e veç të mbeturinave të riciklueshme të thata
Ngritja e një impianti për trajtimin e mekanik-biologjik të mbeturinave të përziera komunale. Idealisht, objekti duhet të ndërtohet në vendin e deponisë aktuale, ndërsa një studim fizibiliteti do të përcaktojë lokacionin e saktë.	Ngritja e oborreve të riciklimit (lokacionet janë identifikuar)
Ngritja e një objekti riciklimi për mbeturinat e ndërtimit dhe demolimit	Stacionet e transferimit të mbeturinaveve (për komunën e Istogut vendndodhja ende nuk është përcaktuar, ndërsa për Deçanin ekziston një studim)
Ngritja e një impianti për trajtimin e mbeturinave organike - Studimi i fizibilitetit do të përcaktojë se cili lloj objekti për trajtimin e mbeturinave do të jetë më i përshtatshëm; studimi i fizibilitetit është planifikuar për vitin 2028, ndërsa objekti për trajtimin e mbeturinave organike për vitin 2031.	Krijimi i një objekti kompostimi për mbeturinat e gjelbra të grumbulluara veç e veç (në komunën e Pejës- lokacioni I padefinuar, fillimisht të bëhet studimi i fizibilitetit) dhe zbatimi i kompostimit të decentralizuar të mbeturinave të gjelbra duke përdorur pajisje mobile në komunat Istog, Klinë, Deçan dhe Junik
Ngritja e një objekti riciklimi për mbeturinat e ndërtimit dhe demolimit	Të fillohet me kompostimin shtëpiak në zonat rurale

Tabela 13: Projektet kryesore që do të zbatohen në nivel rajonal dhe në komunat individuale

Niveli rajonal	Komunat individuale
	Krijimi i katër pikave të hedhjes së mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi (në komunat Pejë, Istog, Klinë dhe Deçan)

Dokumenti përshkruan masat kyçe për të gjitha fraksionet prioritare të mbeturinave sipas PNMIM-së, me aktivitete që duhet të kenë përparësi në periudhën afatshkurtër 2025–2027 dhe ato për periudhën afatgjatë 2028–2035. Ai përfshin veprime të detajuara, buxhete, burime financimi, palët përgjegjëse, afatet kohore dhe indikatorët e performancës për të mbështetur monitorimin dhe zbatimin efektiv.

3.2. Vlerësimi i skenarëve alternativë

Skenarët për zhvillimin e një sistemi për menaxhimin e integruar të mbeturinave janë formuluar si një kombinim i alternativave të ndryshme për operacionet individuale të menaxhimit të mbeturinave dhe janë analizuar përmes pesë opsioneve të paraqitura në tabelën më poshtë.

Tabela 14: Skenarët për zhvillimin e sistemit për menaxhimin e integruar të mbeturinave

Elementet e Sistemit	Opsioni 1	Opsioni 1a	Opsioni 2	Opsioni 3	Opsioni 4	Opsioni 5
Grumbullimi i mbeturinave të përziera ²⁷	Sistemi aktual i grumbullimit i bazuar në kontejnerë 1.1 m ³ dhe shporta individuale 240 l	Sistemi aktual i grumbullimit i bazuar në kontejnerë 1.1 m ³ dhe shporta individuale 240 l	Sistemi aktual i grumbullimit i bazuar në kontejnerë 1.1 m ³ dhe shporta individuale 240 l	Sistemi aktual i grumbullimit i bazuar në kontejnerë 1.1 m ³ dhe shporta individuale 240 l	Sistemi aktual i grumbullimit i bazuar në kontejnerë 1.1 m ³ dhe shporta individuale 240 l	Sistemi aktual i grumbullimit i bazuar në kontejnerë 1.1 m ³ dhe shporta individuale 240 l
Mbledhja ndaras e mbeturinave	Shporta individuale plastike 240 l për ambalazhim të përzier dhe kontejnerë Igloo 1.5 m ³ për qelq	Sistemi për sjelljen e mbeturinave me kontejnerë të llojit Igloo me ngjyra 3x1.5 m ³	Shporta individuale plastike 240 l për ambalazhim të përzier dhe kontejnerë Igloo 1.5 m ³ për qelq	Shporta individuale plastike 240 l për ambalazhim të përzier dhe kontejnerë Igloo 1.5 m ³ për qelq	Shporta individuale plastike 240 l për ambalazhim të përzier dhe kontejnerë Igloo 1.5 m ³ për qelq	Shporta individuale plastike 240 l për ambalazhim të përzier dhe kontejnerë Igloo 1.5 m ³ për qelq
Transferimi dhe transporti	ST pa ngjeshje në Istog , transport direkt për komunat tjera	ST pa ngjeshje në Istog , Klinë dhe Deçan (që shërben edhe Junikun)	Transport direkt, pa stacione transfer	ST pa ngjeshje në Istog , Klinë dhe Deçan (që shërben edhe Junikun)	Transport direkt, pa stacione transfer	ST me ngjeshje në Istog dhe Deçan. Transport direkt për Klinë
Klasifikimi i mbeturinave	Objekt i centralizuar për klasifikim në Pejë	Objekt i centralizuar për klasifikim në Pejë	Objekt i centralizuar për klasifikim në Pejë	Objekt i centralizuar për klasifikim në Pejë	Instalime individuale të klasifikimit me kapacitet të vogël në Pejë, Istog , Klinë dhe Deçan	Objekt i centralizuar për klasifikim në Pejë
Kompostimi i mbeturinave të gjelbra	Lokacion për kompostim në Pejë, pajisje mobile kompostimi për Istog , Klinë, Deçan dhe Junik	Lokacion për kompostim në Pejë, pajisje mobile kompostimi për Istog , Klinë, Deçan dhe Junik	Lokacion për kompostim në Pejë, pajisje mobile kompostimi për Istog , Klinë, Deçan dhe Junik	Lokacion për kompostim në Pejë, pajisje mobile kompostimi për Istog , Klinë, Deçan dhe Junik	Lokacion për kompostim në Pejë, pajisje mobile kompostimi për Istog , Klinë, Deçan dhe Junik	Lokacion për kompostim në Pejë, pajisje mobile kompostimi për Istog , Klinë, Deçan dhe Junik
Kompostimi shtëpiak	Të gjitha zonat rurale	Të gjitha zonat rurale	Të gjitha zonat rurale	Të gjitha zonat rurale	Të gjitha zonat rurale	Të gjitha zonat rurale
Mbeturinat	Objekti për	Objekti për	Objekti për djegje	Impianti i	Objekti për	Objekti për djegje

²⁷Distanca të ndryshme transporti në varësi të disponueshmërisë së stacionit të transferit në komunat përkatëse

Tabela 14: Skenarët për zhvillimin e sistemit për menaxhimin e integruar të mbeturinave

Elementet e Sistemit	Opsioni 1	Opsioni 1a	Opsioni 2	Opsioni 3	Opsioni 4	Opsioni 5
organike	djegje anaerobe në Pejë	djegje anaerobe në Pejë	anaerobe në Pejë	kompostimit brenda kontejnerëve të specializuar në Pejë	djegje anaerobe në Pejë	anaerobe në Pejë
TMB	Impianti i centralizuar TMB	Impianti i centralizuar TMB	Impianti i centralizuar TMB	Impianti i centralizuar TMB	Impianti i centralizuar TMB	Impianti i centralizuar TMB
Deponitë	Deponia rajonale	Deponia rajonale	Deponia rajonale	Deponia rajonale	Deponia rajonale	Deponia rajonale

Është bërë një krahasim i kostove të skenarëve, duke vënë në dukje se të gjithë skenarët kanë kosto të krahasueshme për ton dhe janë të zbatueshëm, megjithatë rekomandohet Skenari 3 për zhvillim të mëtejshëm. Ky opsion propozon një qasje të integruar për menaxhimin e mbeturinave, me fokus në riciklim, kompostim dhe zvogëlimin e ndikimit mjedisor të mbeturinave. Sistemi kombinon përdorimin e kontejnerëve individualë dhe atyre më të mëdhenj, si dhe objekte të centralizuara për ndarje dhe kompostim. Mbeturinat në disa zona (Istog, Klinë dhe Deçan, i cili shërben edhe për Junikun) transportohen pa kompresim, gjë që mund të ndikojë në efikasitetin e transportit. Kompostimi realizohet në mënyrë të centralizuar në Pejë, si dhe përmes njësive mobile që shërbejnë zonat rurale, me një objekt të mbyllur (in-vessel) për procese të kontrolluara në Pejë. Kompostimi në kushte shtëpiake gjithashtu inkurajohet në të gjitha zonat rurale. Sistemi përfshin trajtim mekanik dhe biologjik të mbeturinave, me një Impiant të centralizuar TMB (Trajtim Mekanik-Biologjik), i cili trajton mbeturinat e përziera, ndan materialet e riciklueshme dhe ato të kompostueshme, si dhe përpunon mbeturinat e mbetura. Deponia rajonale shërben si lokacion përfundimtar për depozitim të mbeturinave nga rajoni të cilat nuk mund të riciklohen apo kompostohen.

IV. VLERËSIMI I EFEKTEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS SI RRJEDHOJË E ZBATIMIT TË AKTIVITETEVE TË PNMIM DHE MASAT LEHTËSUESE

4.1. Metodologjia e vlerësimit

Në realizimin e vlerësimit të draftit të PNMIM-it për Zonën e Menaxhimit të Mbeturinave 3 - Pejë (përfshihen Peja, Istogu, Klina, Deçani dhe Juniku) në raport me objektivat e VSM-së, është marrë parasysh:

- Informacioni bazë, përfshirë problemet ekzistuese mjedisore dhe rritja e tyre në Zonën e Menaxhimit të Mbeturinave 3 - Pejë (përfshihen Peja, Istogu, Klina, Deçani dhe Juniku);
- Aktivitetet e mundshme dhe burimet e potenciale të efekteve që lidhen me ndërtimin dhe funksionimin e infrastrukturës për menaxhimin e mbeturinave dhe burimeve, siç është përshkruar në planin e veprimit të PNMIM-it;
- Kuadri ligjor i Kosovës, veçanërisht Ligji Nr. 03/L-230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor dhe shtojcat e tij (Shtojca 1: Kriteret për përcaktimin e rëndësisë së efekteve të mundshme në mjedis dhe Shtojca 2: Informacioni që duhet të sigurohet në raportet e VSM-së).

Efektet janë përshkruar (kur është e mundur) në terma të shkallës së tyre gjeografike, periudhës kohore gjatë së cilës mund të ndodhin, nëse efektet do të jenë të përkohshme apo të përhershme, pozitive apo negative, të mundshme apo të pamundura, të shpeshta apo të rralla.

4.2. Vlerësimi i përputhshmërisë së prioriteteve të PNMIM-së dhe efekteve të tyre me objektivat e VSM-së

4.2.1. Parandalimi i mbeturinave

Parandalimi i mbeturinave është përparësi e madhe e PNMIM-së dhe mbështet fuqimisht arritjen e objektivave të VSM-së. Me zvogëlimin sasisë së mbeturinave të gjeneruara në burim, parandalimi i mbeturinave kontribuon drejtpërdrejt në minimizimin e presioneve mjedisore në disa fusha. Ai ndihmon në mbrojtjen e biodiversitetit (O1) duke kufizuar dëmtimin e habitateve dhe ndotjen, mbështet ekonominë lokale (O2) përmes përdorimit efikas të burimeve dhe ul rreziqet për shëndetin që lidhen me asgjësimin e mbeturinave (O3). Parandalimi i mbeturinave poshtu lehtëson presionin mbi tokën (O5) dhe burimet ujore (O6, O7), si dhe kontribuon në uljen e emetimeve në ajër dhe ndikimeve nga ndryshimet klimatike (O8, O10). Ai gjithashtu përputhet me objektivin për promovimin e një ekonomie qarkore dhe menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve (O14). Përmes veprimeve si kompostimi në shtëpi, reduktimi i plastikës njëpërdorimshe, prokurimi publik i gjelbër dhe ulja e mbeturinave ushqimore, masat për parandalimin e mbeturinave të parashikuara në kuadër të PNMIM-së pritët të kenë një ndikim pozitiv të rëndësishëm në arritjen e këtyre objektivave të VSM-së.

Tabela 16: Vlerësimi i objektivave të VSM-së kundrejt përparësisë së PNMIM-së për parandalimin e mbeturinave

P1. PARANDALIMI I MBETURINAVE	OBJEKTIVAT E VSM-së														
	Biodiversiteti, zonat nat. të mbrojtura	Mirëqenia e popullsisë dhe ekonomia lokale	Shëndeti publik		Shfrytëzimi i tokës dhe kualiteti i dheut	Uji		Kualiteti i ajrit	Zhurma dhe vibrimi	Faktorët e ndryshimeve klimatike		Trashëgimia kulturore	Peizazhi dhe vlerat vizuale estetike	Mbeturinat	Transportimi i mbeturinave
	O1	O2	O3	O4	O5	O6	O7	O8	O9	O10	O11	O12	O13	O14	O15
Prioritetet afatshkurta 2025-2027															
D1. Zhvillimi dhe zbatim i programeve të kompostimit shtëpiak /shpërndarja e kompostuesve shtëpiak tek amvisëritë	++	++	+	0	+	+	+	++	0	+	0	0	0	++	++
D2. Aktivitete ndërgjegjëse lidhur me zhvillimin dhe zbatimin e programeve të kompostimit shtëpiak	+	++	+	+	+	+	+	0	0	0	0	0	0	++	++
D3. Miratimi i udhëzuesve për prokurimin publik të gjelbër	+	++	+	0	+	+	+	+	0	+	0	0	0	++	+
D4. Mbështetja e bizneseve lokale në zbatimin e masave për parandalimin e mbeturinave ushqimore	++	++	0	0	+	+	+	++	0	+	0	0	0	++	++
D5. Pjesëmarrja në nismat kombëtare për reduktimin e plastikës një-përdorimesh	++	++	0	0	+	+	+	+	0	+	0	0	0	++	++
Prioritetet afatmesme dhe afatgjata 2028-2035															
D1. Zhvillimi dhe zbatim i programeve të kompostimit shtëpiak	++	++	+	0	+	+	+	++	0	+	0	0	0	++	++
D2. Futja e "kriterëve të gjelbra" në procedurat e prokurimit publik (blerja e mallrave dhe e punëve nga autoritetet publike)	+	++	+	0	+	+	+	+	0	+	0	0	0	++	+

D3. Mbështetja e bizneseve lokale në zbatimin e masave për parandalimin e mbeturinave ushqimore	++	++	0	0	+	+	+	++	0	+	0	0	0	++	++
D4. Pjesëmarrja në nismat kombëtare për reduktimin e plastikës një-përdorimesh	++	++	0	0	+	+	+	+	0	+	0	0	0	++	++
Sub-totali P1	++	++	+	0	+	+	+	++	0	+	0	0	0	++	++

Vlerësimi i përputhshmërisë midis veprimeve për parandalimin e mbeturinave dhe objektivave të VSM-së tregon një korrelacion pozitiv. Masat e propozuara në kuadër të parandalimit të mbeturinave, si promovimi i kompostimit në shtëpi (D1), mbështetja për parandalimin e mbeturinave ushqimore (D4) dhe pjesëmarrja në nisma për reduktimin e plastikës njëpërdorimesh (D5), kontribuojnë në mënyrë domethënëse (++) në disa objektiva të VSM-së, veçanërisht ato që lidhen me mbrojtjen e biodiversitetit (O1), promovimin e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore (O2, O14), reduktimin e ndotjes mjedisore (O5, O6, O7, O8), si dhe përmirësimin e shëndetit publik dhe cilësisë së jetës (O3).

Gjatë vlerësimit nuk u identifikuan ndikime negative (–) apo ndikime negative të konsiderueshme (– –). Përkundrazi, parandalimi i mbeturinave njihet si një faktor kyç për qëndrueshmërinë brenda PNMIM-së dhe një shtyllë qendrore për uljen e barrës mjedisore në të ardhmen.

4.2.2. Deponimi i mbeturinave

Aktivitetet e deponimit të mbeturinave, përfshirë përmirësimin e planifikuar të deponisë rajonale dhe mbylljen e deponive ilegale, janë të lidhura ngusht me objektivat e VSM-së. Deponimi i duhur i mbeturinave redukton rreziqet e ndotjes për tokën, ujin dhe ajrin dhe në uljen e emetimeve në ajër dhe ndikimeve nga ndryshimet klimatike (O5, O6, O7, O8, O10, O11), minimizon ndikimet mbi biodiversitetin dhe peizazhet natyrore (O1, O4), si dhe mbron shëndetin e njeriut (O3). Duke kaluar nga deponimi i pakontrolluar drejt praktikave të deponive më të rregulluara dhe më të sigurta nga prizimi i mbrojtjes së mjedisit, PNMIM adreson sfida të rëndësishme mjedisore dhe siguron përputhshmëri me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm. Për më tepër, këto masa kontribuojnë në mbrojtjen e vlerave të pasurive materiale (O12) dhe janë thelbësore për përmirësimin e cilësisë së jetës në Zonën e Menaxhimit të Mbeturinave 3 - Pejë (përfshihen Peja, Istogu, Klina, Deçani dhe Juniku).

Tabela 17: Vlerësimi i objektivave të VSM-së kundrejt përparësisë së PNMIM-së për deponimin e mbeturinave

P2. DEPONIMI I MBETURINAVE	OBJEKTIVAT E VSM-së														
	Biodiversiteti, zonat nat. të mbrojtura	Mirëqenia e popullsisë dhe ekonomia lokale	Shëndeti publik		Shfrytëzimi i tokës dhe kualiteti i dheut	Uji		Kualiteti i ajrit	Zhurma dhe vibrimi	Faktorët e ndryshimeve klimatike		Trashëgimia kulturore	Peizazhi dhe vlerat vizuale estetike	Mbeturinat	Transportimi i mbeturinave
	O1	O2	O3	O4	O5	O6	O7	O8	O9	O10	O11	O12	O13	O14	O15
Prioritetet afatshkurta 2025-2027															
D1. Përfundimi i projektit të detajuar për përmirësimin e deponisë së Sferkës	+	+	+	0	++	++	+	+	0	+	0	+	+	-	-
T2. Punimet e ndërtimit për Dërmirësimin e deponisë së Sverkës	-	+	+	-	-	-	-	+	-	-	0	0	0	-	-
Prioritetet afatmesme dhe afatgjata 2028-2035															

D1. Deponia rajonale funksionon sipas kërkesave për leje dhe standardeve të fundit mjedisore	+	+	++	0	++	++	++	+	+	0	++	++	+	+	+
D2. Nuk krijohen deponi ilegale në territorin e komunave	++	+	++	+	++	++	++	+	+	0	++	++	+	+	+
Sub-totali P2	+/-	+	+	+	+	+	+/-	+	+/-	+/-	0	+	+	+/-	+/-

Veprimet kyçe si përmirësimi i deponisë sanitare rajonale dhe mbyllja sistematike me rehabilitim e deponive ilegale, kontribuojnë në mënyrë domethënëse (++) në arritjen e objektivave për mbrojtjen e të tokës, ujit dhe ajrit (O5, O6, O7, O8), forcimin e ruajtjes së biodiversitetit (O1), si dhe përmirësimin e shëndetit të njeriut dhe kushteve të jetesës (O3). Megjithatë, deponia nuk konsiderohet pjesë e koncepteve të ekonomisë qarkore (O14) dhe gjithashtu nuk ndihmon në minimizimin e trafikut të lidhur me aktivitetet e menaxhimit të mbeturinave (O15), anipse një deponi e re, e projektuar sipas standardeve dhe praktikave më të mira, duhet të marrë parasysh mbrojtjen e burimeve ujore, kontrollin e gazrave dhe emetimeve, si dhe vendndodhjen për të shmangur transportin e tepërt.

Funksionimi i deponisë rajonale sipas standardeve përmirëson shëndetin publik (O3), mbron tokën dhe ujin (O5, O6), mbështet infrastrukturën (O14, O15) dhe siguron përputhshmëri me kërkesat mjedisore (O7). Ka gjithashtu efekte pozitive të lehta në biodiversitet dhe peizazh (O1, O4), megjithëse këto nuk janë objektivat kryesore. Eliminimi i deponive ilegale ka efekte shumë të forta pozitive (++): përmirëson drejtpërdrejt cilësinë mjedisore (O5, O6, O7), mbron biodiversitetin (O1), redukton rreziqet për shëndetin publik (O3), mbështet peizazhin (O4) dhe rregullimin e infrastrukturës së mbeturinave dhe transportimit të tyre (O15).

Ndërkohë që funksionimi i deponisë mbart natyrshëm disa ndikime të mbetura mjedisore, zbatimi i standardeve moderne të menaxhimit dhe monitorimi i rregullt do të sigurojnë që këto ndikime të minimizohen dhe të jenë plotësisht në përputhje me objektivat për mbrojtjen e mjedisit.

Nuk u identifikuan konflikte madhore me objektivat e VSM-së. Investimet në përmirësimin e deponisë dhe veprimet për eliminimin e deponive ilegale, të planifikuara dhe menaxhuara sipas praktikave më të mira, shërbejnë si një shtyllë themelore për arritjen e objektivave më të gjera mjedisore dhe sociale të PNMIM-së.

4.2.3. Transporti dhe transferimi i mbeturinave

Organizimi efikas i transportit dhe operacioneve të transferimit të mbeturinave kontribuon në arritjen e disa objektivave të VSM-së. Duke optimizuar rrugët e grumbullimit të mbeturinave, duke krijuar stacione transferimi dhe duke reduktuar transportin në distanca të gjata, PNMIM mbështet uljen e emetimeve në ajër (O8) dhe kufizon ndikimin mjedisor të lidhur me logjistikën e mbeturinave (O7, O5). Sistemet e duhura të transportit dhe transferimit gjithashtu minimizojnë rrezikun e derdhjeve aksidentale të mbeturinave, mbrojnë tokën (O5) dhe burimet ujore (O6) si dhe kontribuojnë në mjediset më të sigurta dhe më të pastra të banimit. Për këtë arsye, përmirësimi i infrastrukturës së transportit dhe transferimit është thelbësor për të siguruar një sistem menaxhimi të mbeturinave që është i qëndrueshëm nga aspekti mjedisor dhe ekonomik.

Tabela 18: Vlerësimi i objektivave të VSM-së kundrejt përparësisë së PNMIM-së për transportin dhe transferimin e mbeturinave

P3. TRANSPORTI DHE TRANSFERIMI I MBETURINAVE	OBJEKTIVAT E VSM-së															
	Biodiversiteti, zonat nat. të	Mirëqenia e popullsisë dhe	Shëndeti publik		Shfrytëzimi i tokës dhe kualiteti i	Uji		Kualiteti i ajrit	Zhurma dhe vibrimi	Faktorët e ndryshimeve klimatike		Trashëgimia kulturore	Peizazhi dhe vlerat vizuale estetike	Mbeturinat		Transportimi i mbeturinave

	O1	O2	O3	O4	O5	O6	O7	O8	O9	O10	O11	O12	O13	O14	O15
Prioritetet afatshkurta 2025-2027															
D1. Identifikimi i lokacionit dhe dizajni i detajuar për stacionin e transferit për Komunën e Istogut	+	+	+	0	++	++	+	+	0	+	0	+	+	+	+
D2. Punimet e ndërtimit të stacionit të transferit për Komunën e Istogut	-	+	+	-	-	0	0	+	-	0	0	0	0	+	+
D3. Hartimi i studimit të fizibilitetit dhe dokumentacionit të projektimit për ngritjen e stacionit të transferit për Komunën e Deçanit (që shërben edhe për komunën e Junikut)	+	+	+	0	++	++	+	+	0	+	0	+	+	+	+
D4. Punimet për ndërtimin e stacionit të transferit për Komunën e Deçanit	-	+	+	-	-	0	0	+	-	0	0	0	0	+	+
Prioritetet afatmesme dhe afatgjata 2028-2035															
D1. Stacionet e Transferit në Istog dhe Deçan funksionojnë sipas kërkesave për leje	+	+	+	0	+	+	++	+	+	0	+	+	+	++	++
Sub-totali P3	+/-	+	+	+/-	+	+	+/-	+	-	+/-	0	+	+	+	+

Analiza tregon se masat e planifikuara për transportin dhe transferimin e mbeturinave janë në masë të madhe të përputhshme dhe mbështetëse ndaj objektivave të VSM-së.

Krijimi i stacioneve të transferit në Istog dhe Deçan, së bashku me organizimin më të mirë të sistemeve të transportit të mbeturinave, sjell ndikime pozitive (++) veçanërisht në objektivat që lidhen me reduktimin e ndotjes së ajrit dhe emetimeve të gazeve serrë (O8), mbrojtjen e tokës dhe burimeve ujore (O5, O6, O7), promovimin e efikasitetit të energjisë (O14), si dhe përmirësimin e shëndetit publik dhe sigurisë (O3). Stacionet e transferit reduktojnë rreziqet mjedisore duke parandaluar hedhjet e paligjshme, përmirësuar efikasitetin e trajtimit dhe minimizuar ndotjen. Vlerësimi tregon ndikim shumë pozitiv (++) për O14 dhe O15, pasi stacionet e transferit përbëjnë infrastrukturë të rëndësishme për logjistikën rajonale të mbeturinave. Nuk u identifikuan efekte negative të rëndësishme. Stacionet e transferimit, megjithëse të dobishme, mund të shkaktojnë probleme lokale mjedisore si aromë, pluhur, zhurmë dhe rritje të trafikut, sidomos kur ndodhen pranë zonave të banuara ose të ndjeshme. Për të minimizuar këto ndikime, nevojitet një përzgjedhje e kujdesshme e vendndodhjes përmes VNM-së, si dhe dizajnim dhe menaxhim i mirë operacional. Rasti i Deçanit ilustron rëndësinë e shmangies së afërsisë me zonën e veçantë të mbrojtur të Manastirit të Deçanit. Në përgjithësi, përmirësimi i sistemeve të transportit dhe transferimit të mbeturinave në kuadër të PNMIM-së përbën një hap kyç drejt një sistemi më të qëndrueshëm, efikas dhe mjedisor të menaxhimit të mbeturinave në Zonën e Menaxhimit të Mbeturinave 3 - Pejë (përfshihen Peja, Istogu, Klina, Deçani dhe Juniku).

4.2.4. Krijimi i sistemeve të riciklimit dhe rikuperimit të mbeturinave

Zhvillimi i sistemeve për riciklimin dhe rikuperimin e mbeturinave është një veprim themelor që mbështet fuqishëm objektivat e VSM-së. Me drejtimin e mbeturinave nga deponia, promovimin e përdorimit efikas të burimeve, iniciativat për riciklim dhe rikuperim kontribuojnë drejtpërdrejt reduktimin e ndotjes mjedisore (O5, O6, O7, O8), si dhe në promovimin e ekonomisë qarkore (O14). Për më tepër, këto aktivitete ndihmojnë në ruajtjen e biodiversitetit (O1) dhe përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies së njerëzve (O3) përmes uljes së gjurmës mjedisore të menaxhimit të mbeturinave. Ndërtimi i objektit për ndarjen e mbeturinave, kompostimin, tretjen anaerobe dhe rikuperimin e materialeve siguron që PNMIM-ja të avancojë drejt objektivave të zhvillimit të

qëndrueshëm dhe të jetë në përputhje me standardet mjedisore të Bashkimit Evropian dhe ato vendore.

Tabela 19: Vlerësimi i objektivave të VSM-së kundrejt përparësisë së PNMIM-së për krijimin e sistemeve të riciklimit dhe rikuperimit të mbeturinave

P4. KRIJIMI I SISTEMEVE TË RIKIKLIMIT DHE RIKUPERIMIT TË MBETURINAVE	OBJEKTIVAT E VSM-së														
	Biodiversiteti, zonat nat. të	Mirëqenia e popullsisë dhe	Shëndeti publik		Shfrytëzimi i tokës dhe kualiteti i	Uji		Kualiteti i ajrit	Zhurma dhe vibrimi	Faktorët e ndryshimeve klimatike		Trashëgimia kulturore	Peizazhi dhe vlerat vizuale estetike	Mbeturinat	Transportimi i mbeturinave
	O1	O2	O3	O4	O5	O6	O7	O8	O9	O10	O11	O12	O13	O14	O15
Prioritetet afatshkurta 2025-2027															
D1. Krijimi i Oborreve të Riciklimit (OR)	++	++	+	+	++	++	++	-	-	+	++	0	0	++	++
D2. Menaxhimi i mbeturinave të ambalazhit Aktivitetet kryesore përfshijnë marrëveshje komunale me OPP-të, krijimi i sistemeve për grumbullimin ndaras të materialeve të riciklueshme, themelimi i një qendre për klasifikimin e materialeve dhe zhvillimi i fushatave ndërgjegjësuere për të rritur pjesëmarrjen e publikut.	++	++	+	+	++	++	++	+	0	+	0	0	0	++	++
D3. Menaxhimi i mbeturinave të gjelbra Aktivitetet kryesore: objekti për kompostim në Pejë, duke përfshirë studimin e fizibilitetit dhe projektimin, ndërsa Istogu, Klina, Deçani pajisen me pajisje mobile për kompostim.	++	++	+	+	++	++	++	-	-	+	0	0	0	++	++
D4. Menaxhimi i MNRR Aktivitetet kryesore: Pikat e grumbullimit do të përzgjidhen dhe ndërtohen në Pejë, Istog, Klinë dhe Deçan, së bashku me furnizimin me pajisje për grumbullim dhe transport. Një qendër riciklimi dhe një objekt për deponim do të ndërtohen në Pejë, me pajisjet e nevojshme që do të sigurohen për të dyja.	++	++	+	+	++	++	++	-	-	+	0	0	0	++	++
Prioritetet afatmesme dhe afatgjata 2028-2035															
D1. Krijimi i Oborreve të Riciklimit (OR). OR funksion në përputhje me kërkesat mjedisore	++	++	+	+	++	++	++	+	0	+	++	0	0	++	++
D2. Menaxhimi i mbeturinave të ambalazhit. Aktivitetet kryesore: Sisteme të ndara për grumbullimin e mbeturinave komunale dhe ambalazhit të mbështetura, fushata ndërgjegjësuere për të rritur pjesëmarrjen e publikut.	++	++	+	+	++	++	++	+	0	+	0	0	0	++	++

D3. Menaxhimi i mbeturinave të gjelbra	Nuk parashihen aktivitete.														
D4. Menaxhimi i MNRR Zbatimi i legjislacionit dhe rregulloreve që kontrollojnë deponimin e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënim	++	++	+	+	++	++	++	+	0	+	0	0	0	++	++
D5. Ngritja e objekteve të rikuperimit të mbeturinave Aktivitetet kryesore: studim fizibiliteti paraprin projektimit dhe ndërtimit të objektit për trajtim mekaniko-biologjik dhe objektit për rikuperimin e mbeturinave ushqimore.	+	++	+	+	++	+	++	-	-	+	++	++	+	++	+
Sub-totali P4	++	++	+	+	++	++	++	-	-	+	+	+	+	++	++

Analiza tregon një nivel të lartë përputhshmërie pozitive ndërmjet krijimit të sistemeve të riciklimit dhe rikuperimit dhe objektivave të VSM-së. Investimet e planifikuara në impiante për ndarje, kompostimin e mbeturinave të gjelbra dhe organike, tretjen anaerobe dhe operacionet për rikuperimin e materialeve tregojnë efekte shumë pozitive (++) në objektivat që lidhen me mbrojtjen e tokës (O5), uljen e emetimeve të gazeve serrë (O8), promovimin e ekonomisë qarkore (O14), mbrojtjen e biodiversitetit dhe peizazhit (O1), si dhe përmirësimin e kushteve të jetesës dhe shëndetit publik (O3).

Nuk janë identifikuar ndikime negative. Rreziqe të vogla që lidhen me menaxhimin e impianteve, si erërat apo emetimet lokale, mund të trajtohen në mënyrë efektive përmes përdorimit të teknikave më të mira të disponueshme dhe monitorimit të rreptë mjedisor. Në tërësi, krijimi i sistemeve për riciklimin dhe rikuperimin e mbeturinave shihet si një faktor kyç për përmbushjen e ambicieve për qëndrueshmëri të PNMIM-së dhe mbështet realizimin e objektivave të VSM-së. Për shkak të afërsisë së tyre me zona të banuara dhe vendndodhjes në zona të rrezikuara nga përmblytjet, siç janë Oborret e riciklimit (OR) në Pejë dhe Klinë, si dhe afërsisë me zona me rrezik përmblytjeje si në rastin e OR-së në Istog dhe OR-së në Deçan pranë zonës së veçantë të mbrojtur të Manastirit, të gjitha projektet e kësaj natyre duhet t'i nënshtrohen VNM-së dhe të kenë plane përkatëse të menaxhimit të përcaktuara dhe të zbatuara.

Menaxhimi i duhur i mbeturinave ndërtimore përmes pikave të planifikuara të grumbulimit në secilën komunë, e veçanërisht ripërdorimi dhe riciklimi i tyre përmes planifikimit të qendrës për riciklim dhe objektit për grumbullim në Pejë do të ketë ndikime të rëndësishme pozitive mjedisore. Riciklimi i materialeve inerte si betoni, tulla dhe asfalti redukton nevojën për nxjerrjen dhe përpunimin e materialeve të reja, duke ruajtur kështu burimet natyrore dhe duke reduktuar degradimin mjedisor që lidhet me nxjerrjen e minierave dhe lëndëve të para. Rreziqet e vogla që lidhen me emetime të pluhurit, zhurmës, substancave të rrezikshme në këto mbeturina si azbesti, ngjyra me bazë plumbi etj. Edhe pse këto zhvillime kanë ndikime të ulëta mjedisore (sidomos pikat e grumbullimit), objekti i riciklimit dhe deponia për grumbullim duhet t'i nënshtrohen procesit të VNM-së. Gjatë planifikimit të tyre të shmanget afërsia nga zonat me dendësi të madhe të banimit, zonat ekologjikisht të ndjeshme, zonat e rrezikuara nga përmblytjet, Brenda zonave të mbrojtura kulturore apo natyrore si dhe në afërsi të burimeve ujore apo akuifereve.

Në Objektet e rikuperimit të materialeve mund të lindin ndikime të ndryshme mjedisore si aromë e pakëndshme, pluhur dhe zhurmë. Këto emetime janë të zakonshme për operacionet e menaxhimit të mbeturinave, por mund të kontrollohen në mënyrë efektive me teknologjinë moderne dhe praktikën e menaxhimit. Gjatë studimit të fizibiliteti për planifikimin e lokacionit të objektit të tillë në Pejë duhet

të mirret parasysh që zona e përzgjedhur të mos jetë në afërsi të zonave ekologjike si dhe zonave me dendësi të madhe të banimit. Gjithashtu edhe për këtë zhvillim duhet të përgatitet VNM-ja me të cilin do të identifikohen ndikimet dhe masat më specifike për të zvogëluar apo eliminuar efektet mjedisore.

4.2.5. Menaxhimi i mbeturinave bujqësore

Menaxhimi i duhur i mbeturinave bujqësore luan një rol të rëndësishëm në arritjen e objektivave të VSM-së. Hedhja e pakontrolluar e mbeturinave bujqësore mund të çojë në ndotjen e tokës, ujit dhe ajrit (O5, O6, O7, O8), dhe të ndikojë negativisht në biodiversitet (O1) dhe shëndetin publik (O3). Duke promovuar praktika të qëndrueshme si kompostimi në fermë, rikuperimi i mbeturinave organike dhe menaxhimi korrekt i mbeturinave të rrezikshme bujqësore, PNMIM synon të mbrojë burimet natyrore, të reduktojë emetimet e gazeve serrë dhe të përmirësojë cilësinë e përgjithshme të mjedisit. Menaxhimi i mbeturinave bujqësore gjithashtu është në përputhje me objektivat që mbështesin përdorimin e qëndrueshëm të tokës (O5), zhvillimin rural dhe parimet e ekonomisë qarkore (O14).

Tabela 20: Vlerësimi i objektivave të VSM-së kundrejt përparësisë së PNMIM-së për menaxhimin e mbeturinave bujqësore

P5. MENAXHIMI I MBETURINAVE BUJQËSORE	OBJEKTIVAT E VSM-së														
	Biodiversiteti, zonat nat. të	Mirëqenia e popullsisë dhe	Shëndeti publik		Shfrytëzimi i tokës dhe kualiteti i	Uji		Kualiteti i ajrit	Zhurma dhe vibrimi	Faktorët e ndryshimeve klimatike	Trashëgimia kulturore	Peizazhi dhe vlerat vizuale estetike	Mbeturinat	Transportimi i mbeturinave	
	O1	O2	O3	O4	O5	O6	O7	O8	O9	O10	O11	O12	O13	O14	O15
Prioritetet afatshkurta 2025-2027															
D1. Zhvillimi dhe shpërndarja e materialeve informative mbi menaxhimin e mbeturinave bujqësore (p.sh. udhëzime për ruajtjen e plehut organik në fermë, kompostimin e mbeturinave bujqësore, rikuperimin e energjisë nga biomasa, etj.)	++	+	++	+	++	++	++	+	0	+	0	0	+	++	+
D2. Përmirësimi i kushteve për ruajtjen dhe trajtimin e plehut organik të kafshëve	++	+	++	+	++	++	++	++	0	+	0	0	+	++	++
D3. Masat për parandalimin e djegies së mbeturinave bujqësore në mjedise të hapura, duke përfshirë djegien e fushave, në instalime që nuk janë të pajisura me sisteme të trajtimit të gazrave të rrjedhshme dhe në instalime pa rikuperim të energjisë	++	+	++	+	++	++	++	++	0	++	0	0	++	++	++
D4. Mirëmbajtja dhe përditësimi i rregullt i inventarit të magazinave të agrokimikateve të vietruara	++	+	++	+	++	++	++	++	0	+	0	0	+	++	++
Prioritetet afatmesme dhe afatgjata 2028-2035	Nuk parashihen aktivitete.														
Sub-totali P5	++	+	++	+	++	++	++	++	0	+	0	0	+	++	++

Vlerësimi i përputhshmërisë tregon se masat e propozuara për menaxhimin e mbeturinave bujqësore kanë një efekt shumë pozitiv (++/+) në arritjen e disa objektivave të VSM-së. Në veçanti, futja e praktikave të kompostimit në vend, mbështetja për rikuperimin e mbeturinave bujqësore dhe promovimi i asgjësimit mjedisor të qëndrueshëm të mbeturinave të rrezikshme nga bujqësia

kontribuojnë drejtpërdrejt në mbrojtjen e cilësisë së tokës dhe ujit (O5, O6), reduktimin e emetimeve në ajër (O8), mbrojtjen e biodiversitetit (O1) dhe përmirësimin e shëndetit publik dhe kushteve mjedisore në zonat rurale (O3).

Nuk janë identifikuar efekte negative të rëndësishme. Sfidat e vogla që lidhen me rritjen e ndërgjegjësimit të fermerët dhe zbatimin e praktikave të reja mund të adresohen përmes trajnimeve të synuara dhe masave mbështetëse të përshtatshme.

4.2.6. Menaxhimi i fraksioneve tjera të mbeturinave

Menaxhimi i duhur i fraksioneve tjera të mbeturinave, si mbeturinat e rrezikshme shtëpiake, mbeturinat nga ndërtimi dhe demolimi, si dhe fraksionet tjera si pajisjet elektrike dhe elektronike, bateritë dhe automjetet mbeturinë është thelbësor për arritjen e objektivave të VSM-së. Këto lloje mbeturinash përbëjnë rreziqe të veçanta për tokën, ujin, ajrin, biodiversitetin dhe shëndetin e njeriut nëse nuk trajtohen në mënyrë të përshtatshme (O1, O3, O5, O6, O7, O8). Përmes veprimeve të synuara për grumbullimin e veçantë, trajtimin, riciklimin dhe deponimin e sigurt, PNMIM-ja mbështet drejtpërdrejt parandalimin e ndotjes, mbrojtjen e burimeve natyrore, krijimin e mjediseve më të sigurta për banim dhe promovon praktikën e ekonomisë qarkore (O14). Menaxhimi efektiv i këtyre është kritik për të minimizuar rreziqet mjedisore dhe për të siguruar përputhshmëri me legjislacionin e BE-së për mbeturinat.

Tabela 21: Vlerësimi i objektivave të VSM-së kundrejt përparësisë së PNMIM-së për menaxhimin e fraksioneve tjera të mbeturinave

P6. MENAXHIMI I FRAKSIONEVE TJERA TË MBETURINAVE	OBJEKTIVAT E VSM-së														
	Biodiversiteti, zonat nat. të	Mirëqenia e popullsisë dhe ekonomia lokale	Shëndeti publik		Shfrytëzimi i tokës dhe kualiteti i dheut	Uji		Kualiteti i ajrit	Zhurma dhe vibrimi	Faktorët e ndryshimeve klimatike		Trashëgimia kulturore	Peizazhi dhe vlerat vizuale estetike	Mbeturinat	Transportimi i mbeturinave
	O1	O2	O3	O4	O5	O6	O7	O8	O9	O10	O11	O12	O13	O14	O15
Prioritetet afatshkurta 2025-2027															
D1. Menaxhimi i MPEEE Aktivitetet kryesore: Nënshkrimi i marrëveshjes me OPP-të për MPEE pasuar nga zhvillimi dhe zbatimi i sistemit të grumbullimit ndaras të MPEE, Zbatimi i fushatave të ndërgjegjësimit të publikut të përcaktuara për modelet e reja të konsumit të qëndrueshëm dhe pjesëmarrja në skemat e grumbullimit ndaras	++	++	+	+	++	++	++	+	0	+	0	0	0	++	++
D2. Menaxhimi i baterive dhe akumulatorëve. Aktivitetet kryesore: Marrëveshje me OPP-të për bateritë e përdorura, do të krijohet një inventar i shitoreve që shesin bateri dhe do të zhvillohet e zbatohet një sistem i veçantë për grumbullimin e baterive të përdorura.	++	++	+	+	++	++	++	+	0	+	0	0	0	++	++

D3. Menaxhimi i automjeteve mbeturinë (AM). Aktivitetet kryesore: marrëveshje me OPP-të për Mjetet në Fund të Jetës (MFJ), caktimi i vendeve për ruajtje të përkohshme dhe çmontim, zhvillim dhe zbatim i kërkesave për heqjen dhe grumbullimin e MFJ-ve të braktisura në rrugë publike dhe zona parkimi.	++	++	+	+	++	++	++	-	-	+	0	0	0	++	++
D4. Menaxhimi i gomave të shpenzuara. Aktivitetet kryesore: Nënshkrimi i marrëveshjeve me OPP-të për AM-të, Përcaktimi i vendeve për magazinimin e përkohshëm (dhe çmontimin) e AM-ve, Zhvillimi dhe zbatimi i kërkesave për largimin dhe grumbullimin e AM-ve të braktisura në rrugë publike dhe zona parkimi	++	++	+	+	++	++	++	+	0	+	0	0	0	++	++
D5. Menaxhimi i vajrave të përdorura. Aktivitetet kryesore: Nënshkrimi i marrëveshjeve me OPP-të për vajrat e përdorura, Inventarizimi i dyqaneve të riparimit të makinave dhe vendeve për zëvendësimin e vajrave motorikë, Ndalimi i zëvendësimit të vajrave të përdorura motorike në zona publike dhe vende të papajisura për këtë qëllim	++	++	+	+	++	++	++	+	0	+	0	0	0	++	++
Prioritetet afatmesme dhe afatgjata 2028-2035	Nuk parashihen aktivitete.														
Sub-total P6	++	++	+	+	++	++	++	+	0	+	0	0	0	++	++

Analiza konfirmon se masat e propozuara për menaxhimin e fraksioneve tjera të mbeturinave kanë përputhshmëri shumë pozitive (++) me objektivat e VSM-së. Përmes krijimit të sistemeve të grumbullimit të veçantë, impianteve të përshtatshme për trajtim dhe promovimit të mekanizmave të përgjegjësive së zgjeruar të prodhuesit (PZP) për mbeturinat e rrezikshme dhe të veçanta, PNMIM-ja ndikon pozitivisht në objektivat që lidhen me mbrojtjen e shëndetit të njeriut (O3), ruajtjen e tokës dhe ujit (O5, O6), përmirësimin e cilësisë së ajrit (O8), mbrojtjen e biodiversitetit (O1) dhe ekonominë qarkore (O14).

Megjithëse ekzistojnë rreziqe të vogla në rast të keqmenaxhimit (p.sh., nëse mbeturinat e rrezikshme trajtohen apo ruhen në mënyrë të pasigurt), këto rreziqe janë të parandalueshme përmes zbatimit të standardeve të rrepta operationale, monitorimit të vazhdueshëm dhe fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit. Gjatë planifikimit të lokacioneve për magazinimin e përkohshëm dhe çmontimin e mbeturinave të gomës dhe automjeteve jashtë përdorimit, është thelbësore të shmangen zonat e banuara, zonat ekologjikisht të ndjeshme, ato të rrezikuara nga përmytjet, afërsia me burime ujore dhe akuifere, zonat me rrezik të lartë nga zjarret si dhe zonat e mbrojtura kulturore ose arkeologjike. Këto mbeturina përmbajnë substanca të rrezikshme si vajra, lëngje industriale dhe metale të rënda, të cilat mund të ndotin mjedisin dhe të paraqesin rrezik për shëndetin publik. Prandaj, për çdo lokacion të tillë duhet të bëhet VNM dhe të hartohen plane të qarta menaxhimi për kontrollin e ndotjes, trajtimin e mbeturinave dhe monitorimin e vazhdueshëm të aktiviteteve.

4.2.7. Fuqizimi i strukturës institucionale

Fuqizimi i strukturës institucionale për menaxhimin e mbeturinave është thelbësor për zbatimin e suksesshëm të PNMIM-së dhe për arritjen e objektivave të VSM-së. Një strukturë institucionale e mirë-koordinuar siguron zbatimin e standardeve mjedisore, ofrimin efikas të shërbimeve, monitorim efektiv dhe reagim të shpejtë ndaj çështjeve të reja mjedisore. Institucionet e forta mbështesin objektivat që lidhen me mbrojtjen e shëndetit të njeriut (O3), mbrojtjen e cilësisë së tokës, ujit dhe ajrit (O5, O6, O7, O8), si dhe promovimin e qeverisjes së mirë dhe zhvillimit të qëndrueshëm (O14). Forcimi i bashkëpunimit ndërkomunal dhe ndërtimi i kapaciteteve teknike dhe administrative është thelbësor për të siguruar përfitimet afatgjata mjedisore dhe socio-ekonomike që synon PNMIM.

Tabela 22: Vlerësimi i objektivave të VSM-së kundrejt përparësisë së PNMIM-së për fuqizimin e strukturës institucionale

P7. FUQIZIMI I STRUKTURËS INSTITUCIONALE	OBJEKTIVAT E VSM-së														
	Biodiversiteti, zonat nat. të	Mirëqenia e popullsisë dhe	Shëndeti publik		Shfrytëzimi i tokës dhe kualiteti i	Uji		Kualiteti i ajrit	Zhurma dhe vibrimi	Faktorët e ndryshimeve klimatike		Trashëgimia kulturore	Peizazhi dhe vlerat vizuale estetike	Mbeturinat	Transportimi i mbeturinave
	O1	O2	O3	O4	O5	O6	O7	O8	O9	O10	O11	O12	O13	O14	O15
Prioritetet afatshkurta 2025-2027															
D1. Përgatitja dhe nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit ndërkomunal (MBNK)	+	+	+	0	+	+	+	+	+	0	++	++	++	++	++
D2. Emërimi i koordinatorit të BNK-së	+	+	+	0	+	+	+	+	+	0	++	++	++	++	++
D3. Takime dy-vjeçare për zbatimin e marrëveshjes së PNMIMB-së dhe marrëveshjes për BNK	+	+	+	0	+	+	+	+	+	0	++	++	++	++	++
D4. Zhvillimi i një modeli për kontratën e shërbimit publik (KShP) që do të përdoret për ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave	+	+	+	0	+	+	+	+	+	0	++	++	++	++	++
D5. Hartimi dhe miratimi i planit të biznesit për KRM ‘Ambienti’	+	+	+	0	+	+	+	+	+	+	++	++	+	++	++
D6. Miratimi i raporteve vjetore dhe planeve vjetore për operimin e KRM ‘Ambienti’	+	+	+	0	+	+	+	+	+	+	++	++	+	++	++
Prioritetet afatmesme dhe afatgjata 2028-2035	Nuk parashihen aktivitete.														
Sub-total P7	+	+	+	0	+	+	+	+	+	+	+	++	++	++	++

Analiza tregon se masat që synojnë fuqizimin e strukturës institucionale kanë përputhshmëri pozitive të fortë (++) me objektivat e VSM-së. Përmes përmirësimit të strukturave të qeverisjes, qartësimit të roleve dhe përgjegjësisë midis aktorëve, rritjes së kapaciteteve operacionale dhe promovimit të koordinimit më të mirë në nivelet rajonale dhe lokale, PNMIM-ja ofron mbrojtje më efektive të mjedisit (O1, O3, O5, O6, O7, O8, O11) dhe mbështet objektivin më të gjerë të kalimit drejt një ekonomie të qëndrueshme dhe qarkore (O14). Nuk janë identifikuar efekte negative. Megjithatë, suksesi i këtyre masave do të varet nga vullneti politik i vazhdueshëm, investimi i qëndrueshëm në ndërtimin e kapaciteteve institucionale dhe përfshirja efektive e aktorëve të interesuar.

4.3. Gjetjet kryesore mbi efektet e pritshme nga zbatimi i PNMIM-së

Vlerësimi i veprimeve të PNMIM tregon se efektet mjedisore në përgjithësi janë kryesisht pozitive, duke kontribuar në arritjen e objektivave strategjike mjedisore. Shumica e veprimeve të propozuara, si parandalimi i mbeturinave, përmirësimi i mbulimit të mbledhjes së mbeturinave, ngritja e sistemeve të riciklimit dhe rikuperimit, krijimi i impiantit për kompostim dhe rikuperim materialesh, si dhe forcimi i kuadrit institucional, pritet të përmirësojnë cilësinë mjedisore, të reduktojnë ndotjen dhe të mbështesin kalimin drejt një ekonomie qarkore.

Megjithatë, kapitulli i mëparshëm tregoi se disa nga prioritetet kryesore të PNMIM mund të kenë konflikt të vogël me disa nga objektivat e VSM-së. Ky kapitull evidenton veprimet që ka gjasa të kenë ndikime të rëndësishme mjedisore dhe propozon masa përkatëse lehtësuese për të minimizuar efektet negative.

Përfundimet kryesore të përmbledhura si më poshtë:

- **Efektet Pozitive:**
 - Zvogëlim i ndjeshëm i sasisë së mbeturinave të depozituara në deponinë rajonale dhe në deponitë ilegale, duke çuar në përmirësim të cilësisë së tokës, ujit dhe ajrit.
 - Mbrojtje e biodiversitetit dhe e peizazheve natyrore nëpërmjet zvogëlimit të deponimit të pakontrolluar të mbeturinave dhe menaxhimit më të mirë të vendeve të trajtimit.
 - Ulja e ndotjes së mjedisit përmes rritjes së riciklimit, kompostimit dhe përmirësimit të logistikës së transportit.
 - Përmirësim i shëndetit publik përmes trajtimit më të mirë të mbeturinave, uljes së ekspozimit ndaj mbeturinave të rrezikshme dhe zgjerimit të mbulimit të shërbimeve.
 - Nxitje e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve dhe mbështetje për ekonominë qarkore.
- **Efektet e mundshme negative:**
 - Ndërtimi dhe funksionimi i impianteve të reja (p.sh., stacione transferimi, objektit për klasifikimin e mbeturinave të riciklueshme, objektit për kompostim etj) mund të shkaktojë rritje të përkohshme të zhurmës, pluhurit dhe trafikut lokal sidomos gjatë fazës së ndërtimit dhe e mundshme edhe gjatë operimit.
 - Rrezik i emetimit të erërave të pakëndshme nga impiantet e kompostimit dhe trajtimit të mbeturinave organike.
 - Rreziqe të vogla të mundshme për aksidente ose për trajtim të papërshtatshëm të flukseve të mbeturinave të rrezikshme ose të veçanta.
 - Reagime sociale të mundshme që lidhen me ndryshimet në skemat e mbledhjes së mbeturinave dhe formalizimin e roleve të sektorit informal.

PNMIM-ja pritet të gjenerojë përfitime të konsiderueshme mjedisore dhe socio-ekonomike. Efektet e mundshme negative të identifikuar janë të lokalizuara, afatshkurtra dhe të menaxhueshme përmes aplikimit të masave të përshtatshme lehtësuese, kontrolleve të rrepta mjedisore dhe monitorimit të vazhdueshëm. Për këtë arsye, VSM rekomandon që masat lehtësuese dhe aktivitetet e monitorimit të integrohen në mënyrë sistematike në fazën e zbatimit të PNMIM për të siguruar që efektet pozitive të maksimizohen dhe ato negative të minimizohen.

4.4. Masat e parapara lehtësuese

Masat lehtësuese të parapara përfshijnë veprime për të:

- Shmangur ndikimet mjedisore,
- Zvogëluar madhësinë, shtrirjen, mundësinë dhe/ose seriozitetin e tyre,
- Riparuar dëmet pasi ndikimet të kenë ndodhur
- Kompensuar ndikimet duke balancuar efektet negative me rezultate pozitive.

Efektet negative të mundshme të identifikuar janë kryesisht të lokalizuara, afatshkurtra dhe të menaxhueshme. Përmes zbatimit të masave të propozuara lehtësuese, pritet që rreziqet mjedisore dhe sociale të minimizohen dhe ndikimet pozitive të PNMIM të realizohen plotësisht.

Tabela 23: Përmbledhje e efekteve të mundshme negative dhe masave për zbutjen e tyre

Efektet e mundshme negative	Masat lehtësuese
Zhurmë, pluhur dhe trafik gjatë ndërtimit të impianteve (stacione transferimi, OR, objekti për riciklim dhe kompostim) si dhe transportit të mbeturinave ndërtimore/demolimit	Zbatimi i masave të parapara me raportet e VNM-së për këto projekte, të cilat padyshim që do të përfshijnë masa për largimin dhe kontrollin e pluhurit (p.sh. spërkatje me ujë, ventilim, kapsulimin e makinerive), masa për zvogëlimin e zhurmës (p.sh. kufizimi i orarit të punës, izolimi i zërit, mirëmbajtja e rregullt e makinerisë) dhe plane për menaxhimin e trafikut. Monitoroni aktivitetet e ndërtimit për të siguruar përputhshmëri me këto masa. Rekomandohet përpilimi dhe zbatimi edhe i Planit të Menaxhimit Mjedisor (PMM) si pjesë e VNM-së për të siguruar zbatimin e masave gjatë fazës së ndërtimit dhe operimit të këtyre objekteve.
Emetime erërash të pakëndshme nga objekti i kompostimit dhe trajtimi i mbeturinave, ndikim në biodiversitet	Gjatë përpilimit të studimit të fizibilitetit për vend-ndodhjen e objektit të kompostimit, të sigurohet që është bërë zgjedhja e duhur të vendndodhjes për objektin (larg zonave të banimit, larg zonave ekologjike të ndjeshme, planifikimi i zonës tampon të gjelbër) dhe se është hartuar raporti i VNM-së për këtë. Zbatoni masat e parapara me raportin e VNM-së për këtë projekt të cilat duhet të përfshijnë, përdorimin e teknologjisë të përshtatshme për kontrollin e erërave (biofiltra, sisteme të mbyllura); Monitorimi të rregullt të emetimeve; aplikimin e praktikave të mira operative (p.sh., kthimi i grumbujve të kompostit, ventilim i mjaftueshëm).
Aksidente të mundshme ose trajtim i papërshtatshëm i flukseve të mbeturinave të rrezikshme/të veçanta	Kryeni trajnime të rregullta për stafin mbi trajtimin e mbeturinave të rrezikshme; zbatoni protokolle të rrepta operative dhe procedura reagimi në raste emergjente; sigurohuni për etiketimin, ruajtjen dhe transportimin e duhur të materialeve të rrezikshme.
Rritje e përkohshme e ndotjes gjatë aktiviteteve të ndërtimit për shkak të makinerive dhe transportit	Përdorni makineri dhe mjete që përmbushin standardet e emetimeve; optimizoni logjistikën e ndërtimit për të minimizuar udhëtimet; inkurajoni përdorimin e teknologjive me konsum efikas të karburantit, kryerja e inspektimeve të rregullta.
Rezistencë e mundshme e operatorëve joformalë ndaj ndryshimeve në sistemet e mbledhjes së mbeturinave ose ndërprerje e aktiviteteve të sektorit informal	Përfshini palët e interesuara që në fazat e para; organizoni fushata informacioni për të shpjeguar ndryshimet; ofroni mundësi integrimi për punëtorët informalë në sistemin formal të riciklimit (trajnime, mundësi punësimi).
Rrezik i krijimit të deponive të reja ilegale gjatë periudhave të tranzicionit (përpara se shërbimet e mbeturinave të jenë plotësisht funksionale)	Forconi mekanizmat e zbatimit dhe mbikëqyrjes; kryeni fushata ndërgjegjësimi për shërbimet e reja; ofroni mundësi ligjore për depozitim të mbeturinave tek Qendrat e riciklimit sa më shpejt të jetë e mundur.

V. KORNIZA E MONITORIMIT

Direktiva e VSM-së kërkon që efektet e rëndësishme mjedisore të zbatimit të PNMIM-it të monitorohen, për të identifikuar në një fazë të hershme çdo efekt negativ të paparashikuar, në mënyrë që autoritetet të jenë në gjendje të ndërmarrin veprimet e duhura korrigjuese.

Monitorimi gjithashtu mund të përdoret për të analizuar nëse PNMIM po arrin objektivat e tij dhe ato të mbrojtjes së mjedisit, nëse këto objektiva duhet të rishikohen dhe nëse masat e propozuara për zbutje po zbatohen.

Tabela në vijim paraqet Planin e Monitorimit, duke ofruar tregues për matjen e shkallës në të cilën po arrihen objektivat e VSM-së, frekuencën e monitorimit, autoritetet përgjegjëse për monitorimin dhe kohën e reagimit të mundshëm.

Tabela 24: Plani i Monitorimit për zbatimin e masave lehtësuese të identifikuara në VSM

Tema e VSM-së	Biodiversiteti dhe zonat natyrore të mbrojtura		
Objektivat e VSM-së	O1. Mbrojtja dhe përmirësimi i biodiversitetit dhe ekosistemeve nëpërmjet adoptimit të praktikave për menaxhimin e mbeturinave që janë të qëndrueshme dhe miqësore ndaj mjedisit		
Treguesit për monitorim	Frekuenca	Përgjegjësia	Koha e reagimit
Aplikohen praktika të reja të menaxhimit	Çdo vit Bazuar në: Ligjin Nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma (e vogël, për shqetësimin e specieve) Ligjin Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës	Inspektorati I Mjedisit; AMMK Bazuar në: Ligjin Nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma (e vogël, për shqetësimin e specieve) Ligjin Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës	Nëse objektet ndodhen brenda ose pranë zonave të ndjeshme pa masa zbutëse.
Numri i deponive ilegale të eliminuara	Dy herë në vit Bazuar në: Ligjin Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës	Komunat, Inspektorët e mjedisit, MMPHI Bazuar në: Ligjin Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës	Nëse vërehet rritje e hedhjes së paligjshme të mbeturinave.
Tema e VSM-së	Popullsia, mirëqenia e popullatës dhe ekonomia lokale		
Objektivat e VSM-së	O2. Mbështetja e zhvillimit ekonomik lokal (ekonomia qarkore) përmes zbatimit të praktikave inovative dhe efikase të menaxhimit të mbeturinave që zvogëlojnë konsumin e burimeve dhe gjenerimin e mbeturinave.		
Treguesit për monitorim	Frekuenca	Përgjegjësia	Koha e reagimit
Punësimi i gjeneruar përmes aktiviteteve të menaxhimit të mbeturinave dhe riciklimit.	Çdo vit	Komunat, KRM Ambienti	Nëse nivelet e punësimit ulen ose nuk krijohen mundësi të reja.
Numri i bizneseve që marrin pjesë në programet e riciklimit dhe rikuperimit.	Çdo vit	Komunat	Nëse pjesëmarrja e bizneseve është e ulët ose në rënie.
Tema e VSM-së	Shëndeti i popullatës		
Objektivat e VSM-së	O3. Eliminimi ose zvogëlimi i rreziqeve shëndetësore të lidhura me hedhjen dhe trajtimin e mbeturinave si rezultat i zbatimit të PNMIM-së.		
Treguesit për monitorim	Frekuenca	Përgjegjësia	Koha e reagimit
Shkalla e ankesave të lidhura me aromat e pakëndëshme, dëmtuesit ose derdhjet e mbeturinave.	Çdo tre muaj – Sipas Ligjit Nr. 02/L-78 për Shëndetin Publik	Inspektorati Shëndetësor (Komunal dhe Kombëtar – Institucionet Shëndetësore Publike), MSH	Nëse ankesat rriten ndjeshëm.
Numri i rasteve të raportuara të problemeve shëndetësore të lidhura me objektet e trajtimit të mbeturinave.	Çdo vit Bazuar në: Ligjit Nr. 02/L-78 për Shëndetin Publik; Ligjin Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë Ligjin Nr. 04/L-183 për Transportin Tokësor të Mallrave të Rrezikshme	Institucionet Shëndetësore Publike, Inspektorati i Mjedisit, MSH Bazuar në: Ligjit Nr. 02/L-78 për Shëndetin Publik; Ligjin Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë; Ligjin Nr. 04/L-183 për Transportin Tokësor të Mallrave të Rrezikshme	Nëse identifikohen raste të shumta
O4. Zvogëlimi i shqetësimeve për banorët lokal që rrjedhin nga zbatimi i aktiviteteve të PNMIM-së.			
Numri dhe lloji i ankesave nga banorët (aromat e keqe, zhurmë, trafik, ndikim vizual)	Çdo tre muaj – Sipas Ligjit Nr. 02/L-78 për Shëndetin Publik	Komunat, KRM Ambienti	Nëse ankesat në një lokacion të caktuar shtohen ose mbeten të pazgjidhura
Afërsia e infrastrukturës së re të mbeturinave me zonat e banuar	Gjatë fazës së planifikimit	Autoritetet e Planifikimit Hapësinor Komunal	Nëse infrastruktura ndodhet shumë afër pa masa të përshtatshme zbutëse
Nivelet e zhurmës dhe pluhurit gjatë ndërtimit të objekteve	Gjatë ndërtimit	Inspektorati Mjedisor, Kontraktorët	Nëse nivelet tejkalojnë kufijtë ligjorë ose kontraktualë

Emetimet e aromave të pakëndshme pranë objekteve të	Çdo tre muaj	Operatorët, Komunat	Nëse tejkalohen ankesat ose pragjet e aromave të
Rezultatet e sondazheve të kënaqshmërisë së publikut në lidhje me shërbimet e menaxhimit mbeturinave.	Çdo vit	Komunat, OJQ-të	Nëse pakënaqësia e publikut është në rritje ose shërbimet perceptohen si shqetësuese.
Tema e VSM-së	Shfrytëzimi i tokës dhe cilësia e saj		
Objektivat e VSM-së	O5. Mbrojtja e tokës dhe tokës bujqësore nga ndikimet e mundshme negative të aktiviteteve të PNMIM-së.		
Treguesit për monitorim	Frekuenca	Përgjegjësia	Koha e reagimit
Ndotësit e cilësisë së tokës pranë impianteve të mbeturinave	Çdo vit Bazuar në: Ligjin Nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore; Ligjin Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit (detyrimet e përgjithshme për zbutjen)	Inspektorati i Mjedisit, MPBZHR Bazuar në: Ligjin Nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore; Ligjin Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit (detyrimet e përgjithshme për zbutjen)	Nëse tejkalohen pragjet e ndotjes
Ndryshimet e përdorimit të tokës për shkak të infrastrukturës së re të mbeturinave	Çdo vit Bazuar në: Ligjin Nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore; Udhëzimi Administrativ Nr. 41/2006 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore	Komunat, Autoritetet e Planifikimit Hapësinor, MPBZHR Bazuar në: Ligjin Nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore; Udhëzimin Administrativ Nr. 41/2006 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore	Nëse toka bujqësore me vlerë të lartë kompromentohet
Tema e VSM-së	Uji		
Objektivat e VSM-së	O6. Të mbrohen burimet ujore dhe të parandalohet ndotja e mundshme si rezultat i zbatimit të aktiviteteve të PNMIM-së.		
Treguesit për monitorim	Frekuenca	Përgjegjësia	Koha e reagimit
Cilësia e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore pranë objekteve të mbeturinave (parametrat kimikë)	Çdo vit Bazuar në: Ligjin Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës; Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit (mbrojtja e përgjithshme e ujit)	AKMM, Inspektorati i Mjedisit, IHMK Bazuar në: Ligjin Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës; Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit (mbrojtja e përgjithshme e ujit)	Nëse nivelet e ndotjes rriten ose tejkalojnë standardet
Numri i deponive ilegale pranë trupave ujorë	Dy herë vit Bazuar në: Ligjin Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës; Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit (mbrojtja e përgjithshme e ujit)	Komunat, Inspektorati i Mjedisit, IKHM Bazuar në: Ligjin Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës; Ligjin Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit (mbrojtja e përgjithshme e ujit)	Nëse zbulohen raste të reja
	O7. Të përmirësohet cilësia e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe të promovohet menaxhimi i qëndrueshëm i ujit përmes zbatimit të PNMIM-së.		
Cilësia e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore pranë deponive operative dhe të mbyllura (psh., KKO, KBO, metalet e rënda)	Çdo vit Bazuar në: Ligjin Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës; Ligjin Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit (mbrojtja e përgjithshme e ujit)	AKMM, Inspektorati i Mjedisit, IHMK Bazuar në: Ligjin Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës; Ligjin Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit (mbrojtja e përgjithshme e ujit)	Nëse përqendrimet e ndotësve tejkalojnë pragjet rregullatore ose tregojnë një trend në rritje

Numri i rrjedhjeve ose derdhjeve të lëngut kullues të raportuara në deponi, stacione të transferit dhe lokacione të kompostimit	Çdo tre muaj Bazuar në: Ligjin Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës; Ligjin Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit (mbrojtja e përgjithshme e ujit)	KRM Ambienti, Operatorët e objekteve Bazuar në: Ligjin Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës; Ligjin Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit (mbrojtja e përgjithshme e ujit)	Nëse ndodh ndonjë shkarkim i pakontrolluar ose trajtimi i lëngut kullues nuk funksionon siç duhet.
Zbatimi dhe mirëmbajtja e sistemeve të mbledhjes dhe trajtimit të lëngut kullues	Dy herë në vit Bazuar në: Ligjin Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës; Ligjin Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit (mbrojtja e përgjithshme e ujit)	KRM Ambienti, Komunitat	Nëse sistemet nuk janë vendosur, nuk funksionojnë mirë ose janë në gjendje të keqe
Incidentet e ndotjes së ujit të lidhura me hedhjen e paligjshme të mbeturinave (p.sh., pranë lumenjve ose puseve)	Incident i vazhdueshëm Bazuar në: Ligjin Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës	Komunitat, Inspektorati i Mjedisit	Kërkohej veprim i menjëhershëm nëse zbulohet ndonjë ndotje
Tema e VSM-së		Kualiteti i ajrit, zhurma dhe dridhjet	
Objektivat e VSM-së		O8. Të zvogëlohen emetimet e gazeve dhe grimcave të dëmshme nga aktivitetet e trajtimit dhe transportit të mbeturinave	
Treguesit për monitorim	Frekuenca	Përgjegjësia	Koha e reagimit
Niveli i emetimeve në ajër (pluhur, NOx, CO2) nga objektet e mbeturinave dhe transporti	Çdo vit Bazuar në: Ligjin Nr. 03/L-160 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja; Ligjin Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit	AKMM, Inspektorati i Mjedisit Bazuar në: Ligjin Nr. 03/L-160 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja; Ligjin Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit	Nëse nivelet e ndotësve të ajrit tejkalojnë pragjet ligjore
Objektivat e VSM-së		O9. Të minimizohen shqetësimet nga zhurmat dhe dridhjet e shkaktuara nga aktivitetet që lidhen me zbatimin e PNMIM-së.	
Treguesit për monitorim	Frekuenca	Përgjegjësia	Koha e reagimit
Nivelet e zhurmës pranë objekteve të reja të trajtimit ose transferimit të mbeturinave	Dy herë në vit Bazuar në: Ligjin Nr. 02/L-102 për Mbrojtje nga Zhurma	Inspektorati i mjedisit: Bazuar në: Ligjin Nr. 02/L-102 për Mbrojtje nga Zhurma	Nëse nivelet e zhurmës tejkalojnë kufijtë e lejuar të decibelëve
Tema e VSM-së		Ndryshimet klimatike	
Objektivat e VSM-së		O10. Të minimizohen emetimet e gazrave serrë që rezultojnë nga aktivitetet e PNMIM-së dhe të rritet qëndrueshmëria ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike.	
Treguesit për monitorim	Frekuenca	Përgjegjësia	Koha e reagimit
Emetimet e gazrave serrë që lidhen me operacionet e menaxhimit të mbeturinave (të vlerësuara)	Çdo vit Bazuar në: Strategjinë e ndryshimeve klimatike 2019–2028 (politikë) Ligjin Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit (detyrimet e përgjithshme për zbutjen)	AKMM, KRM Ambienti Bazuar në: Strategjinë e ndryshimeve klimatike 2019–2028 (politikë) Ligjin Nr. 03/L-025 për mbrojtjen e Mjedisit (detyrimet e përgjithshme për zbutjen)	Nëse emetimet e gazrave serrë rriten në vend që të ulen
		O11. Të merren parasysh dhe të minimizohen rreziqet që lidhen me ndryshimet klimatike, veçanërisht përmblytjet, gjatë planifikimit dhe zbatimit të PNMIM-së.	

Vlerësimet e rrezikut të kryera për objektet e reja (rreziqet e përmbajtjeve, rrëshqitjeve të dheut)	Gjatë fazës së planifikimit për secilin objekt Bazuar në: Strategjinë e ndryshimeve klimatike 2019–2028 (politikë) Ligjin Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit (detyrimet e përgjithshme për zbutjen)	Komunat, Inspektorati I Mjedisit, ARPL, Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave Bazuar në: Strategjinë e ndryshimeve klimatike 2019–2028 (politikë); Ligjin Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit (detyrimet e përgjithshme për zbutjen)	Nëse objektet janë të vendosura në zona me rrezik të lartë pa masa zbutëse
Tema e VSM-së	Trashëgimia kulturore dhe arkeologjike		
Objektivat e VSM-së	O12. Të ruhet dhe mbrohet trashëgimia kulturore dhe asetet e saj, së bashku me mjedisin përreth, gjatë zbatimit të aktiviteteve të PNMIM-së		
Treguesit për monitorim	Frekuenca	Përgjegjësia	Koha e reagimit
Numri i projekteve të menaxhimit të mbeturinave pranë lokacioneve të trashëgimisë kulturore	Çdo vit Bazuar në: Ligjin Nr. 02/L-88 për Trashëgimi Kulturore Ligjin Nr. 03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura	Ministria e kulturës Rinisë dhe sportit, Komunat Bazuar në: Ligjin Nr. 02/L-88 për Trashëgimi Kulturore; Ligjin Nr. 03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura	Nëse ndodhin ndikime të paautorizuara në lokacionet kulturore
Zbatimi i masave mbrojtëse gjatë punës pranë zonave të trashëgimisë	Per projekt Bazuar në: Ligjin Nr. 02/L-88 për Trashëgimi Kulturore Ligjin Nr. 03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura	Autoritetet e Trashëgimisë Kulturore (Instituti I Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve, Inspektorati për Trashëgimi Kulturore) Bazuar në: Ligjin Nr. 02/L-88 për Trashëgimi Kulturore Ligjin Nr. 03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura	Nëse masat nuk janë zbatuar
Tema e VSM-së	Peizazhi i ndërtuar dhe i pandërtuar		
Objektivat e VSM-së	O13. Të mbrohet dhe përmirësohet cilësia e peizazhit natyror dhe urban, si dhe pamja vizuale, gjatë planifikimit dhe zbatimit të aktiviteteve të PNMIM-së.		
Treguesit për monitorim	Frekuenca	Përgjegjësia	Koha e reagimit
Vlerësimet e ndikimit vizual të kryera para ndërtimit të objektit të mbeturinave	Për projekt Bazuar në: Ligjin Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor Ligjin Nr. 03/L-025 për Mbrojtje të Mjedisit (peizazhi si vlerë mjedisore)	Komunat (Drejtoritë e urbanizmit dhe Planifikimit hapësinor), Autoritetet e Planifikimit Hapësinor Bazuar në: Ligjin Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor; Ligjin Nr. 03/L-025 për Mbrojtje të Mjedisit (peizazhi si vlerë mjedisore)	Nëse nuk janë kryer vlerësimet ose gjenden ndikime të mëdha negative
Numri i aktiviteteve të restaurimit të peizazhit pas mbylljes së deponisë së mbeturinave	Çdo vit Bazuar në: Ligjin Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor Ligjin Nr. 03/L-025 për Mbrojtje të Mjedisit (peizazhi si vlerë mjedisore)	Komunat Bazuar në: Ligjin Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor; Ligjin Nr. 03/L-025 për Mbrojtje të Mjedisit (peizazhi si vlerë mjedisore)	Nëse deponitë e mbeturinave mbyllen pa restaurim të peizazhit
Tema e VSM-së	Aspektet tjera-Mbeturinat		

Objektivat e VSM-së	O14. Të përmirësohet menaxhimi i mbeturinave në Zonën e Menaxhimit të Mbeturinave 3 - Pejë (përfshihen Peja, Istogu, Klina, Deçani dhe Juniku), të promovohet ekonomia qarkore, të		
Treguesit për monitorim	Frekuenca	Përgjegjësia	Koha e reagimit
Përqindja e mbeturinave të devijuara nga deponia (shkallët e riciklimit dhe kompostimit)	Çdo vit Bazuar në: Ligjin Nr. 04/L-060 për Mbeturinat (përmend hierarkinë e mbeturinave dhe riciklimin)	KRM Ambienti, Komunitat Bazuar në: Ligjin Nr. 04/L-060 për Mbeturinat (përmend hierarkinë e mbeturinave dhe riciklimin)	Nëse normat e devijimit ngecin ose bien
Zbatimi i iniciativave të ekonomisë qarkore (qendra ripërdorimi, programe kompostimi)	Çdo vit Bazuar në: Ligjin Nr. 04/L-060 për Mbeturinat (përmend hierarkinë e mbeturinave dhe riciklimin)	Komunitat Bazuar në: Ligjin Nr. 04/L-060 për Mbeturinat (përmend hierarkinë e mbeturinave dhe riciklimin)	Nëse iniciativat e reja vonohen ose nuk funksionojnë siç duhet
Tema e VSM-së	Transportimi i mbeturinave		
Objektivat e VSM-së	O15. Të minimizohet volumni i trafikut të lidhur me aktivitetet e menaxhimit të mbeturinave në kuadër të PNMIM-së dhe të promovohen zgjedhje më të qëndrueshme të transportit..		
Treguesit për monitorim	Frekuenca	Përgjegjësia	Koha e reagimit
Numri dhe optimizimi i rrugëve të transportit të mbeturinave	Çdo vit Bazuar në: Ligji Nr. 08/L-186 për Rregullat e trafikut Rrugor; Ligjin Nr. 04/L-183 për Transportin Tokësor të Mallrave të Rrezikshme	Komunitat, KRM Ambienti Bazuar në: Ligji Nr. 08/L-186 për Rregullat e trafikut Rrugor; Ligjin Nr. 04/L-183 për Transportin Tokësor të Mallrave të Rrezikshme	Nëse ndikimet e trafikut në komunitetet lokale përkeqësohen
Emetimet nga flota e transportit të mbeturinave (përputhshmëria me standardet)	Çdo vit Bazuar në: Ligji Nr. 08/L-186 për Rregullat e trafikut Rrugor; Ligjin Nr. 04/L-183 për Transportin Tokësor të Mallrave të Rrezikshme	KRM Ambienti, Inspektorati I Mjedisit Bazuar në: Ligji Nr. 08/L-186 për Rregullat e trafikut Rrugor; Ligjin Nr. 04/L-183 për Transportin Tokësor të Mallrave të Rrezikshme	Nëse automjetet që nuk janë në përputhje me rregullat vazhdojnë të funksionojnë

VI. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Plani Ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave propozon një kornizë gjithëpërfshirëse për menaxhimin e mbeturinave në Zonën e Menaxhimit të Mbeturinave 3 - Pejë (përfshihen Peja, Istogu, Klina, Deçani dhe Juniku) për periudhën 2025–2035. Plani parasheh përmirësime të ndjeshme në efikasitetin, qëndrueshmërinë dhe ndikimin mjedisor të sistemeve të menaxhimit të mbeturinave në të pesë komunitetet pjesëmarrëse. Objektivat e tij përfshijnë mbulimin 100% me shërbime të grumbullimit të mbeturinave, rritjen e normave të riciklimit dhe rikuperimit, uljen e konsiderueshme të sasisë së mbeturinave që dërgohen në deponi, si dhe mbylljen e deponive ilegale.

PNMIM-ja është e strukturuar në katër komponentë kryesorë: vlerësimi fillestar dhe analizë e nevojave, raporti mbi parashikimin dhe përbërjen e mbeturinave, analiza e opsioneve që shqyrton skenarë të ndryshëm zhvillimi dhe plani i detajuar i veprimit. PNMIM-ja përcakton objektiva ambicioze, si arritja e një norme riciklimi të mbeturinave komunale prej 50% deri në vitin 2035 dhe ulja e deponimit të mbeturinave në më pak se 30% të totalit deri në të njëjtin vit. Për të mbështetur këto qëllime, do të ndërtohen infrastrukturë e re si Qendrat e riciklimit për shërbime qytetare, dy

stacione të transferimit të mbeturinave, objekti për riciklim dhe kompostim, objekti për riciklimin e mbeturinave të ndërtimit dhe demolimit etj.

Nga ana tjetër, VSM-ja mbulon një gamë të gjerë çështjesh mjedisore, përfshirë biodiversitetin, tokën, ujin, cilësinë e ajrit, ndryshimet klimatike, peizazhin, shëndetin e njeriut dhe trashëgiminë kulturore. Analiza e gjendjes ekzistuese në këto fusha tregon se Zona e Menaxhimit të Mbeturinave 3 - Pejë (përfshihen Peja, Istogu, Klina, Deçani dhe Juniku) posedon burime natyrore të rëndësishme, të karakterizuara nga toka pjellore, burime të bollshme ujore, biodiversitet të pasur dhe zona me rëndësi kulturore dhe historike. Megjithatë, rajoni përballet edhe me sfida të mëdha mjedisore, veçanërisht në lidhje me menaxhimin e mbeturinave. Ndonëse shërbimet për grumbullimin e mbeturinave ofrohen në shumicën e zonave, grumbullimi i ndarë për materialet e riciklueshme mbetet i pazhvilluar, deponitë ilegale vazhdojnë të ekzistojnë, megjithëse numri i tyre është duke rënë. Deponia rajonale në Pejë është e mbingarkuar dhe i mungojnë procedurat operative të nevojshme për një depozitim të sigurt dhe të qëndrueshëm mjedisor. Për më tepër, mungojnë objektet e dedikuara për trajtimin e mbeturinave, ndërsa aktivitetet e riciklimit kryhen kryesisht nga sektori informal. Trupat ujqorë, cilësia e tokës dhe ajri në rajon janë në rrezik degradimi për shkak të praktikave të papërshtatshme të menaxhimit të mbeturinave. Biodiversiteti është i kërcënuar nga shqetësimi i habitateve dhe ndotja, ndërsa ka shqetësime serioze edhe për ndikimet në shëndetin publik që rrjedhin nga trajtimi i pamjaftueshëm i mbeturinave. Nga pikëpamja socio-ekonomike, rajoni është kryesisht rural, me nivele të larta papunësie dhe varësi ekonomike nga bujqësia, remitancat dhe shërbimet në shkallë të vogël. Zhvillimi i infrastrukturës mbetet një nevojë kritike për të nxitur rritjen ekonomike dhe për të përmirësuar kushtet e jetesës.

VSM-ja ka identifikuar disa efekte pozitive mjedisore që priten nga zbatimi i PNMIM-së si:

- të ndikojë në zvogëlim të ndjeshëm të ndotjes nga mbeturinat e pakontrolluara, duke përmirësuar kështu cilësinë e ajrit, ujit dhe tokës.
- të kontribuojë në mbrojtjen e biodiversitetit përmes zvogëlimit të ndotjes së habitateve dhe të mbështesë zbutjen e ndryshimeve klimatike përmes uljes së emetimeve të gazeve serra nga deponitë.
- të përmirësojë vizualitetin e peizazhit dhe të rrisë cilësinë e shëndetit publik duke minimizuar ekspozimin ndaj mbeturinave dhe duke promovuar një mjedis më të pastër në zonat urbane dhe rurale.

Megjithatë, VSM-ja vë në pah se gjithashtu se ka disa ndikime të mundshme negative që mund të shfaqen gjatë ndërtimit dhe funksionimit të infrastrukturës së re për menaxhimin e mbeturinave me zbatimin e PNMIM-së të cilat përfshijnë:

- shqetësime të përkohshme si zhurma, pluhuri dhe rritja e trafikut;
- rreziqe të vogla që lidhen me vendndodhjen e objekteve të reja, nëse nuk menaxhohen siç duhet;
- rrezikun që mbulimi i pamjaftueshëm i shërbimeve ose mungesa e zbatimit efektiv gjatë fazave të hershme të zbatimit mund të çojë në vazhdimësi apo edhe rritje të aktiviteteve të hedhjes ilegale të mbeturinave.

Vlerësimi në përgjithësi arriti në përfundimin se ndikimet pozitive të PNMIM-së tejkalojnë çdo ndikim të mundshëm negativ, me kusht që masat përkatëse të zbutjes të zbatohen në mënyrë efektive.

Për të maksimizuar përfitimet mjedisore dhe për të minimizuar efektet negative, si pjesë e VSM-së, janë propozuar disa masa zbutëse si:

- zbatimin e standardeve të rrepta mjedisore gjatë ndërtimit dhe operimit të objekteve të reja
- përdorimin e teknologjive më të mira të disponueshme për trajtimin e mbeturinave

- përfshirjen e kriterëve mjedisore në procedurat e prokurimit (prokurimi i gjelbër) dhe operimit
- t'i kushtohet vëmendje vendndodhjes së objekteve për mbeturina për të shmangur zonat e ndjeshme mjedisore dhe për të minimizuar ndikimin vizual
- të zhvillohen strategji për menaxhimin e trafikut për të kufizuar emetimet gjatë transportimit të mbeturinave
- të zbatohen me rigorozitet masa për shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit e menaxhimit të mbeturinave
- Meqenëse shumë nga vendndodhjet e infrastrukturës dhe objekteve të planifikuara për mbeturina nuk janë identifikuar ende dhe studimet e fizibilitetit janë parakusht, VSM-ja rekomandon kryerjen e VNM-ve për zhvillimet e tilla. Gjithashtu, VSM-ja ofron kritere të vlefshme për përzgjedhjen e vendeve të përshtatshme, së bashku me të dhëna të bazuara në GIS që evidentojnë zonat e rrezikuara nga përmbytjet dhe ato me histori zjarresh
- Fushatat për ngritjen e ndërgjegjësimit të publikut që do të luajnë një rol kyç në promovimin e ndarjes së mbeturinave në burim dhe në inkurajimin e pjesëmarrjes së komunitetit në programet e riciklimit
- Zbatim më i fuqishëm i legjislacionit, duke përfshirë inspektime të rregullta dhe ndëshkime për hedhjen e paligjshme të mbeturinave, gjithashtu i nevojshëm për të siguruar përputhshmërinë.

Plani i detajuar i monitorimit që është pjesë e këtij raporti ka për qëllim të sigurojë që objektivat mjedisore të përmbushen dhe të merren masa korrigjuese kur është e nevojshme. Plani i monitorimit përfshin tregues kyç si: normat e riciklimit, mbylljen e deponive ilegale, masat e cilësisë mjedisore dhe të dhënat për shëndetin publik. Monitorimi do të kryhet me frekuenca të ndryshme në varësi të treguesit, nga monitorimi i vazhdueshëm operativ deri te raportimet tremujore dhe vjetore.

Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), autoritetet komunale të menaxhimit të mbeturinave dhe institucionet e shëndetit publik do të ndajnë përgjegjësinë për zbatimin e aktiviteteve të monitorimit. Të dhënat e mbledhura do të përdoren për rishikime periodike të Planit dhe për të mundësuar menaxhimin adaptues në përgjigje të sfidave apo mundësive të paparashikuara.

VSM-ja përfundon se PNMIM-ja për Zonën e Menaxhimit të Mbeturinave 3 - Pejë (përfshihen Peja, Istogu, Klina, Deçani dhe Juniku) është i qëndrueshëm nga aspekti mjedisor, ashtu edhe përfitues në aspektin socio-ekonomik. Nëse zbatohet siç duhet dhe mbështetet nga masat e propozuara të zbutjes dhe monitorimit, PNMIM-ja do të sjellë përmirësime të mëdha në cilësinë e mjedisit, do të përmirësojë shëndetin publik, do të mbështesë përpjekjet për zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe do të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm të rajonit.

Miratimi i PNMIM-së, i udhëhequr nga gjetjet e këtij vlerësimi, përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt një Rajoni të Dukagjinit më të pastër, më të shëndetshëm dhe më të begatë, në përputhje me prioritetet kombëtare dhe objektivat mjedisore të Bashkimit Evropian.

ANEKSI 1. PËRMBLEDHJA JO-TEKNIKE

(është pjesë e shkoqitur e këtij raporti e destinuar për përdorim të publikut)

Raport i trajtimit të komenteve të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor
dhe Infrastrukturës / Departamenti i Mjedisit

për

Vlerësimin Strategjik Mjedisor të Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e
Integruar të Mbeturinave në rajonin e Dukagjinit¹

¹ Termi “Rajoni i Dukagjinit” në këtë dokument i referohet Zonës së Menaxhimit të Mbeturinave (ZMM) 3 – Pejë, të përcaktuar me Strategjinë për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Kosovë (SMIMK) 2024-2035. ZMM 3 i përfshin qytetet Pejë, Istog, Klinë, Deçan dhe Junik.

Komenti	Përgjigjet në koment
Mungon nënshkrimi i Raportit të VSM-së	Komenti është pranuar. Nënshkrimi është përfshirë në dokument
Në raport duhet të përmirësohet baza ligjore, ligjet e shkruara janë të shfuqizuara;	Lista e bazës ligjore është rishikuar. Ligjet që janë shfuqizuar janë zëvendësuar me ligjet në fuqi dhe ato të cilat kanë pësuar ndryshim/plotësime me ligje tjera janë plotësuar.
2.1. Në faqen 26, janë paraqitur në mënyrë grafike të dhënat për cilësinë e ajrit nga Zonën ZKS1, por këto të dhëna janë nga Mitrovica, Drenasi Hani i Elezit, Brezovica dhe Gjilani, që nuk përfshihen në rajonin e Dukagjinit. Prandaj, ato nuk janë relevante për këtë plan ndër komunal dhe nuk mund të përfaqësojnë gjendjen reale në komunat për të cilat bëhet vlerësimi. 2.2. Në tekst thuhet se: “Mesatarja vjetore e O₃ është 558 µg/m³”. Kjo vlerë është plotësisht jo reale dhe e pakuptimtë. Nëse do të ishte e saktë, do të kërkohej shpallje e menjëhershme e alarmit shtetëror, sipas nivelit të pragut të alarmit të përcaktuar në legjislacionin për cilësinë e ajrit.	Gabimi teknik me tekstin e ZKS1 është larguar nga grafiku dhe janë mbajtur vetëm të dhënat për rajonin e Pejës, i cili i përfshin komunat e ZMZ-së. Të dhënat janë marrë nga publikimi i ASK, Disa Fakte mbi Mjedisin” 2024, vizitoni: https://ask.rks.gov.net/Themes/Environment. Gabimi teknik tek vlera e O₃ është përmirësuar. Vlera është 55.8 µg/m³ që konsiderohet si një nivel i moderuar ose i pranueshëm, që nuk paraqet rrezik për shumicën e popullsisë. Teksti ndërlidhës me këtë është përmirësuar.
2.3. Po ashtu, në tekst i është referuar masës së thatë pas korrije-shirjeve si “mbeturinë”, gjë që është e gabuar . Ajo nuk është mbeturinë , por material organik që ka vlerë bujqësore dhe energjetike (biomasa), prandaj kategorizimi i saj si mbeturinë është i pasaktë dhe mund të krijojë keqkuptime.	Përmirësimi është bërë. Fjalja që përmban këtë tekst është larguar.